Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR 2007

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569;
Faks: 355-4-2223558
e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:
Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit.
E-mail: public@bankofalbania.org

Tirazhi: 1000 kopje

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	7
1. PËRMBLEDHJE	8
2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 2007	15
3. SITUATA MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI	32
4. ANALIZA E TREGUESVE TË SHËNDETIT TË SISTEMIT FINANCIAR	42
5. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE	58
6. ANALIZA "STRESS-TEST"	62
7. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA DHE SHOQËRITË E SIGURIMIT	69
ANEKS 1.	72
SHËNIME	74

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

2. Zhvillimet ndërkombëtare gjatë vitit 2007
Tabelë 1. Rritja e PBB-së dhe inflacioni në Evropë. 18

3. Situata makroekonomike në Shqipëri
Tabelë 2. Ndryshimet vjetore sipas sektorëve të prodhimit. 34
Tabelë 3. Tregues të sektorit të ndërtimit. 35
Tabelë 4. Norma e inflacionit vjetor gjatë vitit 2007. 36
Tabelë 5. Tregues të punësimit. 39

4. Analiza e treguesve të shëndetit të sistemit financiar
Tabelë 6. Raporti i kredisë me probleme neto ndaj treguesve të kapitalit. 48
Tabelë 7. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS. 58
Tabelë 8. Tregues për transaksionet në sistemin AECH. 58

5. Infrastruktura teknologjike
Tabelë 9. Llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS. 59
Tabelë 10. Tregues të përqendrimit për sistemin AIPS. 59
Tabelë 11. Tregues të përqendrimit për sistemin AECH. 59
Tabelë 12. Përdorimi i kredisë brenda ditës. 60
Tabelë 13. Shlyerja e çeqeve në AIPS. 60
Tabelë 14. Përdorimi i kartave bankare. 60
Tabelë 15. Numri i terminaleve ATM dhe POS. 60
Tabelë 16. Transaksionet me kartat e debitit. 61
Tabelë 17. Transaksionet me kartat e kreditit. 61
Tabelë 18. Përdorimi i home – banking. 61

6. Analiza "Stress-Test"
Tabelë 19. Rezultate të përmbledhura të analizës "stres-test". 68

Aneks 1
Tabelë 20. Humbjet e shkaktuara nga kriza e huave hipotekare në sektorin financiar në disa vende të botës. 72
Tabelë 21. Ndryshimet e rreziqeve dhe kushteve. 72

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2. Zhvillimet ndërkombëtare gjatë vitit 2007

Grafik 1. Norma vjetore LIBOR në usd. 21
Grafik 2. Diferenca midis normës së interesit për kredinë 3-mujore dhe 1-ditore, në pikë bazë (1 për qind = 100 pikë bazë), para dhe gjatë krizës. 22
Grafik 3. Kursi i këmbimit euro/usd. 22
Grafik 4. Humbjet e bankave të lidhura me krizën financiare që prej fillimit të vitit 2007 (në mld usd). 23
Grafik 5. Rritja e kapitalit nga bankat që prej fillimit të vitit 2007. 23
Grafik 6. Humbjet e bankave evropiane që prej fillimit të vitit 2007. 24
Grafik 7. Rritja e kapitalit nga bankat evropiane që prej fillimit të vitit 2007. 24

3. Situata makroekonomike në Shqipëri

Grafik 8. Indeksi i çmimeve të apartamenteve. 33
Grafik 9. Kursi nominal efektiv i këmbimit. 35
Grafik 10. Kursi nominal usd/lek. 35
Grafik 11. Kursi nominal euro/lek. 36
Grafik 12. Flukset tremujore të remitancave në milionë euro. 40

4. Analiza e treguesve të shëndetit të sistemit financiar

Grafik 13. Ecuria e depozitave dhe kredive për sistemin bankar. 44
Grafik 14. Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive për sistemin bankar. 45
Grafik 15. Kredia në valutë ndaj totalit të kredive për sistemin bankar. 45
Grafik 16. Depozitat në valutë ndaj totalit të depozitave për sistemin bankar. 45
Grafik 17. Totali i depozitave ndaj totalit të kredisë për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 45
Grafik 18. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 45
Grafik 19. Detyrimet në valutë ndaj totalit të detyrimeve për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 45
Grafik 20. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar. 47
Grafik 21. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 47
Grafik 22. Raporti i levës financiare për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 47
Grafik 23. Raporti i huave me probleme ndaj kapitalit për sistemin bankar. 49
Grafik 24. Huatë me probleme neto ndaj kapitalit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 49
Grafik 25. Kthimi nga kapitali për sistemin bankar. 49
Grafik 26. Normat e interesit për instrumentet në lekë. 50
Grafik 27. Normat e interesit për instrumentet në usd. 50
Grafik 28. Normat e interesit për instrumentet në euro. 50
Grafik 29. Kthimi nga kapitali për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 50
Grafik 30. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sistemin bankar. 50
Grafik 31. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 51
Grafik 32. Mbulimi i kredisë me kolateral. 52
Grafik 33. Kredia e kolateralizuar ndaj portofolit të kredisë në valutat kryesore. 52

Grafik 34. Kredia e kolateralizuar ndaj portofolit të kredisë në valutë ku kredimarrësi nuk kryen aktivitet në valutë. 52
Grafik 35. Përdorimi i kredisë ndaj kredisë së re. 53
Grafik 36. Përbërja e porofolit të kredisë sipas afatit të maturimit. 53
Grafik 37. Kohëzgjatja mesatare e kredisë. 53
Grafik 38. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve. 54
Grafik 39. Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve për sistemin bankar. 55
Grafik 40. Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 55
Grafik 41. Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar. 55
Grafik 42. Kthimi nga aktivet për sistemin bankar. 55
Grafik 43. Kthimi nga aktivet për grupbankat sipas madhësisë së aktivitetit. 55
Grafik 44. Huatë me probleme bruto ndaj huave totale për sistemin bankar. 55
Grafik 45. Huatë me probleme ndaj huave totale për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 56
Grafik 46. Shpërndarja e huave sipas sektorëve të industrisë. 56
Grafik 47. Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto për sistemin bankar. 57
Grafik 48. Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 57
Grafik 49. Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto për sistemin bankar. 57
Grafik 50. Shpenzime interesi ndaj të ardhurave bruto për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit. 57

6. Analiza "Stress-Test"
Grafik 51. Pesha e përbërësve të sistemit financiar ndaj PBB-së (2007). 69
Grafik 52. Pesha specifike e përbërësve të sistemit financiar në %. 69

7. Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e sigurimit
Grafik 53. Ndryshimi i aktiveve të institucioneve jobanka në %. 70
Grafik 54. Raporti dëme/prime në tregun total të sigurimit. 71

HYRJE

Ky është numri i parë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një publikim i Bankës së Shqipërisë, i cili do të vijojë të përgatitet çdo vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, si edhe është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar. Me qëllim që raporti të lexohet nga grupe të ndryshme interesi dhe publiku në tërësi, është synuar që gjuha e përdorur dhe informacioni që paraqitet, të jenë sa më të përshtatshëm. Përmirësimi i cilësisë së raportit, veçanërisht në kuadër të të dhënave që përmban, do të jetë objektivi ynë për çdo publikim të ardhshëm.

Stabiliteti i sistemit financiar është vlerësuar në bazë të performancës dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet makroekonomike dhe të tregjeve brenda vendit dhe në ekonomitë e huaja partnere. Janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë në rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe ekonomitë e zhvilluara, dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar.

Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, është vlerësuar situata e të ardhurave personale dhe efektet që ajo ka mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar. Për të vlerësuar rreziqet që rrjedhin si rezultat i veprimtarisë së sistemit financiar, janë analizuar zhvillimet në treguesit kryesorë të shëndetit financiar të tij, ku përfshihen kapitali, cilësia e aktiveve dhe performanca financiare. Madhësia e rreziqeve është vlerësuar nëpërmjet analizës "stress-test". Është realizuar gjithashtu, një vlerësim i përmbledhur i situatës së sektorit financiar jobankar. Të dhënat dhe analiza përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë vitit 2007 por edhe të tremujorit të parë të vitit 2008. Pritjet për zhvillimet e ardhshme shtrihen përgjithësisht, deri në fund të vitit 2008.

1. PËRMBLEDHJE

Analiza e karakteristikave të rreziqeve të veprimtarisë financiare në vendin tonë, tregon për rritjen e nivelit të përgjithshëm të rrezikut. Spektri i rreziqeve është zgjeruar gjatë vitit 2007 dhe kjo prirje do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti. Kjo ecuri diktohet nga zgjerimi i mëtejshëm i investimeve të sistemit financiar në aktive me kthim (dhe rrezik) më të lartë, nga zhvillimet e brendshme të ekonomisë, nga hapja e saj dhe nga integrimi gradual në tregjet financiare rajonale dhe globale. Megjithatë, në bazë të analizës së autoriteteve rregullative, përgjithësisht sistemi financiar paraqitet aktualisht i mbrojtur nga rreziqet që vijnë si rezultat i zhvillimeve të brendshme dhe të atyre rajonale e globale. Në këtë kuadër, nuk identifikohet ndonjë rrezik i cili ka mundësi të lartë materializimi dhe që mund të dëmtojë në mënyrë të menjëhershme dhe të rëndë, veprimtarinë e sistemit financiar. Ndonëse niveli i rreziqeve është i administrueshëm, rekomandohet rritja e kujdesit mbikëqyrës nga ana e autoriteteve rregullative të tregut financiar, nga vetë institucionet financiare dhe nga publiku.

Gjatë vitit 2007, treguesit makroekonomikë shënuan një ecuri të qëndrueshme, pranë prirjes së tyre disavjeçare. Rritja vjetore ekonomike pritet të jetë pranë nivelit 6 për qind, ashtu si edhe në vitet e mëparshme, pavarësisht rritjes së deficitit tregtar. Në fund të vitit, Qeveria e Republikës së Shqipërisë plotësoi objektivat në lidhje me nivelin e të ardhurave dhe të shpenzimeve publike, tepricën negative (deficitin) buxhetore, si edhe në lidhje me madhësinë e financimit të një pjese të shpenzimeve me burime të brendshme të tregut financiar. Shpenzimet e kryera veçanërisht në pjesën e fundit të vitit, ndryshuan tiparet e financave publike, të cilat deri atëherë shfaqën një tepricë pozitive buxhetore. Politika monetare iu përgjigj presioneve inflacioniste, të cilat u ashpërsuan dhe u shfaqën qartë në tremujorin e fundit të vitit. Efekteve negative mbi kostot e prodhimit dhe ofertën e mallrave, të krijuara si rezultat i motit të thatë në periudhën e verës dhe të vjeshtës si edhe të situatës së rënduar energjitike brenda vendit, iu shtuan pasojat e një situate të vështirë në tregjet globale të lëndëve të para të energjisë dhe të produkteve ushqimore. Struktura e papërshtatshme e prodhimit në vend dhe varësia nga produktet e importuara, mbetën faktorë të cilët dëmtuan mekanizmat mbrojtës të ekonomisë së vendit ndaj zhvillimeve të tilla rajonale dhe globale. Si rezultat, në muajt shtator dhe tetor të vitit 2007, rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit sipas vlerësimit të Institutit të Statistikave, rezultoi përkatësisht 4.4 për qind dhe 4.2 për qind, përtej kufirit maksimal të synuar nga Banka e Shqipërisë, prej 4 për qind. Për të shmangur qëndrueshmërinë e presioneve inflacioniste, Banka e Shqipërisë rriti dy herë normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes, duke e ngjitur atë në nivelin 6.25 për qind. Në fund të vitit, rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit rezultoi 3.1 për qind, brenda kufijve të synuar të Bankës së Shqipërisë dhe pranë objektivit prej 3 për qind. Gjatë të njëjtës periudhë, situata në tregun e këmbimeve valutore u paraqit e qëndrueshme. Vlerat e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj atyre të huaja, kanë lëvizur brenda intervaleve historike për periudhën, duke reflektuar gjithashtu situatën në tregjet financiare ndërkombëtare.

Treguesit makroekonomikë për vitin 2008, pritet të realizohen brenda objektivave për një rritje ekonomike rreth vlerës së vitit të kaluar, por ndjeshmëria e ekuilibrit makroekonomik ndaj performancës sektoriale, rritjes së ekonomisë botërore si edhe ndaj qëndrimeve të politikës fiskale dhe monetare është rritur. Rritja ekonomike do të vazhdojë të përfitojë nga zgjerimi i kreditimit të sektorit bankar dhe nga fokusimi i shpenzimeve të qeverisë në investime, të cilat përmirësojnë nivelin e përgjithshëm të produktivitetit. Nga ana tjetër, rritja e kostos së prodhimit për shkak të faktorëve që lidhen me çmimet e lëndëve të para dhe energjinë, mundësia e rritjes së deficitit tregtar, si edhe mundësia e ngadalësimit të rritjes së ekonomisë rajonale dhe evropiane, do të jenë faktorë që do të ndikojnë negativisht mbi madhësinë e rritjes ekonomike. Ky vit karakterizohet nga parashikimi i një buxheti qeveritar me përmasa të konsiderueshme. Në të njëjtën kohë, për shkak të nevojës për të financuar disa investime të rëndësishme për ekonominë e vendit, deficiti buxhetor parashikohet të rritet. Rritja e shpenzimeve dhe rritja e deficitit buxhetor do të rrisin presionet inflacioniste në ekonomi, të cilat pritet të mbeten aktive gjatë gjithë vitit edhe për shkak të vijimit të situatës së pafavorshme në tregjet globale të lëndëve të para të energjisë dhe të produkteve ushqimore. Gjithashtu, rritja e investimeve publike nga ana e Qeverisë do të shoqërohet me rritje të financimit nga sistemi financiar, dhe mund të shkaktojë ngushtim të hapësirës ose përkeqësim të termave të financimit për sipërmarrjet private. Në kuadër të performancës më të dobët të disa sektorëve të ekonomisë si për shembull, sektorit të ndërtimit, ky zhvillim mund të shtojë vështirësitë e tyre. Megjithatë, efekti mund të jetë i administrueshëm, nëse realizohen objektivat e qeverisë për orientimin e një pjese të rëndësishme të shpenzimeve për projektet e mëdha të infrastrukturës, si edhe nëse realizohet një shpërndarje më e mirë në kohë e të ardhurave dhe e shpenzimeve të përgjithshme. Nëpërmjet politikës monetare, Banka e Shqipërisë do të ndjekë me vëmendje efektin e zhvillimeve të ndryshme ekonomike mbi nivelin e çmimeve, dhe do të veprojë në kohën e duhur dhe me instrumentet e nevojshme, për të mos lejuar qëndrueshmërinë e presioneve të mundshme inflacioniste.

Veçanërisht në pjesën e fundit të vitit 2007, tregjet financiare ndërkombëtare përjetuan një situatë mjaft të vështirë likuiditeti në afat të shkurtër, si rezultat i ekspozimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të disa institucioneve të rëndësishme financiare, në instrumentet që lidheshin me kredinë jocilësore për shtëpi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Humbjet e konsiderueshme financiare të shkaktuara në disa prej bankave dhe institucioneve financiare më të rëndësishme të botës, ngërçi në kreditim, si edhe shtrëngimi i kushteve të likuiditetit në tregjet ndërbankare, rritën mundësitë për ndikim negativ mbi sektorin real të ekonomisë, nëpërmjet rënies së konsumit dhe të investimeve nga ekonomitë familjare dhe shoqëritë e biznesit. Për këtë arsye, Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Banka Qendrore Evropiane si edhe disa banka të tjera qendrore, realizuan në bashkëveprim disa masa, për të lehtësuar përmbushjen e nevojave për financim afatshkurtër të bankave dhe të institucioneve të tjera financiare, me një rëndësi globale. Në të njëjtën kohë, administrata në Shtetet e Bashkuara të Amerikës bëri publik planin për miratimin e një pakete fiskale, e cila do të siguronte një stimul financiar prej rreth 150 miliardë dollarësh për ruajtjen e kërkesës së sektorit real të

ekonomisë. Qëndrimet ndaj ecurisë së normave bazë të interesit të bankave kryesore qendrore, krahas nevojës për lehtësimin e pasojave të krizës, u diktuan edhe nga ndryshimet në objektivat e politikës monetare dhe mënyrën e realizimit të tyre. Kështu, Rezerva Federale ktheu drejtimin e lëvizjes së normës bazë të interesit, duke realizuar tre ulje të saj në periudhën shtator-nëntor deri në nivelin 4.25 për qind. Ajo gjithashtu, shprehu gatishmërinë për të vijuar me ulje të tjera për të shmangur rënien e ekonomisë në recesion dhe rritjen e papunësisë. Ndërkohë, zhvillimet e pafavorshme inflacioniste në vendet e Zonës së Euros, diktuan qëndrimin e Bankës Qendrore Evropiane për të mos ulur normën bazë të interesit prej nivelit 4 për qind, i cili u ruajt deri në korrik 2008. Pritshmëritë për ngadalësim më të shpejtë të rritjes ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si edhe për një zgjerim të mëtejshëm të diferencave të normave të interesit midis Shteteve të Bashkuara dhe Zonës së Euros, ndikuan në dobësimin e përgjithshëm të dollarit amerikan kundrejt valutave të tjera, veçanërisht ndaj monedhës së përbashkët evropiane, euro dhe paundit britanik.

Kriza në tregjet financiare ndërkombëtare ka nxitur një proces të rivlerësimit të rrezikut, i dëshmuar në formën e rishikimit të vendimeve për investime dhe nëpërmjet riçmimit të disa instrumenteve, që përdoreshin gjerësisht më parë. Problemet e likuiditetit të gjeneruara nga kriza financiare, shkaktuan një rënie në vlerën e aktiveve për grupet e mëdha financiare dhe humbjet nga këto të fundit janë shtrirë edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2008. Shqetësimi i përgjithshëm për një ndikim të mëtejshëm në rënien ekonomike globale nëpërmjet tkurrjes së kreditimit, mbetet konstant. Projeksionet për rritjen makroekonomike të Eurozonës gjatë vitit 2008 janë ulur ndjeshëm, duke u vlerësuar në intervalin 2.1-2.3 për qind në janar 2008. Ndërkohë, rritja ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka rënë në nivelet 0.5-1 për qind. Bankat qendrore të ekonomive më të zhvilluara të botës kanë ndërhyrë edhe gjatë këtij viti, në mënyrë individuale dhe të harmonizuar, për të përmirësuar situatën e likuiditetit në këto tregje, nëpërmjet uljes së normave bazë të interesit dhe rishikimit të kuadrit rregullativ të operacioneve të tregut të hapur. Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka ulur normën bazë të interesit deri në nivelin 2.25 për qind. Megjithatë, këto përpjekje po dëmtohen nga presionet e larta inflacioniste, veçanërisht në vendet e Eurozonës, ku në muajin maj 2008 norma vjetore e inflacionit rezultoi 3.7 për qind. Ndonëse një rënie e lehtë e diferencave midis normave të interesit afatshkurtër dhe normave bazë të interesit në tregun ndërbankar global mund të jetë një tregues se situata më e rëndë e kësaj krize është kapërcyer, efektet e krizës në bilancet e institucioneve të rëndësishme financiare dhe kohëzgjatja e saj, mbeten ende të panjohura në mënyrë të plotë.

Hapja e ekonomisë dhe integrimi i sistemit financiar shqiptar në tregjet rajonale dhe globale, e rrit ndjeshmërinë e sistemit tonë financiar ndaj zhvillimeve të pafavorshme, në rajonin tonë ekonomik dhe në tregjet e huaja. Pavarësisht integrimit financiar, përgjithësisht investimet e grupeve të njohura financiare dhe bankare të vendeve të zhvilluara në tregjet në zhvillim, përfaqësojnë ende një vlerë të vogël në krahasim me vlerën e përgjithshme të grupit. Ky pohim vërtetohet veçanërisht për vendet në zhvillim që i përkasin

rajonit të Ballkanit. Ky fakt, si edhe mungesa e tregjeve të zhvilluara në vendet në zhvillim, kanë kufizuar ndikimin e krizës financiare në këto vende, të paktën në afat të shkurtër. Edhe në vendin tonë, të dhënat e fundit për bankat që zotërohen nga grupet bankare evropiane, nuk reflektojnë humbje financiare apo probleme që e kanë origjinën në krizën financiare që po kalojnë tregjet e zhvilluara. Situata e mirë e likuiditetit të bankave që operojnë në vendin tonë si edhe përdorimi mjaft i kufizuar i financimit nga ana e grupit, janë faktorë shtesë të cilët pengojnë transferimin e elementeve të krizës në banka dhe në institucione të tjera financiare të vendit.

Megjithatë, mundësia e përcjelljes së krizës së sektorit financiar në sektorin real të ekonomive partnere në tregti, paraqet një burim rreziku për sektorin bankar shqiptar. Kanalet me anë të të cilave mund të materializohet ky rrezik janë:

- *ndryshimi i shpejtë i diferencës midis normës së interesit të valutave kryesore dhe asaj të lekut, duke favorizuar më tej kredidhënien në valutë dhe financimin e saj nëpërmjet huamarrjes nga tregjet e huaja (ose grupi bankar zotërues).* Këto ndryshime mund të theksojnë më tej faktorët që mbështesin kredidhënien në valutë, dhe për të ruajtur pjesën e tyre të tregut e për të kontrolluar kostot e financimit, sektori bankar mund të zgjedhë të financohet nga tregu i jashtëm në valuta jokryesore (të ndryshme nga dollari amerikan dhe euro), me norma interesi relativisht më të ulëta. Këto lëvizje mund të shkaktojnë ashpërsimin e karakteristikave të rrezikut që mbart huadhënia e shpejtë dhe veçanërisht ajo në valutë, si rezultat i financimit në një valutë rreth të cilës nuk ekziston njohja e nevojshme nga ana e kredimarrësit, dhe i rritjes së madhësisë së vlerës së kështit të kredisë që duhet paguar, për kreditë me normë interesi të ndryshueshme. Ndjeshmëria e portofolit të kredisë në valutë ndaj një ndryshimi të mundshëm, të pafavorshëm të kursit të këmbimit, bëhet edhe më e madhe. Bankat ashtu edhe klientët e tyre huamarrës, duhet të ndjekin me kujdes dinamikën e zhvillimeve të këtyre faktorëve, dhe të kryejnë veprimet e nevojshme për t'u mbrojtur nga zhvillimi i tyre i pafavorshëm. Analiza "*stress-test*" mbi rrezikun e drejtpërdrejtë të ndryshimit të normës së interesit dhe analiza e rrezikut të tërthortë të kreditit nga ndryshimi i normave të huaja të interesit për valutat kryesore, tregojnë se sektori bankar në tërësi, paraqet një rezistencë të mjaftueshme ndaj këtyre rreziqeve. Megjithatë, banka të veçanta paraqesin një ndjeshmëri relativisht të lartë ndaj këtyre rreziqeve.
- *lëvizjet e kursit të këmbimit.* Përveç pasigurisë për vlerën e valutave kryesore (dollari amerikan dhe euro) që ekziston në tregjet ndërkombëtare për shkak të krizës financiare, drejtimi i ndryshëm i lëvizjes së normave bazë të interesit në kushtet e përparësive të ndryshme të bankave qendrore, ndodh të krijojë mundësi për lëvizje ekstreme të diferencës mes tyre, si edhe ndryshim të vlerës së tyre në raport me monedhën kombëtare. Megjithatë, ekspozimi i bankave ndaj kursit të këmbimit, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2007, ka pësuar ulje dhe analiza "stress-test" tregon se kapitali i sistemit bankar do të siguronte mbrojtje të mjaftueshme edhe për një zhvlerësim/vlerësim mjaft të madh të kursit të këmbimit si në

euro, ashtu edhe në usd. Për sa i përket rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ose rrezikut me të cilin përballen kredimarrësit në valutë të huaj, ai mund të jetë relativisht i lartë në pjesë të veçanta të sektorit bankar.

- *kombinimi i vështirësive në tregjet financiare ndërkombëtare, me dinamikën e pafavorshme të çmimeve të burimeve energjitike dhe të lëndëve të para të produkteve ushqimore në shkallë botërore.* Ky kombinim i padëshiruar, kufizon arsenalin e instrumenteve të bankave qendrore, për t'iu përgjigjur plotësisht kërkesës për likuiditet nga tregjet financiare ndërkombëtare; shton rrezikun që kjo situatë të ndikojë negativisht kërkesën globale për konsum dhe investime, si edhe mund të rezultojë në një ngadalësim të rritjes ekonomike në qendrat botërore të zhvillimit. Kjo situatë do të ndikojë në rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomitë e vogla, siç është ekonomia shqiptare, si edhe në shtrëngimin e termave të financimit të brendshëm dhe të jashtëm për agjentët e ndryshëm ekonomikë, duke përfshirë edhe qeveritë. Gjithashtu, ajo mund të diktojë uljen e të ardhurave dhe të punësimit në vendet e prekura nga ngadalësimi i rritjes ekonomike, duke sjellë një rënie në të ardhurat e emigrantëve dhe të punëtorëve sezonalë, dhe ulje të remitancave për ekonomitë në zhvillim, siç është ekonomia jonë. Përveç përkeqësimit të aftësisë paguese të huamarrësve në valutë, flukset e depozitave të reja në valutë do të binin dhe për pasojë, gjenerimi i burimeve të reja në valutë të huaj do të bëhej i mundur vetëm nëpërmjet mbajtjes së një niveli të lartë interesi për depozitat në valutë, ose huamarrjes në tregun e huaj. Nëse nga ana tjetër, nuk ka edhe një rritje të normës së interesit për kredinë në valutë, rreziku i normës së interesit do të rritet.
- *rishikimi i politikave të investimit në kuadër të rivlerësimit të rrezikut në përgjithësi, rënie e investimeve të huaja direkte.* Rivlerësimi i rrezikut si në sistemin financiar ashtu edhe në atë jofinanciar, në ekonomitë e zhvilluara do të sillte një ulje të interesit të investitorëve të huaj për të zgjeruar aktivitetin në ekonomitë në zhvillim, nëse perceptohet një pasiguri më e lartë e tyre për këto vende. Gjithashtu politikat e kredidhënies së bankave rezidente, të cilat kontrollohen nga institucionet financiare jorezidente, mund të ndryshojnë duke reflektuar më shumë qëndrimin e ri ndaj rrezikut të grupeve bankare se sa kushtet e brendshme të vendit ku ato operojnë.
- *ekspozimi i sistemit financiar ndaj sektorëve të ekonomisë që ndikohen negativisht nga rënia e mundshme e ekonomisë rajonale dhe globale.* Për këtë arsye, institucionet financiare jobanka dhe bankat, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre, duhet të monitorojnë përqendrimin e produkteve sipas sektorëve të ekonomisë (duke vlerësuar edhe ndikimin ndërsektorial), duke synuar shpërndarjen sa më të ekuilibruar të veprimtarisë dhe shmangien e përqendrimeve.

Sistemi financiar në Shqipëri, pati një rritje të qëndrueshme dhe përgjithësisht të ekuilibruar, gjatë vitit 2007, e mbështetur mirë nga infrastruktura ekzistuese. Rezultati i mirë financiar, si në sektorin bankar ashtu edhe në atë financiar jobankar, erdhi si rrjedhojë e përdorimit më të mirë të burimeve financiare dhe e vazhdimit të zgjerimit, relativisht të shpejtë, të veprimtarive me kthim të lartë nga investimi. Prirja afatgjatë për rënien graduale të treguesit të

kapitalizimit të sektorit financiar dhe veçanërisht të atij bankar ka vazhduar, por ritmi i rënies u ngadalësua. Kjo ecuri u përcaktua nga sjellja e bankave dhe e institucioneve financiare më aktive, në të cilat treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë gjenden pranë niveleve minimale, të kërkuara nga kuadri ligjor dhe rregullativ. Gjatë periudhës, vijoi hyrja e kapitalit të huaj në institucionet financiare dhe u konstatuan veprime të bashkimit institucional, të cilat mbështesin konsolidimin e tregut financiar.

Infrastruktura me rëndësi sistemike e sektorit bankar, e përfaqësuar nga sistemet e pagesave dhe të shlyerjeve që administrohen nga Banka e Shqipërisë, mbështeti mirë zhvillimin e veprimtarisë së sektorit bankar gjatë vitit të kaluar. Sistemi i shlyerjes së pagesave me vlerë të madhe AIPS dhe sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël AECH, nuk patën asnjë problem teknik për të përballuar shtimin e numrit të transaksioneve, ashtu si edhe gjatë viteve të mëparshme të funksionimit të tyre. Për kryerjen e transaksioneve të nevojshme në mënyrë eficiente, bankat shfrytëzuan më mirë lehtësitë që ofrojnë sistemet, siç është kredia brenda ditës. Gjatë vitit 2007, është zgjeruar edhe përdorimi i instrumenteve elektronike të pagesave, si rezultat i rritjes së përdorimit të kartave, rritjes së numrit të terminaleve të parasë fizike (ATM) dhe të pikave të shitjes (POS). Gjithashtu, ka gjetur një përdorim më të gjerë përfitimi i shërbimeve bankare "nga shtëpia", nëpërmjet aksesit të drejpërdrejtë elektronik, të mundësuar nga bankat për klientët e tyre, nëpërmjet internetit. Duke konsideruar rolin parësor të mirëfunksionimit të sistemeve të pagesave në stabilitetin e sistemit financiar, Banka e Shqipërisë ka mbikëqyrur me kujdes sistemet e pagesave si edhe ka kryer përmirësime teknologjike dhe rishikime të kuadrit rregullativ, me qëllim përmbushjen sa më të mirë të kërkesave të sigurisë dhe të eficiencës, që përcaktohen nga standardet evropiane.

Aktivet e sektorit financiar kanë njohur rritje të qëndrueshme, por pesha e sektorit financiar jobankar mbetet e ulët, duke kufizuar kontributin e këtij sektori në zhvillimin e qëndrueshëm të të gjithë sistemit financiar. Totali i aktiveve të sistemit financiar në fund të vitit 2007, vlerësohet të jetë pranë nivelit 78.5 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Pesha e sektorit bankar në të, llogaritet në 76 për qind, nga 69.4 për qind që ishte një vit më parë. Sipas vlerësimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, deri në muajin shtator 2007, vlerësohet që totali i aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, segment i cili mbizotëron në sektorin financiar jobankar, ishte rritur me 12 për qind, në nivelin 12.98 miliardë lekë. Me këtë rritje, vlerësohet që totali i aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, të licencuara në vendin tonë, ka përfaqësuar rreth 1.3 për qind të PBB-së. Kundrejt totalit të aktiveve të sektorit bankar, pesha e totalit të aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit ishte vetëm 1.9 për qind në të njëjtën periudhë, duke mos patur ndryshim në krahasim me fundin e vitit 2006. Sipas vlerësimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në fund të vitit 2007, treguesit e veprimtarisë së këtij segmenti të rëndësishëm të sektorit financiar jobankar, duke përfshirë përfitueshmërinë, aftësinë siguruese dhe kapitalizimin, kanë qenë pozitive dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ. Shkalla e penetrimit të produkteve të institucioneve financiare jobankare në tregun shqiptar, mbetet e ulët. Në këtë mënyrë, efekti pozitiv që ai jep, si një mekanizëm që përmirëson karakteristikat e rrezikut të

produkteve financiare dhe bankare, është i kufizuar. Megjithatë, vlerësohet që ky segment i tregut mbart një potencial të lartë zhvillimi në të ardhmen. Situata optimiste në tregun financiar jobankar, dëshmohet edhe nga interesi i shtuar i investitorëve të huaj institucionalë, veçanërisht në segmentin e këtij tregu të përfaqësuar nga veprimtaria e sigurimit dhe e risigurimit. Në sektorin bankar, gjatë gjashtëmujorit të kaluar janë finalizuar procedurat e bashkimit të dy bankave, si shprehje e procesit të mirëpritur të konsolidimit të veprimtarisë. Ndryshimet në strukturën e aksionerëve të institucioneve financiare, krahas miratimit të autoriteteve mbikëqyrëse dhe rregullative të secilit sektor, janë analizuar në lidhje me efektet në konkurrencën e tregut dhe janë miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës.

Sektori bankar ka zgjeruar më tej investimet në kredi dhe letra me vlerë. Ai ka ruajtur nivele të kënaqshme të kthyeshmërisë nga veprimtaria, por ka shfaqur rënie të lehtë të treguesve të kapitalizimit dhe të likuiditetit. Në fund të vitit 2007, portofoli i kredive të sektorit bankar arriti në pothuaj 40 për qind të totalit të aktiveve të sektorit, duke shënuar një rritje me 4 pikë përqindje, në krahasim me fundin e muajit qershor të vitit 2007. Investimet në letra me vlerë arritën në 18 për qind të totalit të aktiveve, duke u rritur me 1.6 pikë përqindje në krahasim me fundin e muajit qershor të vitit 2007. Në fund të vitit 2007, kthimi nga investimi i aktiveve mesatare rezultoi 1.6 për qind, ndërsa kthimi nga investimi mbi kapitalin aksioner rezultoi 20.7 për qind, pranë niveleve të shënuara në fund të vitit 2006. Cilësia e kreditimit, ndonëse është ndikuar negativisht nga ritmi i lartë i kreditimit që dikton konkurrenca në treg, ka ndryshuar pak në krahasim me fundin e muajit qershor 2007 dhe konsiderohet e mirë. Kredia në valutë vijon të mbizotërojë në portofolin e përgjithshëm të kredisë. Afati mesatar i maturimit të kredisë është zgjatur. Si rezultat i investimit në aktive me rrezik më të lartë, sektori bankar ruan prirjen vjetore të rënies së treguesve të kapitalizimit dhe të likuiditetit, ndonëse këta tregues konsiderohen në nivele të kënaqshme dhe janë mesatarisht më të lartë se ata të vendeve të tjera në rajon. Kapitalizimi i sektorit bankar në fund të periudhës, i përcaktuar sipas treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerësohet 17.1 për qind, duke rezultuar 0.9 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Aktivet likuide të sektorit bankar përfaqësojnë 49.8 për qind të totalit të aktiveve, duke shënuar një rënie prej rreth 7.8 pikë përqindjeje, në krahasim me fundin e vitit 2006.

Duke vlerësuar që niveli i përgjithshëm i rrezikut për sistemin financiar në vendin tonë është rritur, forcohet nevoja për zhvillimin e një tregu financiar eficient, i cili zgjeron kapacitetet e pjesëmarrësve të tregut dhe në përgjithësi të agjentëve ekonomikë, për të administruar efektivisht pasojat e një situate të pafavorshme financiare. Pamjaftueshmëria e zhvillimit aktual të tregut financiar, mund të shërbejë si një mekanizëm i natyrshëm mbrojtjeje ndaj përcjelljes së problemeve financiare midis segmenteve të ndryshme të tregut dhe në marrëdhëniet me tregjet financiare ndërkombëtare, por ky efekt do të jetë i përkohshëm. Për këtë arsye, pjesëmarresit e tregut duhet të kontribuojnë në ndërtimin e një tregu financiar të zhvilluar dhe eficient, pasi në këtë mënyrë rrisin mundësitë që të përcaktojnë realisht çmimin e produkteve të tyre, që të identifikojnë lëvizjet e ekzagjeruara në çmimin e mjeteve të ndryshme dhe që të realizojnë transaksionet e nevojshme, në madhësinë dhe në kohën e

duhur. Duke vepruar në këtë mënyrë, tregu ofron një mekanizëm efektiv dhe automatik, i cili zbut pasojat e një situate të vështirë financiare. Nga ana tjetër, nëpërmjet veprimeve të caktuara në një treg që vepron në mënyrë eficiente, bankat qendrore realizojnë më mirë objektivat e politikës së tyre monetare, duke i kontribuar stabilitetit të përgjithshëm financiar.

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 2007

Zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare dhe treguesit makroekonomikë të vendeve të zhvilluara, përgjithësisht shfaqën një situatë në përkeqësim të vazhdueshëm gjatë vitit 2007. Vendet në zhvillim kanë treguar një rezistencë të mirë në këtë situatë të pafavorshme. Shpërthimi i problemeve me kreditë hipotekare jocilësore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në muajin korrik të vitit të kaluar, i dha nxitjen një procesi zinxhir përkeqësimi i cili kulmoi me pakësimin e ndjeshëm, pothuaj të plotë, të likuiditetit në tregjet ndërbankare dhe me mungesën e plotë të tregtimit për disa instrumente të veçanta. Këto të fundit qenë krijuar për të lehtësuar financimin e vazhdueshëm të kredive hipotekare nga investitorë institucionalë (duke përfshirë bankat, fondet e investimit, ndërmjetësuesit e tjerë etj.) me preferenca të ndryshme për nivelin e rrezikut financiar dhe të kthimit nga investimi. Bankat qendrore kanë ndërhyrë për të ofruar likuiditetin e nevojshëm në treg. Paralelisht, rritja e kërkesës globale për produkte ushqimore, për lëndë të para dhe energji, e nxitur nga zhvillimi i shpejtë i vendeve si Kina, India, Brazili si edhe nga pasojat mbi ofertën e produkteve ushqimore të fenomenit të ngrohjes globale, rritën presionet inflacioniste veçanërisht në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet që e rrethojnë. Megjithatë, përgjithësisht në vendet në zhvillim, aktiviteti ekonomik u rrit në mënyrë të qëndrueshme si pasojë e politikave të përshtatshme makroekonomike, e përmirësimit të produktivitetit dhe rritjes së investimeve të huaja. Në tregjet e këmbimit valutor, dollari amerikan ka reflektuar problemet që po kalon ekonomia amerikane dhe pritjet për normat e interesit në tregjet e zhvilluara, duke u zhvlerësuar në këmbimin e tij me valutat kryesore dhe veçanërisht me euron.

2. 1. MJEDISI MAKROEKONOMIK

2.1.1 Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kriza financiare e shkaktuar nga rënia e çmimit të pasurive të paluajtshme u përhap me shpejtësi në ekonominë reale, nëpërmjet rivlerësimit të rrezikut, rënies së ofertës për kredi dhe rritjes së kostove të financimit të borxhit. Si rrjedhojë, mundësia për një kthesë në ciklin e kredisë dhe tkurrje të ekonomisë është rritur. Një rënie e kërkesës agregate amerikane, megjithatë pritet të rivendosë një ekuilibër më të mirë në tregtinë ndërkombëtare.

Rritja e deficitit tregtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe niveli relativisht i ulët i normave të interesit në periudhën 2000-2005, ndikoi në rritjen

e flukseve hyrëse të kapitalit dhe në rritjen e kërkesës së investitorëve për letra me vlerë të borxhit me kthim (dhe rrezik) të lartë, duke përfshirë letrat me vlerë të mbështetura mbi huatë hipotekare. Frenimi i rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe përkeqësimi i cilësisë së kredisë hipotekore për kredimarrës jocilësorë, shkaktoi probleme jo vetëm në këtë treg po edhe në tregjet e tjera financiare, të cilat për shkak të kompleksitetit dhe mungesës së transparencës së instrumenteve financiare të krijuara së fundmi, lidheshin ngushtë me ecurinë e kredive në këtë sektor. Goditja e ardhur prej tregut financiar përkeqësoi ndjeshëm gjendjen e disa prej institucioneve financiare më të mëdha, duke përfshirë banka të njohura për veprimtarinë e tyre globale dhe si rrjedhim, ndikimi në ekonominë reale vlerësohet të jetë i konsiderueshëm.

Gjendja financiare e familjeve ka pësuar një goditje të fortë, për shkak të rënies së çmimit të pasurive të paluajtshme ku ishin të mobilizuara pjesa më e madhe e kursimeve të tyre. Shumë prej tyre që kanë qenë huamarrës në banka, e kanë patur së fundi të pamundur të rinovojnë kushtet e kredive ekzistuese me terma më të favorshëm, dhe janë detyruar të pranojnë kushtet e reja që përfshijnë norma interesi më të larta. Për këtë arsye, numri i kredimarrësve familjarë që kanë deklaruar pamundësinë e shlyerjes së kredisë, është rritur ndjeshëm. Nga ana tjetër, gjendja financiare e sektorit të korporatave mund të përkeqësohet nga një kthesë e ciklit të kredisë dhe shtrëngimi i termave të financimit, si rezultat i rivlerësimit të rrezikut nga ana e institucioneve financiare dhe e bankave. Zgjatja e periudhës së shtrëngimit të kushteve të financimit për familjet dhe për korporatat, do të ketë një efekt të rëndësishëm në ngadalësimin e rritjes ekonomike.

Për të pakësuar efektet negative që kriza financiare mund të ketë mbi rritjen ekonomike, Rezerva Federale ka kryer në një kohë të shkurtër, disa ulje të normës bazë të interesit. Në të njëjtën kohë, administrata amerikane miratoi një paketë për pakësimin e taksave në nivelin 150 miliardë dollarë amerikanë, për të përmirësuar financat e familjeve dhe të korporatave. Pavarësisht këtyre masave, ekzistonin dyshime të forta se ekonomia amerikane do të pësonte një recesion ekonomik (rritje negative e ekonomisë për dy tremujorë rradhazi), në kapërcimin e viteve 2007-2008. Por, pavarësisht se rritja ekonomike është ngadalësuar ndjeshëm (pozitive, por më pak se 1 për qind), ekonomia amerikane nuk ka shënuar ende një tremujor me rritje ekonomike negative. Nga ana tjetër, rënia e kërkesës dhe ngadalësimi ekonomik, të shoqëruara me një zhvlerësim të monedhës amerikane në tregjet e huaja, pritet të ndikojnë mbi flukset hyrëse të kapitalit si edhe ato të tregtisë së mallrave. Përmirësimi i termave të tregtisë, pritet të zbusë deficitin tregtar dhe të rrisë kontributin pozitiv të tregtisë së jashtme në rritjen ekonomike. Së fundi, rritja e vazhdueshme e vlerës së produkteve të energjisë po nxit sjelljet inflacioniste, si edhe ka shtuar presionin mbi Rezerven Federale, për të rishikuar me vëmendje politikën e lirshme monetare të ndjekur gjatë vitit të fundit.

2.1.2 Vendet e Zonës së Euros

Në Evropë, aktiviteti ekonomik gjatë vitit të kaluar, si për vendet e zhvilluara të Eurozonës ashtu edhe për vendet në zhvillim në periferinë e saj, ka pësuar një

rënie të lehtë. Për shkak të krizës financiare, besimi i konsumatorëve shënoi një ulje gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike të Eurozonës gjatë vitit 2008, u rivlerësuan në rënie. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2007 dhe në fillim të vitit 2008, janë shfaqur presione inflacioniste të kahut të ofertës, të cilat paralajmërojnë një politikë neutrale ose shtrënguese të Bankës Qendrore Evropiane, pavarësisht pritjeve për një rënie të aktivitetit ekonomik.

Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2007 në vendet evropiane (tabelë 1) ka shënuar një rritje prej mesatarisht 3.7 për qind, duke rënë me 0.1 pikë përqindjeje në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rënie ka prekur si vendet e zhvilluara ashtu edhe vendet në zhvillim, të cilat gjenden në kufijtë e tyre. Rritja ekonomike ka ardhur kryesisht si pasojë e një kërkese të brendshme të lartë, sidomos në sektorët e ndërtimit dhe të transportit, dhe është mbështetur nga një mjedis financiar i favorshëm, që ka vazhduar për disa vjet rradhazi në Evropë. Reformat në tregun e punës dhe moderimi i rritjes së pagave në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, kanë mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës dhe uljen e papunësisë, duke siguruar kështu një fluks të qëndrueshëm të remitancave për vendet në zhvillim. Goditja e gjeneruar në tregun e pasurive të paluajtshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pritet të ketë ndikim edhe në ecurinë e korporatave jofinanciare të Eurozonës në të ardhmen, e përcjellë nëpërmjet vështirësive që kanë përjetuar disa prej institucioneve financiare të Eurozonës në formën e humbjeve të mëdha financiare nga ekspozimi në instrumentet e lidhura me huatë hipotekare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, ky ndikim pritet të jetë i moderuar.

Përcjellja e kësaj goditjeje së pari mund të ndodhë nëpërmjet shtrëngimit të kushteve të financimit (kredisë), si pasojë e përhapjes së goditjeve midis segmenteve të ndryshme të tregut financiar, pritjeve për një mjedis jo të favorshëm makroekonomik dhe një rritjeje të kostos së financimit të borxhit. Një gjë e tillë mund të ketë pasoja mbi kapitalin e koporatave në periudhat e ardhshme, në aktivitetin prodhues dhe në kthyeshmërinë e korporatave. Duke patur parasysh edhe levën e lartë financiare në disa sektorë - të nxitur nga një rritje e qëndrueshme ekonomike historike dhe interesa të ulët të borxhit - dhe rritjen e kostove të pagesës së borxhit, një situatë e tillë do të rriste probabilitetin e përkeqësimit të portofolit të huasë së institucioneve financiare, sidomos të huasë për bizneset me rrezik më të madh dhe për firmat e vogla. Kthyeshmëria e korporatave në të ardhmen pritet të mbetet e qëndrueshme, si rezultat i një kërkese të brendshme të qëndrueshme. Megjithatë, disa faktorë mund të veprojnë në uljen e kthyeshmërisë: rritja e çmimeve të naftës dhe e lëndëve të para dhe ulja e kërkesës agregate në ekonominë amerikane. Shqetësim gjithashtu, përbën mundësia e ndryshimeve të shpejta në ndjeshmërinë e tregut, që do të çonte në një rivlerësim/riçmim të rrezikut – një periudhë e gjatë e turbullirave në treg mund të ndikojë mbi aftësinë e firmave dhe të individëve për të marrë kredi, duke e ulur më shumë rritjen ekonomike.

Tabelë 1. Rritja e PBB-së dhe inflacioni në Evropë.

	PBB (rritja reale vjetore)			Inflacioni		
	2006	2007	2008	2006	2007	2008
Evropa	3.8	3.7	3.2	3.5	3.3	3.1
Vendet e zhvilluara evropiane	2.9	2.7	2.2	2.2	2.0	2.0
Vendet në zhvillim evropiane	6.6	6.3	5.7	7.2	6.8	6
Bashkimi Evropian	3.2	3.0	2.5	2.3	2.3	2.3
Eurozona	2.8	2.5	2.1	2.2	2.0	2.0
Austria	3.3	3.3	2.5	1.7	1.9	1.9
Italia	1.9	1.7	1.3	2.2	1.9	1.9
Greqia	4.3	3.9	3.6	3.3	3.0	3.2
Franca	2.0	1.9	2.0	1.9	1.6	1.8
Gjermania	2.9	2.4	2.0	1.8	2.1	1.8
Mbretëria e Bashkuar	2.8	3.1	2.3	2.3	2.4	2.0
Bosnja Herzegovina	6.0	5.8	6.5	7.5	2.5	1.9
Serbia	5.7	6.0	5.0	12.7	6.4	8.8
Kroacia	4.8	5.6	4.7	3.2	2.3	2.8
Maqedonia	3.0	5.0	5.0	3.2	2.0	3.0
Mali i Zi	8.3	6.9			4.2	
Kosova	3.8	1.7	6.2	0.7	1.3	-2.0

Burimi: Sipas vlerësimit të Bankës Qendrore Evropiane.

Ndërkohë, presionet inflacioniste janë bërë mjaft të ndjeshme. Në fund të vitit të kaluar, inflacioni në Eurozonë kapërceu ndjeshëm objektivin e Bankës Qendrore Evropiane, pranë nivelit 3.3 për qind, si rezultat i rritjes së çmimeve të naftës dhe të çmimeve të drithërave, veçanërisht në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Këto zhvillime të pafavorshme, diktuan qëndrimin e Bankës Qendrore Evropiane[1] për të mos ulur normën bazë të interesit prej nivelit 4 për qind, i cili u ruajt deri në fund të vitit. Në vendet evropiane në zhvillim, inflacioni ka qenë edhe më i lartë, duke sinjalizuar rrezikun për mbinxehje të ekonomisë, veçanërisht në ato vende që aplikojnë regjimin fiks të kursit të këmbimit.

Gjatë vitit 2008, ekziston mundësia e uljes së investimeve dhe konsumit, edhe pse parashikimet për sektorin e ekonomive familjare tregojnë rritje të qëndrueshme të punësimit dhe ulje në normën e papunësisë, që do të kontribuonin në një përmirësim të të ardhurave të disponueshme gjatë horizontit të parashikuar. Projeksionet makroekonomike të Bankës Qendrore Evropiane, të publikuara në mars 2008[2], parashikojnë një rritje mesatare reale ekonomike midis 1.3 dhe 2.1 për qind.

Në të ardhmen afatshkurtër, kushtet e stabilitetit financiar në Eurozonë nuk mund të përcaktohen me siguri. Ato do të varen nga zhvillimet në kushtet ekonomike - veçanërisht ato të tregut të shtëpive në Shtetet e Bashkuara të Amerikës – dhe nga mënyra se si bankat do t'i përgjigjen një mjedisi operacional, i cili përmban mjaft sfida të reja. E ardhmja gjithashtu, varet nga mënyra se si do të implementohen nismat dhe masat e ndryshme, që synojnë kthimin e besimit të sistemit financiar dhe rritjen e qëndrueshmërisë së tij, të ndërmarra si nga politikëbërësit ashtu edhe nga vetë industria financiare.

Ndikimi i tronditjes së tregjeve financiare mbi vendet në zhvillim, ka qenë i moderuar për shkak të ekspozimit të tyre të ulët ndaj fenomeneve që sollën krizën. Shpejtësia e kthimit në normalitet e gjendjes së likuiditetit në treg dhe

madhësia e rivlerësimit të rrezikut, do të përcaktojnë në të ardhmen efektet e tërthorta që tronditjet në tregjet financiare do të kenë mbi vendet në zhvillim.

Megjithatë, ekzistojnë disa faktorë që mund të rrisin shkallën e ndikimit të krizës financiare edhe mbi vendet në zhvillim. Ata lidhen kryesisht me mundësinë e reduktimit të flukseve hyrëse të kapitalit, si pasojë e rivlerësimit të rrezikut nga investitorët; përkeqësimin e termave të tregtisë dhe të hyrjes së remitancave, për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara partnere, dollarizimit të ekonomisë dhe efekteve që kjo sjell në valutën që përdoret për kreditim, si edhe shtrëngimit të kushteve të financimit në tregun e brendshëm, për shkak të vështirësive për të financuar veprimtarinë në tregjet e huaja të parasë. Sigurisht, që efekti i këtyre faktorëve do të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme, në varësi të strukturës së tyre të prodhimit, të strukturës së tregut financiar, të pozicionit në tregtinë e jashtme etj..

Nga sa më sipër, ekonomia shqiptare pritet të ndikohet nga zhvillimet në mjedisin e jashtëm makroekonomik. Efekti për sistemin tonë bankar, mund të vijë si nëpërmjet përkeqësimit të kushteve financiare të firmave dhe individëve ashtu edhe drejtpërsëdrejti, nëpërmjet përcjelljes së goditjeve nga tregjet financiare ndërkombëtare. Si rrjedhim, ngjarjet e mësipërme paralajmërojnë për një rritje të rrezikut të kredisë, të rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut normës së interesit. Ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj tyre, do të analizohet më hollësisht në pjesën 5 të këtij raporti.

2.2 TREGJET FINANCIARE

Në tregjet e parasë, nëpërmjet kthimit të huave në instrumente të tregtueshme dhe ripaketimit e rishitjes së tyre në disa etapa për investitorë me preferenca të ndryshme rreziku, lidhjet ndërmjet pjesëve të ndryshme të tregut financiar u forcuan, duke bërë që efektet e krizës financiare të përhapeshin me shpejtësi. Si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ashtu edhe në Eurozonë, normat afatshkurtra të interesit u rritën ndjeshëm, duke reflektuar mungesën e likuiditetit dhe ngushtimin e vëllimit të tregtimit, në një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve të tregut të parasë. Autoritetet monetare të huaja reaguan me qëllim stabilizimin e tregut: duke injektuar likuiditet (Banka Qendrore Evropiane, Rezerva Federale, Banka e Anglisë, Banka Kombëtare e Zvicrës) si edhe duke ulur normat bazë të interesit (Rezerva Federale), që sollën një stabilizim të përkohshëm. Megjithatë, rreziku i kreditimit dhe rreziku i likuiditetit, të shprehur nga pakësimi i vëllimit të tregtimit dhe niveli i lartë i normave të interesit për huamarrjet në afat të shkurtër, mbetën të ndjeshëm. Në të ardhmen, pritet një rikthim gradual në normalitet i likuiditetit, pasi të bëhen të njohura humbjet e institucioneve financiare, të lidhura direkt ose tërthorazi me tregun e letrave me vlerë, të mbështetura nga kreditë hipotekare dhe me pozicionet e tyre në lidhje me likuiditetin, si rezultat i riçmimit të rrezikut.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kriza financiare që lindi në tregun e huave hipotekare pati një ndikim të madh në tregun e parasë, si rezultat i lidhjes së ngushtë të instrumenteve financiare dhe i natyrës së biznesit të

institucioneve, që emetojnë këto instrumente (hapësira informuese 2.1). Normat e interesit afatshkurtër të tregjeve të parasë u rritën ndjeshëm siç tregohet edhe nga norma LIBOR (grafik 1), edhe pse pritshmëritë për normat e interesit shfaqën prirje rënëse. Për të përmirësuar kushtet e likuiditetit në tregjet financiare, për të mos lejuar shtrëngimin e skajshëm të termave të financimit, si edhe për të shmangur një tkurrje të ekonomisë, Rezerva Federale ka ndjekur një politikë agresive të uljes së normës bazë të interesit, si edhe të rishikimit të kuadrit të operacioneve të tregut të hapur. Në shtator të vitit 2007, krahu i lëvizjes së normës bazë të interesit ndryshoi, për të nisur një cikël të shpejtë uljeje. Deri në fund të vitit 2007, norma bazë e interesit kishte zbritur në nivelin 4.25 për qind, ndërkohë që në pjesën e parë të vitit 2008, ajo ka zbritur deri në nivelin 2.25 për qind. Për të rritur mundësitë e ofrimit të likuiditetit afatshkurtër në treg si edhe për të ruajtur kushtet e tregtimit për disa instrumente financiare, Rezerva Federale zgjeroi listën e mjeteve, që mund të përdoren si kolaterale nga ana e institucioneve financiare, që përfitojnë likuiditet nga banka qendrore. Ajo e rriti numrin e tyre, duke përfshirë edhe institucione financiare jobankare që janë aktive në transaksionet e tregtimit të letrave me vlerë dhe në sipërmarrjen e rrezikut. Megjithë veprimet e Rezervës Federale në përgjigje të krizës, kushtet e tregut mbetën të tendosura dhe pritshmëritë janë për një stabilizim gradual të tregut të parasë. Pasiguritë në vlerësimin e mjeteve financiare do të vazhdojnë të jenë prezente për aq kohë, sa madhësia e rivlerësimit të rrezikut dhe madhësia e humbjeve në bilancet e institucioneve financiare, dhe posaçërisht të bankave, të mbetet e panjohur plotësisht.

Hapësirë informuese 2.1: Lidhja midis instrumenteve financiare dhe përhapja e krizës financiare në segmente të ndryshme të tregut[3].

Përkeqësimi i kredive hipotekare në Shtetet e Bashkuara dhe rënia në vlerën e letrave me vlerë të mbështetura nga këto hua, u bë shkak i një tronditjeje të sistemit financiar që u përhap me shpejtësi në të gjitha segmentet e tij.

Tregu i parasë në Shtetet e Bashkuara ishte një ndër tregjet që u ndikua më shumë, duke qenë se pjesëmarrësit e tij filluan të shqetësoheshin për rrezikun e kredive që financonin këto letra me vlerë, dhe filluan të grumbullonin likuiditet në rast nevoje të papritur.

Një pjesë e madhe e kredive hipotekare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mbahen nga bankat ose institucionet e tjera, deri në maturim. Ato shiten tek investitorë të tjerë kundrejt fondeve likuide. Ky proces lejon bankat që të zgjerojnë me shpejtësi portofolin e tyre të kredisë, dhe të fragmentarizojnë rrezikun. Investitorët e financojnë blerjen e këtyre kredive nëpërmjet emetimit të disa letrave me vlerë, që njihen me emrin "Letra me vlerë të mbështetura mbi asete (Asset Backed Securities-ABS)". Nga vetë emri, kuptohet që këto letra me vlerë kanë karakteristikat e rrezikut të kredive që financojnë. Më tej, disa prej investitorëve i ripaketojnë ABS në Detyrime Borxhi të Kolateralizuar (Collateralized Debt obligations – CDO) dhe i rishesin këto letra me vlerë të ndara në transhe sipas profilit të rrezikut. Disa nga investitorët në CDO që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit, janë të ashtuquajturat Njësi të Investimit të Strukturuar (Structured Investment Vehicles- SIV), të cilat emetojnë borxh

për të financuar investimet e tyre dhe përdorin gjerësisht levën financiare për të rritur fitimet. Një pjesë e mirë e borxhit të emetuar nga SIV ka formën e letrave tregtare të mbështetura mbi aktivet (ABCP) – borxh afatshkurtër, i cili zakonisht blihet nga fondet e tregut të parasë dhe investitorë të ngjashëm nga pikëpamja rrezikpranuese. Vështirësitë në rinegocimin të ABCP nga SIV, krijuan mundësinë për shpërhapjen e krizës nga huatë hipotekare në tregun e parasë. Pasiguria në vlerësimin e mjeteve të emetuesve të ABCP edhe kur nuk kishte lidhje me tregun e huave hipotekare, i detyroi investitorët të eleminonin pozicionet e tyre në ABCP, duke blerë letra me vlerë likuide të qeverisë. Si rezultat, yieldi-i i bonove të thesarit dhe maturiteti i ABCP, që mund të emetoheshin rishtaz ra në mënyrë të ndjeshme. Si pasojë e pamundësisë për të gjetur fonde me afat më të gjatë, kompanitë emetuese të letrave tregtare iu drejtuan bankave me të cilat kishin nënshkruar marrëveshje për të përftuar likuiditet, duke shkaktuar probleme në tregun ndërbankar. Shumë banka jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës u përpoqën të këmbejnë likuiditetet e tyre nga euro, në dollarë, për të plotësuar nevojat e agjentëve të tyre në tregjet "swap" të valutave. Duke qenë se shitës të usd kishte shumë pak, problemet e likuiditetit qenë më të mprehta në këtë segment të tregut. I tërë procesi njihet me emrin "origjino për të shpërndarë" (originate-to-distribute" model) dhe i referohet faktit që një kredi vetëm sa lind (origjinohet) në një institucion financiar, por më pas, rreziku i kreditit shpërndahet nëpërmjet shitjes së kredisë tek investitorë të tjerë. Deri përpara krizës financiare, ky model konsiderohej i suksesshëm për shkak të mundësisë që kishin institucionet financiare të ndërmjetësonin me shpejtësi, duke siguruar fonde për të zgjeruar më tej kredinë ose investime të tjera.

Grafik 1. Norma vjetore LIBOR në usd.

(janar '07 - maj '08)



Burimi: Faqja e internetit e British' Bankers Association.

Në tregjet e zhvilluara të Evropës, pasojat e tronditjeve të tregut të letrave me vlerë të mbështetura mbi huatë hipotekare në Shtetet e Bashkuara, ndikuan qasjen ndaj rrezikut të investitorëve dhe për pasojë, u shoqëruan me luhatshmërinë e vlerës së aktiveve financiare në të gjitha tregjet. Në korrik 2007, deklarimet e mjaft bankave të njohura evropiane se ishin drejtpërdrejt të ekspozuara ndaj tregut hipotekar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose të ekspozuara në mënyrë të tërthortë nëpërmjet pozicioneve në letrat me vlerë të mbështetura mbi kreditë hipotekare, rritën pritshmëritë për rënien e aftësisë paguese të bankave si pasojë e humbjeve që mund të kishin realizuar. Si rezultat, vëllimi i tregtimit në instrumentet e tregut të parasë me afat më të gjatë dhe në marrëveshjet e riblerjes me institucionet e tjera, përveç atyre qeveritare, u ngushtua ndjeshëm. Goditjet u përhapën më vonë edhe në instrumentet me afat më të shkurtër se një javë, në të gjitha valutat (euro, paund britanik dhe franga zviceriane).

Interesat e instrumenteve afatshkurtra të tregut të parasë u rritën ndjeshëm mbi nivelin e normës bazë të interesit, të përcaktuar nga politika monetare dhe kushtet e tregut u shtrënguan më tej. Bankat hezitonin të jepnin kredi

në tregun ndërbankar, edhe për periudha mjaft të shkurtra kohe, për sa kohë nuk mund të identifikohej qartë ekspozimi i palës tjetër ndaj efekteve të krizës financiare. Në përgjigje të kësaj situate, Banka Qendrore Evropiane u angazhua në operacione rifinancimi, fillimisht me afat të shkurtër dhe më vonë me afat tremujor, për të çliruar tensionet në tregun e instrumenteve me afat më të gjatë. Këto veprime patën një efekt stabilizues në tregun afatshkurtër, megjithatë aktiviteti i tregut mbeti i kufizuar sidomos në instrumentet e pagarantuara të tregut ndërbankar.

Grafik 2. Diferenca midis normës së interesit për kredinë 3-mujore dhe 1-ditore, në pikë bazë (1 për qind = 100 pikë bazë), para dhe gjatë krizës.



Burimi: Bloomberg.

Në fillimet e krizës financiare, diferenca për normat e interesit për kredinë ndaj sektorit jofinanciar, në krahasim me sektorin financiar, ka qenë më e ngushtë. Kjo reflektonte gjithashtu, normat e ulëta të falimentimit të firmave jofinanciare, qëndrueshmërinë e fitimeve të korporatave dhe mungesën e ekspozimit të drejtpërdrejtë të firmave jofinanciare ndaj segmenteve të tregut financiar, që ndjenë goditjen më të madhe nga kriza financiare. Megjithatë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007, shumë agjenci renditëse filluan të ulnin renditjen e cilësisë së borxhit të korporatave, si rezultat i rivlerësimit të rrezikut, veçanërisht për letrat me vlerë të emetuara, që mbështeten nga aktive të tjera. Në përgjithësi, tregjet e kredisë në Eurozonë u karakterizuan nga një ulje e renditjes së korporatave, si rezultat i rivlerësimit të përgjithshëm të rrezikut nga investitorët, megjithë mungesën e ekspozimit të drejtpërdrejtë të sektorit jofinanciar ndaj fenomeneve që sollën krizën. Si rrjedhim, për të ardhmen e afërt është e pritshme një rritje e kostos së financimit për korporatat jofinanciare.

Grafik 3. Kursi i këmbimit euro/usd.

(janar '07 - maj '08)



Burimi: Faqja e internetit e Bankës Qendrore Evropiane.

2.3 TREGJET E KËMBIMIT VALUTOR DHE TË TREGTIMIT TË LËNDËVE TË PARA

Në tregjet e këmbimit valutor, përgjigjja e ndryshme e autoriteteve monetare ndaj kërcënimeve të krizës financiare, ekzistenca e presioneve inflacioniste - veçanërisht në Eurozonë, si edhe rritja e çmimit të produkteve të energjisë, janë shoqëruar me rritje të luhatshmërisë së kursit të këmbimit të monedhave të huaja dhe zhvlerësim të monedhës amerikane ndaj euros. Norma e rivlerësimit të euros ndaj dollarit u rrit me ritme të shpejta, gjatë tremujorit të kaluar (grafik 3). Në tregjet ndërkombëtare mbiçmimi i euros ndaj dollarit u kompensua me një nënçmim ndaj yenit japonez, duke reflektuar diferencat në normat e interesit afatmesëm dhe tronditjet e tregut financiar. Një ulje e perceptimit të rrezikut të likuiditetit në të ardhmen, mosvërtetimi i skenarëve negativë për ecurinë e ekonomisë amerikane, si

edhe masat e mundshme për frenimin e rritjes së çmimit për produktet e energjisë, mund të mbështesin tregtimin e monedhës amerikane në tregjet ndërkombëtare.

Çmimet e lëndëve të para, veçanërisht të naftës dhe të komoditeteve, përjetuan një rritje të lartë duke reflektuar rritjen e kërkesës nga vendet në zhvillim (Kina, India, Brazili dhe Rusia), kushtet më të shtrënguara të tregut, ashtu edhe tensionet politike në disa rajone të caktuara (Irak, Iran, Lindje e Mesme, Nigeri). Çmimet e naftës u rritën si pasojë e një kërkese rritëse dhe e ofertës së ulët nga vendet e OPEC. Pritshmëritë për të ardhmen, siç tregohen në kuotimet e tregjeve të kontratave të ardhshme dhe në tregjet derivative, sinjalizojnë se çmimet e naftës do të vazhdojnë të rriten, nëse nuk ka ndonjë ndryshim në politikat e OPEC ose një rënie në ritmin e rritjes së ekonomisë globale. Megjithatë, presionet në rritje të çmimeve të naftës pritet të zbuten nga një ngadalësim i mundshëm në ritmet e rritjes së ekonomisë globale.

2.4 SEKTORI BANKAR NË BOTË DHE NË EVROPË[4].

Fitimet e mjaft grupeve të mëdha bankare, u ndikuan nga kriza financiare, nëpërmjet humbjeve të shkaktuara nga ekspozimi ndaj instrumenteve dhe tregjeve të goditura nga kriza financiare. Mundësia e një kthese në ciklin e kredisë mbetet një burim i rëndësishëm i rrezikut dhe ekziston shqetësimi për një zvogëlim të të ardhurave nga interesi. Për grupet bankare evropiane, të cilat veprojnë në Shqipëri ende nuk njihen plotësisht pasojat e krizës, por të dhënat ekzistuese tregojnë një ndikim mjaft të moderuar.

Kriza në të cilën po kalon tregu i kredive, ka sjellë humbje financiare për industrinë bankare në të gjithë botën. Në të njëjtën kohë, këto banka janë përballur me nevojën për të rritur kapitalin, në mënyrë që të rivendosin ekuilibrin në bilancet e tyre dhe të respektojnë kërkesat rregullative. Bankat evropiane kanë shfaqur ndjeshmërinë më të madhe ndaj krizës, duke paraqitur humbjet më të mëdha si edhe kërkesat më të mëdha për kapital. Më pak të ekspozuara, kanë qenë bankat aziatike.

Në Evropë, përmirësimi i mëtejshëm i performancës financiare të grupeve bankare të mëdha e komplekse[5] (GBMK), gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, ndikoi në rritjen e aftësive të tyre për përballimin e goditjeve. Sidoqoftë, mbështetja gjithnjë e më e madhe e këtyre institucioneve në

Grafik 4. Humbjet e bankave të lidhura me krizën financiare që prej fillimit të vitit 2007 (në mld usd).



Burimi: Sipas vlerësimit të Bankës Qendrore Evropiane.

Grafik 5. Rritja e kapitalit nga bankat që prej fillimit të vitit 2007 (në mld usd).



Burimi: Sipas vlerësimit të Bankës Qendrore Evropiane.

burime të ardhurash jo nga interesi, i ka bërë fitimet e tyre më të ndjeshme ndaj ndryshimeve të papritura, në kushtet e tregjeve të kapitaleve dhe, për pasojë, më të luhatshme. Veç kësaj, varësia në rritje e disa prej GBMK-ve të Eurozonës nga depozita që nuk vijnë nga klientët e vegjël, mund t'i ketë ekspozuar ato ndaj një rreziku më të madh likuiditeti. Ndikimi i plotë i ndryshimit të vlerës së tregut, si pasojë e rrezikut të kreditimit që shpërtheu në gjysmën e dytë të vitit 2007, do të evidentohet vetëm në mënyrë graduale, por fitimet e mjaft prej GBMK-ve janë prekur negativisht dhe këto institucione mund të vazhdojnë të përballen me sfida likuiditeti në gjetjen e burimeve për financim.

Në rastin më të keq, humbja mund të arrijë deri në 300 për qind të të ardhurave neto të bankës ose rreth 15 për qind të vlerës së kapitalit aksioner të saj. Në grafikun e mëposhtëm, jepen vlerësimet për humbjet e bankave evropiane, sipas zonës së origjinës së tyre. Humbjet më të mëdha financiare, janë ndjerë nga grupet e mëdha dhe komplekse bankare që janë të regjistruara jashtë Zonës së Euros, kryesisht ato zvicerane. Nevojat për kapital të bankave evropiane, kanë reflektuar humbjet financiare të shkaktuara nga ekspozimi ndaj krizës financiare në tregjet globale. Stabilizimi gradual ose ngadalësimi i rritjes së kredidhënies për familjet dhe kompanitë jofinanciare, ashtu si edhe shenjat e një shtrëngimi në standardet e kredidhënies, janë shenja që bankat po veprojnë për t'u mbrojtur ndaj rrezikut të përkeqësimit të cilësisë së aktiveve të tyre. Sidoqoftë, është rritur pesha e problemeve të krijuara prej familjeve huamarrëse me të ardhura të ulëta si dhe prej kompanive të palistuara e me borxhe të larta, dhe ekspozimet e bankave ndaj këtyre huamarrësve do të kërkojnë në të ardhmen një ndjekje të kujdesshme.

Grafik 6. Humbjet e bankave evropiane që prej fillimit të vitit 2007 (në mld usd).



Burimi: Sipas vlerësimit të Bankës Qendrore Evropiane.

Grafik 7. Rritja e kapitalit nga bankat evropiane që prej fillimit të vitit 2007 (në mld usd).



Burimi: Sipas vlerësimit të Bankës Qendrore Evropiane.

Përtë ardhmen, përfundimi i fazave të implementimit të regjimit të Bazelit II në fillim të vitit 2008, së bashku me standardet kontabël IFRS[6], do të shërbejë për të forcuar më tej transparencën e raportimit finaciar dhe të praktikave të administrimit të rrezikut, nga ana e GBMK-ve të Eurozonës. Me gjithë ndryshimet strukturore, kjo krizë tregoi edhe një herë nevojën që bankat të kenë plane kontingjente likuiditeti për raste krizash si dhe të kenë hequr mënjanë kapital të mjaftueshëm për ekpozimet ndaj rrezikut të kreditit të partnerëve të tyre. Gjithashtu, nevojitet një investim i vazhdueshëm nga ana e GBMK-ve në metodat dhe praktikat e analizave "stress-test" dhe të skenarëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu ato për rrezikun e likuiditetit.

2.5 GRUPET BANKARE EVROPIANE QË VEPROJNË NË SHQIPËRI

Në lidhje me gjendjen financiare të grupeve bankare evropiane që veprojnë në Shqipëri, sipas të dhënave që disponohen, rezulton që kriza e huave hipotekore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ka sjellë pasoja të rëndësishme në bilancet e tyre. Në hapësirat informuese 2.2 dhe 2.3, janë paraqitur vlerësime të këtyre grupeve bankare dhe prononcimet e bankave qendrore të Italisë dhe të Greqisë për impaktin e krizës financiare në bankat e këtyre vendeve. Në të dyja rastet ndikimi vlerësohet si i moderuar. Megjithatë, duhet patur parasysh se pasojat përfundimtare të krizës në bilancet e bankave duan ende kohë të shfaqen në mënyrë të qartë.

Vlerësojmë që situata e vështirë që po kalojnë tregjet ndërkombëtare financiare, përfaqëson një element të ri rreziku për sistemin financiar shqiptar, por ndikimi i saj do të bëhet i ndjeshëm për ekonominë shqiptare dhe sistemin tonë financiar, nëse ajo shndërrohet në një krizë globale me pasoja në ekonominë reale botërore dhe veçanërisht në atë evropiane, duke zgjatur në kohë. Aktualisht, ndikimi në sistemin tonë financiar dhe në sektorin bankar, ka qenë mjaft i moderuar në kushtet kur:

a) ka një zhvillim relativisht të ulët të tregut të brendshëm financiar dhe mungojnë produktet e ngjashme e të sofistikuara, vlera e të cilave u trondit së fundi në tregjet ndërkombëtare financiare. Theksojmë gjithashtu, që kuadri rregullativ mbikëqyrës i veprimtarisë bankare në vendin tonë, nuk parashikon në asnjë rast trajtimin e diferencuar të huamarrësve (dhe të kredive që ata marrin) për shkak të perceptimit si "të mirë" dhe "më pak të mirë", duke përfshirë ata që kërkojnë ose përfitojnë një hua për blerjen apo zhvillimin e pasurive të paluajtshme. Përkundrazi, kuadri rregullativ mbikëqyrës orienton bankat drejt analizës financiare të huamarrësit, pavarësisht karakteristikave të tij dhe objektit të huasë, duke vendosur disa kërkesa bazë dhe unike të cilat bankat duhet t'i zbatojnë në çdo rast;
b) gjetja e burimeve të financimit në tregjet financiare ndërkombëtare nga ana e institucioneve financiare shqiptare dhe posaçërisht nga sektori bankar është mjaft i ulët, në kushtet kur ka ende hapësirë për të siguruar financimin e zhvillimit të veprimtarisë nga burimet e brendshme. Pesha më e ulët e kredisë ndaj depozitave të sektorit bankar si edhe ndaj PPB-së, në krahasim me vendet e zhvilluara evropiane dhe disa prej vendeve të rajonit, dëshmojnë këtë fakt;
c) mungon një ekspozim i drejtpërdrejtë i institucioneve financiare shqiptare, dhe posaçërisht i bankave, në institucione të tjera dhe në produkte financiare, vlera e të cilave është ndikuar negativisht nga vështirësitë e likuiditetit në tregjet financiare ndërkombëtare. Nëse një ekspozim i tillë mund të rezultojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga një kategori e caktuar e portofolit të letrave me vlerë të borxhit në valutë, ndikimi i tij bëhet i parëndësishëm për shkak të peshës së ulët të këtyre investimeve për secilën bankë dhe sektorin bankar në përgjithësi, si edhe gjendjes së mirë financiare të sektorit bankar;
d) ekspozimi i grupeve bankare evropiane që veprojnë në Shqipëri, ndaj

skemës dhe produkteve të financimit të huave "sub-prime" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është i kufizuar dhe financiarisht i përballueshëm. Të dhënat financiare të deritanishme që janë publikuar nga vetë këto institucione, nga analistë të ndryshëm të tregut, si edhe nga autoritetet mbikëqyrëse të vendit të origjinës, konfirmojnë këtë vlerësim;

e) performanca e mirë financiare e viteve të fundit e institucioneve financiare dhe e grupeve bankare evropiane, ka krijuar një mbrojtje të mirë financiare nëpërmjet krijimit të rezervave të nevojshme dhe kapitalizimit të bollshëm të veprimtarisë, për të absorbuar goditje të tilla.

Hapësirë informuese 2.2: Grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri.

1. Raiffeisen Bank (Austri)

Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) është banka e tretë më e madhe në Austri. Me qendër në Vjenë, ajo përbën institucionin qendror të grupit bankar Raiffeisen (RBG).

Fitimi i konsoliduar u rrit në mënyrë të ndjeshme në vitin 2007, me 42 për qind ose 248 milionë euro, krahasuar me një vit më parë, duke përjashtuar veprimet e jashtëzakonshme. Kjo shifër arriti në 841 milionë euro këtë vit, krahasuar me 594 milionë euro në 2006-ën. Veprimet e jashtzakonshme të vitit të kaluar lidhen me shitjet e Raiffeisenbank Ukraine (486 milionë euro) si dhe pjesën e pakicës në një bankë në Kazakistan (102 milionë euro). Si pasojë e mosshpërndarjes së fitimit të vitit të kaluar dhe rritjes së kapitalit në vitin 2007, kapitali aksioner u rrit ndjeshëm dhe si pasojë, kthimi nga kapitali aksioner ra me 1.6 pikë përqindjeje, në 25.7 për qind.

Raiffeisen International është ajo pjesë e grupit që administron rrjetin e bankave në Evropën Qendrore e Lindore, ku Raiffeisen ka 12.7 milionë klientë. Në tetë prej tregjeve të këtij rajoni, bankat e grupit renditen ndër tre të parat e tregut, ndërsa në Shqipëri e Serbi zënë vendin e parë. Raiffeisen International nuk është prekur drejtpërsëdrejti nga kriza financiare, por çmimi i aksioneve gjatë tremujorit të parë `08 është ndikuar negativisht prej saj. Në fund të marsit `08, ajo përbëhej nga një total prej 16 bankash dhe 17 compani leasing. Shifrat e marsit `08 i tejkaluan pritjet e analistëve, duke kontribuar në rritjen e çmimit të aksioneve të Raiffeisen International. Fitimi i konsoliduar neto arriti në 254 milionë euro, një rritje prej 32 për qind krahasuar me një vit më parë – ky rezultat ka ardhur vetëm si pasojë e rritjes organike. Kthimi nga kapitali aksioner u zvogëlua me 3.2 pikë përqindjeje, në 22.5 për qind, krahasuar me tërë vitin 2007: kjo për shkak të rritjes së kapitalit aksioner, por edhe të mosshpërndarjes së fitimit vitin e kaluar. Instrumentet derivative sollën një humbje prej 37 milionë eurosh nga zhvlerësimi. Provigjonet për humbje nga zhvlerësimi u rritën me 23 për qind ose 17 milionë euro, duke arritur në 93 milionë euro.

Raiffeisen Albania zë rreth 2.68 për qind të totalit të aktiveve të Raiffeisen International, dhe rreth 31 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

2. Intesa Sanpaolo (Itali)

Intesa-Sanpaolo është banka e parë në të gjitha segmentet e tregut bankar italian, me një pjesë tregu prej 19 për qind të kredive dhe të depozitave. Për nga kapitalizimi, zë vendin e katërt në Eurozonë, me rreth 60.7 miliardë euro (31 dhjetor 2007). Grupi ka një prani strategjike në Evropën Qendrore e Lindore dhe në rajonin e Mesdheut, në 12 vende, me rreth 7.2 milionë klientë e me mbi 1,200 degë.

Të ardhurat neto të konsoliduara për vitin 2007 arrijnë në mbi 7.2 miliardë euro, duke përfshirë këtu fitimet nga shitjet e pjesëve të grupit (e njëjta shifër për 2006-ën: 4.7 mld euro). Marzhi i fitimit operativ ka patur një rritje prej 5.5 për qind, duke arritur në 8,740 milionë euro. Ekspozimi neto ndaj produkteve të strukturuara të kredisë, me bazë ato subprime është madje negativ, në një masë prej 49 milionë eurosh më 31.12.07 (si pasojë e kombinimit të një pozicioni "në blerje" prej 73 milionë eurosh, me një pozicion "në shitje" prej 122 milionë eurosh). Të ardhurat neto në tremujorin e parë të vitit `08 arritën në 1.7 miliardë euro (në fund të tremujorit të parë `07: 4 miliard euro). Nëse do të përjashtohej fitimi nga tregtimi i letrave me vlerë, mjaft më i lartë gjatë tremujorit të parë të vitit të kaluar, kjo shifër do të tregonte një rritje prej 34.2 për qind. Marzhi i fitmit operativ ka rënë me 7.1 për qind krahasuar me një vit më parë. Ekspozimi neto ndaj produkteve të strukturuara të kredisë që bazohen në ato subprime, vazhdon të jetë negativ (28 milionë euro) edhe në fund të marsit `08. Për të përballuar krizën financiare, Intesa-Sanpaolo u mbështet mbi bazën e fortë të depozitave të klientëve si dhe mbi pozicionin e shëndetshëm të likuiditetit e kapitalin bazë. Efekti kryesor negativ i krizës ka qenë zhvlerësimi i disa letrave me vlerë.

Banka Amerikane e Shqipërisë zë rreth 0.15 për qind të totalit të aktiveve të grupit Intesa-Sanpaolo, dhe rreth 14.5 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

3. Emporiki Bank (Greqi)

Kapitali aksioner i Emporiki Bank zotërohet në masën 72 për qind nga Grupi Bankar "Credit Agricole". Emporiki Bank është aktive në tregjet e kapitalit dhe të parasë brenda e jashtë Greqisë. Ka 370 degë në Greqi dhe 54 degë në Qipro, Rumani, Bullgari e Shqipëri. Emporiki ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare e financiare, si leasing, administrim portofoli, administrim pasurish të paluajtshme etj.. Në fund të vitit 2007, fitimi neto i grupit arriti në rreth 48.5 milionë euro (nga një humbje prej 238 milionë eurosh një vit më parë), ndërsa kapitali aksioner në 840 milionë euro. Portofoli i kredive ka patur një rritje në bazë vjetore prej 27 për qind në tremujorin e parë `08, kundrejt një rritjeje prej 13.7 për qind gjatë vitit 2007. Impakti i rivlerësimit të portofolit prej 24 milionë euro në tremujorin e parë si dhe një rritje në koston e financimit, sollën një rezultat negativ neto prej 15.3 milionë eurosh. Humbjet e portofolit, 24 milionë euro gjithsej, pasqyrojnë kryesisht humbje të parealizuara, si pasojë e rivlerësimeve sipas tregut, të lidhura me zhvillimet e pafavorshme në tregun e letrave me vlerë. Për sa i takon pranisë ndërkombëtare, gjatë tremujorit të parë, portofoli total i kredive në tri vende ballkanike (Shqipëri, Bullgari, Rumani) si dhe në Qipro u rrit me 7.1 për qind, ndërkohë që totali i depozitave u rrit me 4.5 për qind. Renditja afatgjatë e grupit, është rritur nga A në A+ nga ana e agjencisë së njohur të renditjes Standard&Poor's.

Banka Emporiki në Shqipëri zë rreth 0.64 për qind të totalit të aktiveve të grupit Emporiki.

4. Credit Agricole SA (France)

Për vitin 2007, Credit Agricole prodhoi një fitim neto prej 4,044 milionë eurosh. Ky rezultat, ndonëse paraqet një rënie prej 16.8 për qind, provon qëndrueshmërinë e grupit në kuadrin e krizës financiare ndërkombëtare. Ai reflekton forcën e modelit të tij, që bazohet në mbajtjen e një ekulibri ndërmjet tre linjave kryesore të biznesit (shërbime financiare të specializuara dhe shërbime bankare për koorporata dhe investime). Impakti negativ i krizës mbi të ardhurat në aktivitetet e tregut të kapitalit u neutralizua nga një rritje e qëndrueshme e të gjitha linjave të tjera të biznesit. Në total, të ardhurat neto nga veprimtaria bankare u rritën me 3.6 për qind. Në rast se do të përjashtohej impakti i krizës, të ardhurat neto nga veprimtaria bankare do të ishin rritur me 25.5 për qind dhe të ardhurat operative bruto do të ishin rritur me 30.5 për qind. Kjo performancë mjaft e mirë operative provon cilësinë e rritjes së linjave të ndryshme të biznesit dhe në veçanti, të kontributeve ndërkombëtare. Grupi është i diversifikuar, por zgjerimi i tij i shpejtë ka krijuar disa dobësi: është ende e paqartë nëse modeli i decentralizuar i bankave që ofrojnë shërbime më të specializuara, mund të zbatohet në mënyrë të suksesshme tek bankat e centralizuara që i janë shtuar grupit, siç është rasti i bankës Emporiki. Rezultatet e tremujorit të katërt u prekën ndjeshëm nga kriza e tregjeve të kredisë dhe kompania Calyon regjistroi një zhvlerësim të jashtëzakonshëm prej 3.3 miliardë eurosh, të lidhur me aktivitetet e saj në tregjet e kapitalit. Si pasojë, rezultati neto i Credit Agricole ishte një humbje prej 857 milionë eurosh, për tremujorin e fundit. Me qëllim që të mbështetej plotësisht rritja e linjave të biznesit, Drejtori i Përgjithshëm propozoi që një pjesë e fitimeve kapitale të ardhura nga dy shitje, të shkonin për të forcuar administrimin e rrezikut dhe sistemet e kontrollit brenda grupit.

Në tremujorin e parë të `08-ës, të ardhurat neto arrijnë në 892 milionë euro. Zhvlerësimet e portofolit subprime janë të konsiderueshme: 1,249 mijë euro (krahasuar me 4 290 mijë në 2007) dhe kanë patur një impakt negativ mbi të ardhurat neto nga aktiviteti bankar si edhe të ardhurat operative bruto (-56.6 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar). Linjat e biznesit, duke përjashtuar shërbimet bankare për koorporata dhe investime, kanë shfaqur qëndrueshmëri në klimën ekzistuese, duke patur të ardhura bruto pothuajse aq sa në tremujorin e parë të vitit '07 (1.5 mld euro).

Banka Emporiki në Shqipëri zë rreth 0.01 për qind të totalit të aktiveve të grupit Credit Agricole, dhe rreth 2.8 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

5. Piraeus Bank (Greqi)

Fitimi neto i grupit për vitin 2007 pati një rritje prej 50 për qind krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 652.6 milionë euro. Edhe treguesi i kthimit nga kapitali (RoE) ka arritur në 29.5 për qind (nga 29 për qind në vitin 2006). Problemet në tregjet financiare ndërkombëtare e gjetën grupin Piraeus me një përmirësim si të mjaftueshmërisë së kapitalit, ashtu edhe të likuiditetit; me një raport të kredive ndaj depozitave prej 127 për qind në fund të vitit 2007, krahasuar me 130 për qind tremujorin e kaluar. Portofoli i kredive u rrit me 48 për qind, ndërsa depozitat me 33 për qind krahasuar me një vit më parë, duke shënuar një rritje të ndjeshme në tremujorin e fundit të vitit 2007. Raporti i kredive me probleme ishte 2.05 për qind (2.37 për qind në fund të vitit 2006). Raporti i mbulimit të kredive me probleme nga provigjonet e akumuluara është 66 për qind; i njëjti raport e tejkalon ndjeshëm shifrën 100 për qind, në rast se merren parasysh kolateralet. Në tremujorin e parë të vitit 2008, norma e rritjes së depozitave arriti në 39 për qind (krahasuar me një 1 vit më parë), ajo e kredive mbeti në 48 për qind dhe e fitimit arriti në 46

për qind, duke përjashtuar fitimin e jashtëzakonshëm nga shitja e aksioneve në Bankën e Qipros. Për sa i takon vëllimit të aktiviteteve ndërkombëtare, ai ka patur ekspansion: portofoli i kredive u rrit me 106 për qind, depozitat me 71 për qind krahasuar me një vit më parë. Rrjeti i degëve u zgjerua nga 545 në mars '07, në 782 në mars '08 (43 për qind), nga të cilat 322 në Greqi dhe 460 jashtë. Vetëm gjatë tremujorit të parë '08 u vendosën 38 degë të reja. Kreditë me probleme të grupit arritën në 2.0 për qind në fund të marsit '08 (krahasuar me 2.1 për qind në fund të '07-ës). Raporti i mbulimit të tyre nga provigjonet e akumuluara është 69 për qind dhe tejkalon 100 për qind kur merren parasysh kolateralet. Treguesi kredi/depozita të klientëve u përmirësua: 122 për qind në fund të marsit 08, nga 127 për qind në fund të vitit '07.

Tirana Bank zë rreth 1.19 për qind të totalit të aktiveve të grupit Piraeus Bank, dhe rreth 9.6 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

6. Banka Kombëtare e Greqisë (Greqi)

NBG ka rrjetin bankar më të madh në Greqi, i cili me 571 banka mbulon të gjithë vendin. Me shtrirjen në Evropën Juglindore, rrjeti jashtë vendit përfshin 989 banka. Që prej vitit 1999, NBG është e listuar në Bursën e New York.

Në tremujorin e fundit të vitit '07, NBG raportoi një fitim neto prej 312 milionë eurosh. Kontributi i bankave vepruese në Evropën Juglindore në rritje ishte rreth 41 për qind, në një shumë prej 155 milionë eurosh si fitim neto. Kjo u shkaktua kryesisht nga rritja e kredidhënies. Fitimi neto për gjithë vitin 2007 arriti në rreth 1,644 milionë euro.

Ndonëse aktiviteti kreditues i grupit në fund të vitit 2007 kishte shënuar një rritje 28 për qind me një vit më parë, ndërkohë që depozitat ishin rritur me 13 për qind, raporti i kredive ndaj depozitave ka qëndruar në nivelin 93 për qind, një ndër më të ulëtit në Evropë. Ky raport i ulët siguron një burim financimi për ekspansionin e ardhshëm të grupit. Cilësia e portofolit të kredive shënoi përmirësim: raporti i kredive me probleme zbriti në 3.4 për qind (nga 3.6 për qind në tremujorin e tretë të vitit). Në Evropën Juglindore ky raport zbriti në 4.3 për qind (nga 4.9 për qind në tremujorin e tretë).

Në kushtet aktuale të tregjeve ndërkombëtare të parasë e kapitalit, NBG ka një përparësi konkurruese, për faktin se aftësia e saj kredidhënëse si dhe kostot e financimit nuk janë prekur nga kriza aktuale e likuiditetit. NBG nuk ka ekspozim ndaj instrumenteve amerikane subprime apo kategorive të tjera me rrezik të aktiveve, me gati të gjithë portofolin e letrave me vlerë të investuar në obligacione të Qeverisë Greke.

Fitimi neto i grupit në tremujorin e parë të vitit 2008 u rrit, duke arritur në 423 milionë euro, në rritje prej 25 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kthimi mbi kapitalin aksioner arriti në 28 për qind, 5 për qind më tepër sesa një vit më parë. Fitimi nga veprimtaria brenda Greqisë arriti në 255 milionë euro (+8 për qind krahasuar me tremujorin e parë të '07-ës), ndërkohë që fitimi në Evropën Juglindore u rrit me 72 për qind, duke arritur shifrën 50 milionë euro e duke përfaqësuar 12 për qind të fitimit të grupit. Me gjithë konkurrencën e fortë në tregun e depozitave dhe rritjen që pasoi në kostot e financimit, marzhi neto i interesit arriti në 4.31 për qind, pa ndryshuar nga shifra e tremujorit të fundit të '07-ës, por duke shënuar rritje nga 4.19 për qind në tremujorin e parë të vitit '07. Kredidhënia totale e grupit arriti në 57.1 miliardë euro në mars 2008, një rritje kjo

prej 25 për qind krahasuar me portofolin e marsit '07. Kreditë e reja gjatë tremujorit në fjalë, për të gjitha segmentet, përbëjnë dyfishin e treguesit të një tremujori më parë. Rritja e shpejtë e kredive nuk ka ndikuar negativisht mbi cilësinë e aktiveve. Treguesi i kredive të këqija për grupin mbetet në nivelin 3.5 për qind, i pandryshuar nga fundi i vitit '07 dhe 0.5 pikë përqindjeje më poshtë krahasuar me marsin '07. Depozitat e klientëve u rritën me 13 për qind nga një vit më parë, duke arritur në 60.5 mld euro. Si rezultat, raporti i kredive me depozitat arriti në 92 për qind (nga 82 për qind në fund të marsit '07).

Performanca solide e grupit në tremujorin e parë të '07-ës, veçanërisht përsa i takon të ardhurave nga interesi, vë në dukje qëndrueshmërinë e treguesve kryesorë të grupit, të cilët mbetën të paprekur nga problemet ndërkombëtare në tregun e kredive.

Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë në Tiranë, përfaqëson rreth 0.28 për qind të totalit të aktiveve të grupit NBG, dhe rreth 5.9 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

7. Societe Generale (Francë)

Gjatë vitit '07, të ardhurat e grupit zbritën me 2.8 për qind krahasuar me një vit më parë, për shkak të krizës financiare amerikane. Fitimi neto i grupit arriti në 947 milionë euro (81.9 për qind më pak sesa një vit më parë). Ndërkohë, për shkak të një mashtrimi financiar me përmasa gjigante nga ana e një trader-i të shoqërisë, tremujori i fundit i vitit 2007 shënoi humbje të jashtëzakonshme prej 4.9 miliardë eurosh. Gjithashtu, pjesa "Corporate and Investment Banking" e grupit u prek nga pasojat e krizës financiare amerikane, duke e mbyllur vitin me një humbje financiare neto prej 2,221 milionë eurosh. Ndërkohë, një kontribut pozitiv dhanë rezultatet e arritura në Evropën Juglindore: të ardhurat neto të grupit në këto vende u rritën me 17.3 për qind pa përfshirë Rusinë, dhe me 58.3 për qind në Rusi.

Fakti që me gjithë problemet e lartpërmendura, Societe Generale arriti ta mbyllë vitin 2007 me një fitim neto, tregon qëndrueshmërinë e burimeve të të ardhurave për të si dhe diversifikimin e portofolit të aktiviteteve të tij.

Gjatë tremujorit të parë '08, Societe Generale administroi pasojat e mashtrimit financiar të lartpërmendur. Injektimi i një kapitali prej 5.5 mld euro ka bërë që grupi t'i rekuperojë sërish treguesit e aftësisë paguese drejt një niveli të kënaqshëm si dhe të promovojë një komunikim të mirë staf-klient, duke hyrë sërish në rrugën e zhvillimit. Fitimi neto i grupit arriti në 1,096 milionë euro, në rënie -23.4 për qind. Të ardhurat neto të aktivitetit bankar për tremujorin arritën në 5,679 milionë euro, në rënie prej 8.6 për qind krahasuar me tremujorin e parë të '07-ës, që ka qenë mjaft i suksesshëm. Zhvillimet në krizën financiare amerikane si dhe tensionet e tregut të kredive kanë patur një impakt të kufizuar mbi të ardhurat e konsoliduara të Grupit – ky impakt vlerësohet në -231 milionë euro dhe lidhet me sektorët "Shërbime Bankare për Koorporata dhe Investime", si dhe "Administrimi i Aktiveve". Bizneset e tjera të grupit kanë patur të ardhura të qëndrueshme ose në rritje.

Banka Popullore zë rreth 0.03 për qind të totalit të aktiveve të grupit Societe Generale, dhe rreth 4.6 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

8. Alpha Bank (Greqi)

Alpha Bank përbën një ndër bankat kryesore në Greqi. Me 675 degë, grupi është i pranishëm edhe në tregun ndërkombëtar, si në Qipro, në Evropën Juglindore, në SHBA, Mbretërinë e Bashkuar etj.. Banka realizoi një fitim neto për vitin 2007 prej 850 milionë eurosh, një rritje prej 44 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm. Në vitin 2007, 85 për qind e borxhit të emetuar ishte me cilësi të lartë, por në vitin 2008 planifikohet ekspozimi prej 1.5 miliardë euro në letra me vlerë të mbështetura mbi të ardhurat nga kreditë hipotekore (covered bonds), të cilat zakonisht kanë një renditje të lartë (AAA).

Fitimi neto në tremujorin e parë të vitit '08 u rrit me 18 për qind, në 205 milionë euro. Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 24.9 për qind, në 374.4 milionë euro, ndërkohë që marzhi u zgjerua me 30 pikë bazë. Kreditë neto u rritën me 31.1 për qind, në 44.4 miliardë euro, për shkak të 2.3 miliardë kredive të reja gjatë tremujorit të parë, nga të cilat 1.3 miliardë në Greqi dhe 0.9 miliardë në Evropën Juglindore. Fitimi bruto nga veprimtaria në Evropën Juglindore arriti në 42.9 milionë euro, një rritje prej 74 për qind dhe përbën 16.5 për qind të fitimit bruto në nivel grupi. Kreditë dhe depozitat në Evropën Juglindore u rritën në mënyrë të ndjeshme, përkatësisht me 80 për qind dhe 34 për qind, duke përbërë përkatësisht 18.8 për qind dhe 14.9 për qind të kredive dhe depozitave totale të grupit. Treguesi i kredive me probleme, llogaritur sipas standardeve IFRS 7, qëndroi në 3.7 për qind në fund të marsit '08, duke shënuar përmirësim nga niveli 4.8 për qind i një viti më parë. Depozitat në Greqi arrijnë në 29.8 miliardë euro (+8 për qind), ndërsa në Evropën Juglindore baza e depozitave u rrit me 34 për qind, duke kapur shifrën 5.4 miliardë euro në fund të muajit mars. Sipas vetë përfaqësuesve të bankës, gjatë problemeve në tregjet financiare globale, Alpha gjeneroi fitime të qëndrueshme për aksionerët me një rrezik të balancuar. Gjithashtu, grupi i qëndron objektivave të vendosur në axhendën afatmesme (deri në 2010).

Alfa Bank – Shqipëri, përfaqëson rreth 0.79 për qind të totalit të aktiveve të grupit dhe rreth 6.4 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar në Shqipëri (mars 2008).

Burimi: Sipas informacioneve e raporteve në faqet e internetit të institucioneve përkatëse.

Hapësirë informuese 2.3: Impakti i krizës financiare ndërkombëtare në sektorin bankar grek dhe sektorin bankar italian.

Impakti i krizës financiare ndërkombëtare, në sektorin bankar grek.

Sipas Bankës së Greqisë, bankat greke të pranishme në Shqipëri nuk kanë patur pasoja negative të drejtpërdrejta nga kriza e kredive subprime. Në veçanti, katër bankat greke më të mëdha, të cilat përbëjnë rreth 70 për qind të industrisë bankare greke deri në fund të tremujorit të parë 2008 nuk raportojnë një ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj kredive hipotekore jocilësore për individët, as ekspozim jo të drejtpërdrejtë përmes investimit në letra me vlerë të lidhura me to. Institucionet e tjera, ndonëse nuk kanë ekspozim të drejtpërdrejtë, kanë disa ekspozime të pakonsiderueshme jo të drejtpërdrejta ndaj kredive hipotekore me cilësi të lartë.

Impakti i krizës financiare ndërkombëtare, në sektorin bankar italian.

Në një prononcim të Guvernatorit të Bankës së Italisë, Draghi, theksohet se ekspozimi i bankave italiane kundrejt sektorit të kredive subprime "është i kufizuar në nivel ndërkombëtar". Të dhënat mbi grupet më të mëdha bankare italiane kanë nxjerrë në pah faktin se vlera e investimeve në letra me vlerë të lidhura me kreditë subprime arrin në 1.3 miliardë euro, mesatarisht më pak se 1.5 për qind e kapitalit bazë, ndërsa asnjë bankë italiane nuk ka dhënë kredi jocilësore ndaj partnerëve amerikanë.

3. SITUATA MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI

3.1 RRITJA EKONOMIKE

Rritja ekonomike ka qenë e qëndrueshme gjatë vitit 2007. Sektorët ekonomikë të cilët kanë kontribuar më shumë për këtë rritje ekonomike, kanë qenë ata më të mbështeturit nga huatë e sektorit bankar. Vihet re një ngadalësim i sektorit të ndërtimit, i cili sinjalizon nevojën për një kontroll të vazhdueshëm të vlerës së pasurive të paluajtshme, të përdorura si kolateral në kreditë e dhëna nga sektori bankar, si edhe për diversifikim të llojeve të kolateralit. Perspektiva për një qëndrueshmëri ekonomike të aktiviteteve prodhuese në të ardhmen do të varet nga shpejtësia e reformave në sektorë kyçë të ekonomisë, përmirësimi i qëndrueshëm i situatës së furnizimit të vazhdueshëm me energji, si dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit nëpërmjet reformave strukturore në sektorin e bujqësisë.

Rritja ekonomike për vitin 2007 pritet të rezultojë pranë nivelit 6 për qind, megjithë rritjen e kostove të prodhimit dhe të shërbimeve, si rezultat i goditjeve që pësoi oferta prej thatësirës rajonale dhe krizës energjitike, në gjysmën e dytë të vitit. Parashikimet paraprake tregojnë se në kushtet e kthimit në normalitet të furnizimit të energjisë elektrike dhe përmirësimit të performancës së eksporteve, rritja ekonomike do të jetë e qëndrueshme edhe gjatë vitit 2008.

Treguesit sipas sektorëve të prodhimit të paraqitur në tabelën 2, dëshmojnë se kontributi kryesor në rritjen ekonomike ka ardhur prej sektorëve të industrisë, të transportit dhe të telekomunikacionit, të tregtisë, të hotelerisë dhe të restoranteve, ndërkohë që vihet re një rënie në indeksin e shitjeve për sektorin e ndërtimeve dhe nënsektorin e energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ujë. Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2007 sektori i ndërtimit ka pësuar një rënie të ndjeshme prej mesatarisht 25 për qind në vëllimin e ndërtimeve të reja dhe 13.7 për qind në vëllimin e shitjeve, duke përjashtuar efektin e çmimeve (tabelë 3).

Prirja vjetore rënëse e ndërtimeve të reja gjatë gjithë vitit 2007 sinjalizon një ngadalësim të kërkesës për pasuri të paluajtshme nga ana e firmave, gjë e

cila ka sjellë rënien e çmimeve për tremujorin e parë të vitit 2008. Kjo duket edhe nga ecuria e indeksit të çmimit të pasurive të paluajtshme, për zonën e kryeqytetit, në grafikun 8, duke qenë se dhe shitjet kanë vazhduar të bien në terma realë. Ulja mund të ketë ardhur edhe si rezultat i normës së lartë të rritjes së çmimeve, të vënë re gjatë tremujorit të kaluar dhe efekteve të pritshme të ndryshimit të tatimit të shitjes së pasurive të paluajtshme. Materializimi i rrezikut të uljes së kërkesës për apartamente dhe një ulje e mundshme e mëtejshme e çmimit të pasurive të paluajtshme, do të kishte pasoja negative si për pasurinë e ekonomive familjare dhe të bizneseve, edhe për vlerën e tregut të kolateraleve të bankave, të cilat janë angazhuar në huadhënie hipotekare dhe në huadhënie për sektorin e ndërtimit. Ky efekt nuk pritet të jetë i rëndësishëm në tërësinë e sektorit bankar, por niveli i tij në banka të veçanta duhet të vlerësohet me kujdes.

Grafik 8. Indeksi i çmimeve të apartamenteve.



Burimi: Departamenti i Politikës Monetare, BSH.

Një faktor tjetër që pritet të ketë efekt në ecurinë e aktivitetit të ndërtimit dhe të të ardhurave të gjeneruara nga ky sektor është përparimi i procesit të legalizimit dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ky proces pritet të ketë ndikim direkt në rritjen e sasisë së kolateralit në dispozicion për t'u vendosur si garanci për kredi të ndryshme, duke stimuluar kërkesën për kredi dhe duke mbështetur ritmin e lartë të kreditimit. Nga ana tjetër, ky proces ka të ngjarë të shoqërohet me rënie të çmimit të pasurive të paluajtshme në zona të caktuara, duke ekspozuar ndaj rrezikut institucionet financiare që kanë kredituar në këto zona. *Ky element rreziku do të zbutej, nëse autoriteti mbikëqyrës do të ruante presionin mbi institucionet financiare që gjatë analizës së kërkesës për kredi, t'i kushtojnë vëmendjen kryesore situatës financiare të kredikërkuesit.*

Nga vlerësimet e disa përfaqësuesve të industrisë së ndërtimit rënia e performancës financiare të këtij sektori, lidhet edhe me disa vendime të autoriteteve vendimmarrëse publike. Një pjesë e vështirësive të pretenduara, dëshmojnë një situatë të pafavorshme në kërkesë/ofertën e tregut të ndërtimit, si edhe shprehin problemet që ndesh një pjesë e këtij sektori për të realizuar formalizimin e plotë të veprimtarisë. Megjithatë, disa nga shqetësimet e përfaqësuesve të këtij sektori që lidhen me vonesat në kohë për diskutimin e projekteve dhe dhënien e lejeve të ndërtimit, për regjistrimin e objekteve në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si edhe në lidhje me zbatimin e menjëhershëm të disa masave tatimore, të cilat ndikojnë negativisht mbi kërkesën në tregun e ndërtimit, kanë potencialin për të thelluar vështirësitë që po kalon ky sektor.

Perspektiva për një qëndrueshmëri ekonomike të aktiviteteve prodhuese në të ardhmen do të varet nga shpejtësia e reformave në sektorë kyçë të ekonomisë, ku veçojmë furnizimin e qëndrueshëm me energji dhe realizimin e potencialit të sektorit të bujqësisë.

Duke patur parasysh peshën e ndjeshme të sektorëve të ndërtimit dhe tregtisë në kreditimin e ekonomisë nga sistemi bankar, gjykohet se një diversifikim më i madh i sektorëve do të zvogëlonte rrezikun e sistemit bankar, që vjen si rezultat i rreziqeve specifike të industrive të caktuara. Megjithatë, struktura e prodhimit është ende e paekuilibruar. Sektorët si bujqësia dhe turizmi vazhdojnë të mbeten të pambështetur në mënyrë të qëndrueshme dhe të studiuar, duke e lënë të padiversifikuar siç duhet zhvillimin ekonomik, duke e bërë atë më të ndjeshëm ndaj zhvillimeve të pafavorshme rajonale si edhe duke kufizuar shpërndarjen proporcionale të përfitimeve të zhvillimit ekonomik, në të gjithë popullsinë.

Tabelë 2. Ndryshimet vjetore sipas sektorëve të prodhimit.

Treguesit %	III-04	IV-04	I-05	II-05	III-05	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06	I-07	II-07	III-07	IV-07
	III-03	III-03	I-04	II-04	III-04	IV-04	I-05	II-05	III-05	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06
Industria														
Shifra e afarizmit	13.7	5	16.3	13.4	3.2	3.5	4.4	2.4	4.8	3.4	16.6	15.9	6.3	12.2
Të punësuar me pagesë	-1.5	-2.7	-0.6	-1.2	-1.4	-0.9	-1.5	-0.7	-1.2	2.3	5.8	4.8	7.3	3.6
Paga	5.9	4.3	4.7	4.8	5	5.3	5.1	3.2	6	11.3	15.7	20.4	23	21.1
Industria nxjerrëse														
Shifra e afarizmit	6.3	-10.1	-4.5	10.3	-10.9	-4.2	53.6	1.8	35.7	13.4	14.4	42.3	24	31.3
Të punësuar me pagesë	-7.4	-8.2	-4.4	-2.4	5	-0.8	-2	-1.2	-0.6	0	4.3	10	10	12.9
Paga	-5.2	-7.7	-1.3	-4.8	17	17.5	11.7	16	10.1	11.5	21.6	27.8	25	24.8
Industria përpunuese														
Shifra e afarizmit	10.6	-4.2	5.8	8.8	1.9	8.4	4.6	10.5	11	13.1	26.5	17.2	8.5	10.5
Të punësuar me pagesë	0.1	-1.8	0.8	-1.1	-2.3	-0.9	-3.2	-2.2	-2	4.7	9.9	7.5	11	2.8
Paga	7	8.6	6.2	7.9	4.9	3.6	3.5	-0.7	2	10.6	16.4	22.6	31	22.6
Energjia elektrike, furnizimi me ujë dhe avull														
Shifra e afarizmit	22.6	29.6	19.9	27.4	14.5	-3.6	-4.5	-13.6	-14	-16.8	0	3.1	-7	8.5
Të punësuar me pagesë	-2.6	-2.5	-2.2	-0.9	0.4	-0.5	2.1	2.9	0.4	-2.3	-2.7	-3.3	-3	1.1
Paga	9.2	2.3	4.7	3.4	0	3.3	5.3	5.9	12	12.8	11.4	12.2	6.7	16.0
Ndërtimi														
Shifra e afarizmit	5.8	28.2	15.6	17.3	9.4	-4.2	-1.6	-6	-5.2	16.1	-1.3	-0	-14	-5.1
Të punësuar me pagesë	12.9	11.2	12.4	8.1	-0.1	-2.4	-0.7	-1.8	-0.4	1.2	-1.7	-4.5	-7	-4.6
Paga	20.5	19.8	17.5	18.2	5.2	-0.2	5.4	4.2	3.8	10.8	10.2	15	19	22.6
Ndryshimi vjetor në hotele														
Shifra e afarizmit	20.6	23.7	-11	7.7	7.6	17.1	3.3	-14.1	8.2	20.7	26.7	34	6.8	2.3
Të punësuar me pagesë	35.8	49	-2.2	0.6	0	-7.4	-1.7	-24.3	5.3	9.1	11.5	4	7.8	1.7
Paga	53.9	77	-8.1	0.7	-1.5	-19	1.3	-28.5	42.5	41.3	53	40	12	8.4
Ndryshimi vjetor në posta														
Shifra e afarizmit	12	7.3	1.9	8.9	30.8	42.9	-10.4	-9.2	-12.8	5.2	55.6	57	26	20.4
Të punësuar me pagesë	3.4	-0.1	1.6	2.3	4.6	5.1	5.3	5.4	3.3	12.9	18.1	20	21	12.1
Paga	14.7	10.6	9.7	10.9	12.7	10.7	24.6	4	3.6	11.9	17.4	19	21	15.3
Ndryshimi vjetor në komunikacion														
Shifra e afarizmit	11	3.2	19.8	18.6	8.6	19.9	-4.9	-16.1	1.6	3.1	17.7	21	12	0
Të punësuar me pagesë	-6.5	-3.8	-13.4	-12.5	-3.8	-8.1	2.6	1.4	7	11.9	9.9	9.8	2.2	0.3
Paga	-6.3	-3.6	13.1	14.2	9.4	8.8	8.3	-6.7	6.1	13.8	13.9	12	18	-1.1
Transporti hekurudhor														
Shifra e afarizmit	-6.8	-9.1	19.7	-20.9	-20.6	-27.6	-21.9	20.3	36.5	9.3	-4.7	42.9	15	25.1
Të punësuar me pagesë	-38.2	-1.9	-0.2	-0.2	-1.5	-1	-35.4	-4	-7.7	-7.7	-5.8	-5.8	-4.1	-5.6
Paga	-29.6	0	5.8	4.4	-3.9	0.4	-24.8	-3.7	2.1	-3.5	-0.3	-2.6	-0.4	-1.0
Transporti detar														
Shifra e afarizmit	0.3	-2	1.2	-5.3	-0.2	-8.1	30.6	105	98.3	30.2	0.7	-22	-18	-3.6
Të punësuar me pagesë	7.7	7.7	50	50.6	42.9	42.9	4.8	52.4	60	60	22.9	-11	-6.5	-15.2
Paga	1.5	0.6	38	42.4	48.5	48.2	9.2	74.5	73.3	79.2	25.5	47.5	24	18.5
Transporti ajror														
Shifra e afarizmit	-4.5	8.8	-0.5	-10.6	18	11.4	-28.5	-42.2	-23.2	-30	-5.2	-17	16	-12.0
Të punësuar me pagesë	-7.5	6	-18.5	-22.3	-25.2	0	-28.2	-7.5	-4	0	0	0	0	26.7
Paga	-0.1	2	9.6	16.1	38.8	35.2	18.1	-1.1	44.5	-16.4	0	0	0	21.6

Burimi: INSTAT.

Tabelë 3. Tregues të sektorit të ndërtimit.

Vëllimi i ndërtimit	III-04	IV-04	I-05	II-05	III-05	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06	I-07	II-07	III-07	IV-07
	III-03	IV-03	I-04	II-04	III-04	IV-04	I-05	II-05	III-05	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06
Vëllimi i ndërtimit	6.6	36.5	16.8	19.9	13.8	-5.6	5	-7.8	-6.5	16.2	0.3	-1.9	-16	-7.6
Ndërtime të reja	-2.9	42.4	17.3	6.9	13.5	9.4	23.8	4.3	2.7	8.6	-5.7	-10	-19	-23.3
Rikonstruksion	25.8	74.2	67.1	47.9	6.3	20.2	7.6	-4.8	-20	22.3	3.9	4.5	-36	-6.1
Punime inxhinierike	19	37	30.4	34.1	16.4	-30.3	20.40	-35.3	-11.8	8.8	21.9	19	1.6	15.1

Burimi: INSTAT.

3.2 ZHVILLIMET NË KURSIN E KËMBIMIT, NË INFLACION DHE NË POLITIKËN MONETARE

Norma e inflacionit për vitin 2007 ka rezultuar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë, megjithatë si në fund të vitit 2007 ashtu edhe në fillim të vitit 2008 është vënë re rritja e presioneve inflacioniste, kryesisht nga krahu i ofertës. Edhe kërkesa e brendshme është ruajtur në nivele të qëndrueshme e mbështetur, krahas faktorëve të tjerë, edhe nga rritja e ndjeshme e kredisë për sektorin privat. Rritja e normës bazë të interesit për të ndikuar pritjet inflacioniste, ka rritur diferencën me normat e interesit të valutave kryesore dhe është një faktor që do të mbajë të lartë kërkesën për kredi në valutë. Për këtë arsye, përcjellja e kësaj rritjeje në normat e kredisë në lekë mund t'i paraprijë rritjes së peshës specifike të kredidhënies në valutë, duke rritur ekspozimin ndaj kursit të këmbimit. Në këtë mënyrë, rreziku i kreditit i shkaktuar tërthorazi nga lëvizjet në kursin e këmbimit, do të jetë vazhdimisht i pranishëm.

Grafik 9. Kursi nominal efektiv i këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e inflacionit vjetor për vitin 2007 rezultoi 2.9 për qind, duke qenë mjaft pranë objektivit prej 3 për qind të Bankës së Shqipërisë. Në vazhdim, presionet inflacioniste kanë qenë të forta, duke kushtëzuar ruajtjen e drejtimit shtrëngues të politikës monetare. Objektivi i inflacionit u arrit në terma mesatarë, pavarësisht luhatjeve të përkohshme, si pasojë e goditjeve nga ana e faktorëve të ofertës ashtu dhe nga faktorë të krahut të kërkesës. Në këtë mënyrë, kriza energjitike, çmimet gjithnjë e në rritje të naftës dhe drithërave si dhe rritja e çmimeve të importeve në tërësi, kanë qenë faktorët kryesorë që ndikuan rritjen e nivelit të çmimeve gjatë muajve gusht–tetor 2007 (tabelë 4). Krahas faktorëve të ofertës kanë vepruar gjithashtu faktorë të kahut të kërkesës, si rritja e vazhdueshme e kredisë për sektorin privat dhe pritjet inflacioniste.

Grafik 10. Kursi nominal usd/lek (janar '07 - maj'08).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tendenca e forcimit të lekut kundrejt shportës së valutave kryesore, e vërejtur gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007, ka vazhduar të theksohet në tremujorin e fundit të tij, si në terma nominalë ashtu edhe në terma realë, duke reflektuar qëndrueshmërinë makroekonomike në vend, thellimin e diferencës së normave të interesit midis lekut dhe monedhave të huaja, si dhe nivelet e krahasueshme të inflacionit me partnerët tregtarë kryesorë (grafiqet 9; 10 dhe 11). Kështu, leku është forcuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj dollarit amerikan mesatarisht 12.4 për qind, duke arritur vlerën 83.38 lekë për dollar në fund të periudhës. Ai është mbiçmuar me 1.6 për qind në terma vjetorë ndaj euros, duke arritur vlerën 121.69 lek/euro në tremujorin e fundit të vitit 2007. Megjithatë, krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2007, leku paraqet një luhatshmëri më të lartë si pasojë e zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe e pjesëmarrjes më aktive të agjentëve vendas në tregun valutor.

Grafik 11. Kursi nominal euro/lek (janar '07 - maj'08).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për të kontrolluar presionet inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë tre herë gjatë vitit 2007, duke e çuar normën bazë të interesit në nivelin 6.25 për qind. *Duke qenë se normat e ofruara nga sistemi bankar si për aktivet dhe për pasivet në lekë, kanë ndjekur lëvizjet e normës bazë dhe këto lëvizje kanë rritur diferencën midis normave të interesit të lekut dhe atyre të valutave kryesore, kërkesa për kredi në valutë do të vazhdojë të jetë e lartë. Në këtë mënyrë, rreziku i kreditimit, i shkaktuar nga lëvizjet në kursin e këmbimit, do të jetë vazhdimisht i pranishëm. Për të kufizuar këtë rrezik, bankat tregtare duhet të tregohen të kujdesshme në dhënien e kredisë në valutë, duke siguruar më parë një ndryshim sa më të vogël midis aktiveve dhe detyrimeve në valutë në bilancin e tyre, si edhe duke bërë një analizë të hollësishme dhe efektive të aftësisë paguese të kredimarrësit dhe të mjeteve të ndryshme që sigurojnë kredinë.*

Tabelë 4. Norma e inflacionit vjetor gjatë vitit 2007.

Muaji	Inflacioni vjetor
Janar-07	2.9%
Shkurt-07	2.9%
Mars-07	2.7%
Prill-07	1.9%
Maj-07	1.4%
Qershor-07	2.0%
Korrik-07	2.1%
Gusht-07	4.2%
Shtator-07	4.4%
Tetor-07	4.2%
Nëntor-07	3.5%
Dhjetor-07	3.1%
Janar-08	3.0%
Shkurt-08	3.6%
Mars-08	4.6%
Prill -08	4.4%
Maj -08	4.2%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

3.3 PUNËSIMI

Gjatë vitit 2007 ka vazhduar rritja e të ardhurave të ekonomive familjare e mbështetur nga rritja e punësimit, rritja e nivelit të pagave në sektorin shtetëror dhe qëndrueshmëria e fluksit të remitancave. Kjo rritje e të ardhurave ka mbështetur rritjen e kredisë për konsum, veçanërisht të asaj në valutë. Materializimi i skenarit të një kthese në fluksin e remitancave, megjithatë mbetet një burim rreziku. Pakësimi i fluksit të remitancave, është një proces i cili sidoqoftë duhet të ndodhë gradualisht, duke zbutur karakteristikat e rrezikut që mund të shkaktojë. Rritja e të ardhurave është një faktor, i cili kontribuon pozitivisht në stabilitetin e sistemit financiar, për sa kohë aftësia e ekonomive familjare për të shlyer borxhin, paraqitet më e mirë. Megjithatë, rritja e të ardhurave lejon rritjen e borxhit (në formën e kredisë së përfituar nga bankat). Nëse kjo rritje bëhet e papërballueshme, shërbimi i borxhit vihet në dyshim, duke i përcjellë problemet tek borxhdhënësi.

Viti 2007 karakterizohet nga një prirje rënëse e forcave të punës, nga një rritje e punësimit, e mbështetur nga punësimi në sektorin privat dhe nga një reduktim si në normën e papunësisë, ashtu edhe në numrin e të papunëve (tabelë 5). Një gjë e tillë pritet të ketë ndikuar në rritjen e të ardhurave për frymë të ekonomive familjare, duke mbështetur kështu prirjen rritëse të konsumit dhe për rrjedhojë, të kredisë konsumatore të dhënë nga sistemi bankar.

Për sa i përket nivelit të pagave në ekonomi, vihet re një tendencë në rritje e pagave mesatare për sektorin shtetëror. Në tremujorin e fundit të vitit 2007 ato janë rritur afërsisht 14 për qind më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të dhënat për ecurinë e pagave mesatare për sektorin privat mungojnë, por mund të hamendësojmë se kjo tendencë në rritje, ka ekzistuar edhe në sektorin privat.

Rritja e të ardhurave ka çuar në rritjen e kërkesës për kredi për konsum, e cila pritet të përshpejtohet gjatë vitit 2008, si rezultat edhe i profilizimit më të madh të burimeve në lekë, për këtë lloj kredie. *Mund të jetë e nevojshme që nga këndvështrimi rregullativ, rreziku që mbart ky tip kredie, të trajtohet në mënyrë të posaçme.*

Një tjetër burim shumë i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare, janë edhe remitancat. Duke ditur që emigracioni përbën aktualisht nga 20-25 për qind të forcave të punës, fluksi i remitancave është një ndër mbështetësit kryesorë për konsumin dhe kursimin e ekonomive familjare. Ai gjithashtu, është një faktor i rëndësishëm që ndikon në ecurinë e kursit të këmbimit dhe në aftësinë e shërbimit të borxhit në valutë të huaj, të ekonomive familjare. Teorikisht ekziston rreziku i një pike kthese në fluksin e remitancave, e cila shpjegohet me integrimin e emigrantëve në ekonomitë ku ata punojnë dhe zhvendosjen e qendrës së interesit ekonomik të familjeve të tyre, nga vendi i origjinës në vendin pritës. Deri në periudhën aktuale një fenomen i tillë nuk është vënë re nga statistikat e remitancave; gjatë vitit 2007 remitancat janë vlerësuar në nivelin në 947 milionë euro me një rritje të lehtë vjetore prej 1.3 për qind, duke arritur në 12 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Megjithatë, remitancat janë ngushtësisht të lidhura me ekonomitë e vendeve të huaja dhe bëhen shkak, për përcjelljen e goditjeve të këtyre ekonomive në vendin e origjinës. Konkretisht, nëse materializohet rreziku i një recensioni të ekonomive në vendet e zhvilluara, fluksi i të ardhurave nga emigrantët do të ulte si mirëqenien e ekonomive familjare e për rrjedhojë, ofertën e depozitave në valutë të huaj, ashtu edhe aftësinë e tyre për të shërbyer borxhin në valutë.

Nga ana tjetër, ruajtja e preferencës për kreditimin në valutë, nga ana e sektorit financiar dhe e huamarrësve edhe për vitin 2008, rrit ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të rënies së fluksit të remitancave. Ky element rreziku do të zbutej gradualisht, nëse do të vendoseshin në zbatim kërkesat rregullative për rritjen e kostos së kredive në valutë dhe forcimin e analizës së rrezikut nga bankat, për këtë lloj veprimtarie.

Tabelë 5. Tregues të punësimit.

Treguesit kryesorë	Njësia											
		II-05	III-05	IV-05	I-06	II-06	III-06	IV-06	I-07	II-07	III-07	IV-07
TREGU I PUNËS												
Forcat e punës		1,086,000	1,086,000	1,086,000	1,082,900	1,081,328	1,084,072	1,084,545	1,080,467	1,078,103	1,077,908	1,081,821
Të punësuar	numër	931,000	931,200	932,000	931,000	931,253	934,405	935,058	932,759	932,960	935,747	939,000
a)Në sektorin shtetëror	numër	175,600	175,600	175,000	174,000	172,126	170,500	169,000	167,500	166,800	167,100	167,100
b)Në sektorin privat jobujqësor	numër	213,400	213,600	215,000	215,000	217,127	221,905	224,058	223,259	224,160	226,647	229,900
c)Në sektorin privat bujqësi	numër	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000	542,000
Të papunë	numër	155,000	154,800	154,000	151,800	150,075	149,667	149,486	147,708	145,143	142,161	142,821
Përfitojnë pagesë papunësie	numër	11,500	11,500	11,200	11,500	11,249	11,360	11,297	10,334	9,857	9,659	9,540
Shkalla e papunësisë së regjistruar	%	14.30	14.20	14.20	14	13.90	13.80	13.90	13.60	13.50	13.18	13.20
TË ARDHURAT												
Paga mesatare mujore në sek.shtetëror	lekë	26,612	27,197	27,333	27,333	27,606	28,950	31,400	31,850	31,850	35,650	35,650
Paga bazë minimale mujore	lekë	10,800	11,800	11,800	11,800	11,800	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000	14,000

Burimi: INSTAT.

Grafik 12. Flukset tremujore të remitancave në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.4 TREGTIA E JASHTME

Deficiti i llogarisë korente gjatë vitit 2007 u rrit, duke reflektuar kërkesën e lartë dhe mungesën e kapaciteteve prodhuese në vend. Eksportet mbuluan vetëm ¼ e vlerës së importeve. Rritja e importit ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të importeve, veçanërisht të importeve të energjisë, dhe rritjes së përgjithshme të nivelit të çmimeve. Gjatë vitit 2007 është konstatuar ulja e importeve për konsum dhe rritja e importeve për mallra kapitalë (kryesisht të makinerive dhe të pajisjeve), duke krijuar premisa më të mira për rritjen e kapaciteteve prodhuese në të ardhmen, dhe për rritjen e eksporteve. Në këtë mënyrë, efekti relativ i tregtisë së jashtme në prodhimin e përgjithshëm të vendit do të ishte pozitiv, dhe kërkesa e brendshme për valutë do të pakësohej. Të dyja zhvillimet do të ishin pozitive, në kuadër të stabilitetit të sistemit financiar.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë dëshmojnë për një rritje të mëtejshme të kërkesës së brendshme. Deficiti korent për vitin 2007, u vlerësua në nivelin 878 milionë euro, me një rritje prej rreth 64 për qind kundrejt vitit 2006. Vëllimi i përgjithshëm tregtar, prej 3.8 miliardë eurosh, në fund të vitit u rrit me 26 për qind në krahasim me vitin e kaluar dhe arriti në 28 për qind të PBB-së. Zgjerimi i deficitit tregtar i mbështetur nga një kërkesë e lartë e mallrave të importit, reflektoi rritjen e përgjithshme të çmimeve në rajon, luhatjet në kursin e këmbimit si dhe uljen graduale të tarifave doganore, pjesë e proceseve liberalizuese tregtare.

Edhe për fundin e vitit 2007 raporti i mbulimit të importeve nga eksportet mbeti në nivel të ulët, prej 26 për qind. Me gjithë rritjen e eksporteve të vënë re gjatë vitit 2007, kapacitetet e ulëta prodhuese në vend dhe kërkesa shumë e lartë për importe ulin ndjeshmërinë e deficitit tregtar nga faktorët specifikë për eksportet. Brenda strukturës së importeve vihet re një ulje prej 7 pikë përqindjeje të mallrave të konsumit, që zënë 30 për qind të totalit të importeve dhe një rritje prej 36 për qind të mallrave kapitalë, që në fund të vitit arrijnë në 14 për qind të totalit të importeve. Fluksi i lartë hyrës i makinerive dhe pajisjeve, që është vërejtur gjatë vitit 2007 (rritje prej 30 për qind), ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të sektorit ndërtues në vend si dhe për investime në infrastrukturë. *Një zhvendosje e tillë e strukturës së importeve në drejtim të mallrave me qëllim investimi, sinjalizon rritjen e kapaciteteve prodhuese nga firmat, gjë që përmirëson vlerën neto të ardhshme të tyre dhe ul rrezikun e kreditimit për sistemin bankar. Në një kohë të dytë gjithashtu, kjo zhvendosje sinjalizon ngushtimin e deficitit tregtar në të ardhmen, si rezultat i rritjes së ofertës së brendshme.*

Sipas të dhënave të Bilancit të Pagesave, kushtet jo të favorshme klimaterike dhe kërkesa e lartë e ekonomisë në zhvillim, kanë sjellë rritjen me 3.5 herë

të importit të energjisë elektrike, në krahasim me vitin paraardhës. Ndërkohë që në vlerë, rezultoi 6 herë më e lartë, duke diktuar kështu dhe ndikimin e rritjes së çmimeve të energjisë elektrike në tregjet botërore. *Zgjerimi i deficitit tregtar mund të jetë një faktor që ushtron presion mbi kursin e këmbimit dhe rrit ekspozimin e ekonomisë ndaj rrezikut të një zhvlerësimi me pasoja në portofolin e kredisë së sektorit bankar.*

3.5 TREGUESIT FISKALË

Realizimet e treguesve fiskalë në fund të vitit 2007 ishin në përputhje me objektivat, ndonëse shpenzimet u përqendruan përsëri në fund të vitit. Për vitin 2008, zgjerimi i deficitit buxhetor në masën 5.2 për qind për të realizuar investimet strategjike, kërkoi ndjekjen e një politike të matur në mbledhjen e të ardhurave (nga tatimet, privatizimet e sektorëve kyçë dhe huamarrja e qeverisë), dhe një shpërndarje më të mirë të shpenzimeve, për të shmangur presionin mbi normat e interesit të likuiditetit në tregun ndërbankar si edhe për të mos krijuar vështirësi në projektet e zhvillimit të biznesit të firmave private.

Në fund të vitit 2007, realizimet e treguesve fiskalë në lidhje me nivelin e të ardhurave dhe të shpenzimeve publike, tepricën negative (deficitin) buxhetore, si edhe në lidhje me madhësinë e financimit të një pjese të shpenzimeve me burime të brendshme të tregut financiar ishin në përputhje me objektivat. Të ardhurat buxhetore u rritën me 12 për qind krahasuar me një vit më parë, kjo si rezultat i reformimit të paketës fiskale, aplikimit të taksës së sheshtë si dhe të performancës së mirë të të ardhurave nga TVSH-ja. Edhe këtë vit, u vu re një përqendrim më i madh i shpenzimeve buxhetore në fund të vitit me një rritje prej 9 për qind, gjë që pati ndikimet e saj edhe në likuiditetin e tregut ndërbankar. Si rezultat i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë për investimin e likuiditetit të tepërt të qeverisë në instrumentet përkatëse financiare të ofruara nga Banka e Shqipërisë, në tremujorin e fundit të vitit 2007 presioni afatshkurtër mbi nivelin e likuiditetit dhe mbi normat e interesit në tregun ndërbankar, u zbut. Në këtë mënyrë, u krijuan kushte më të mira për përcjelljen e ndryshimit të normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, në tregun ndërbankar nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur.

Për vitin 2008 parashikohet një zgjerim i deficitit buxhetor në masën 5.2 për qind të PBB-së, si rezultat i planifikimit të realizimit të investimeve strategjike në infrastrukturë. Politika fiskale ekspansioniste pritet të ketë efektet e mëposhtme:

- zgjerimin e huamarrjes publike të qeverisë, një pjesë e së cilës do të financohet nga sektori financiar dhe ai bankar, duke e shndërruar qeverinë në huamarrësin më të rëndësishëm dhe duke ndikuar ndoshta, në kufizimin e ofertës së kredisë për sektorin privat. Ka shumë të ngjarë që sektori i ndërtimit, të përfitojë nga shpenzimet e shtuara të qeverisë në infrastrukturë. Por, sektorët e tjerë të ekonomisë mund të përballen

me kushte më të vështira të financimit të nevojave për zhvillim të biznesit, veçanërisht nëse ka mospërputhje në kohë mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo situatë mund të jetë më e zbutur, nëse Qeveria siguron një pjesë të madhe të huamarrjes në tregun ndërkombëtar ose ka sukses në privatizimin e disa kompanive të rëndësishme shtetërore, nga fakti që degët e bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri mund të rrisin kreditimin, në kushtet kur janë çliruar nga disa prej kërkesave rregullative që zbatohen për filialet e bankave, si edhe nga hyrja e bankave të fuqishme evropiane;

- rritjen e presioneve inflacioniste, të cilat mund të ndikohen nga mbizotërimi i këtyre faktorëve: a) rritja e kostos së bizneseve për shkak: të rritjes së kostos së energjisë, të procesit të formalizimit të ekonomisë dhe të rritjes së mbledhjes së taksave, b) vështirësimi i kushteve të financimit të nevojave të biznesit si rezultat i përqendrimit të shpenzimeve të qeverisë (në sektorë të caktuar dhe në kohë), c) stimuli financiar në kërkesën e brendshme që vjen si rezultat i rritjes së pagave në sektorin publik dhe të pensioneve, në shifra më të larta se ajo e rritjes së pritshme ekonomike dhe e rritjes së inflacionit. Ky element rreziku do të zbutej nëse kursi i këmbimit të lekut do të vijonte të vlerësohej gradualisht, për shkak të rritjes së interesit të investitorëve të huaj për Shqipërinë;
- rritjen e sasisë së emetimit dhe uljen e frekuencës së ankandeve të bonove të thesarit, të cilat teorikisht do të rrisnin likuiditetin e këtyre instrumenteve. Gjithashtu, edhe masat në rritjen e maturimit të instrumenteve të borxhit për sistemin bankar, do të ndikonin në thellimin e tregut të brendshëm të parasë dhe në tregun e bonove të thesarit. Veçanërisht për thellimin e tregut të instrumenteve me maturim më të lartë se një vit dhe për t'i bërë këto instrumente më tërheqëse për bankat, duhet të ekzistojë mundësia për përdorimin e tyre si kolateral në Bankën e Shqipërisë, në rast përballjeje me një goditje të likuiditetit dhe rritjen e tregtueshmërisë së këtyre instrumenteve në tregun sekondar. Për sa i përket emetimit të instrumenteve të borxhit të qeverisë në valutë të huaj, krijimi i këtij instrumenti të ri ka përparësinë e zgjerimit të bazës së huadhënësve, si edhe përmirësimin e kostos së borxhit në afat të shkurtër. Megjithatë, duke patur parasysh situatën e paqartë të tregjeve ndërkombëtare dhe riçmimin e vazhdueshëm të rrezikut, nuk mund të konkludohet mbi përfitimet në koston e borxhit në afat të mesëm. Duke qenë së vlera e borxhit të qeverisë në valutë, zë një peshë mjaft të vogël në huamarrjen e qeverisë, edhe rreziku i kursit të këmbimit për këtë instrument është i papërfillshëm.

4. ANALIZA E TREGUESVE TË SHËNDETIT TË SISTEMIT FINANCIAR

4.1 ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME

Gjatë vitit 2007 dhe tremujorit të parë të vitit 2008, ka vijuar zgjerimi i aktiveve të sektorit bankar dhe rezultati financiar pozitiv. Ndër elementet e aktiveve, kredia vazhdon të rritet më shpejt se elementet e tjera. Në fund të

marsit 2008, pesha e kredisë ndaj totalit të aktiveve është rritur me 10 për qind, në krahasim me fundin e vitit 2006. Kredia në valutë ka vazhduar të zërë peshën më të madhe ndaj totalit të kredisë duke u rritur me shpejtësi, por aftësia e sektorit për të mbledhur depozita në valutë është rritur më ngadalë. Nëse kjo prirje vazhdon edhe në të ardhmen, kërkesa e lartë për burime në valutë të huaj mund të çojë ose në një rritje të huamarrjes nga grupet bankare të huaja, në një zvogëlim të marzhit të interesave për aktivitetin në valutë nga ana e bankave dhe rritjen e preferencës për të mbledhur valutë që ka një normë të ulët interesi; ose në një përkeqësim të përputhjes së maturimit midis aktiveve dhe detyrimeve në valutë. Në të dyja rastet, duke rritur përkatësisht rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e normës së interesit për sistemin bankar.

Sektori bankar ka mbështetur me kredi sektorët më produktivë të ekonomisë. Kredia me probleme paraqitet ende në nivele të ulëta, por ky raport mund të përkeqësohet më vonë, duke qenë se kredia është rritur me ritme mjaft të shpejta në vitet e fundit dhe shkalla e rritur e përdorimit të kredisë, mund të tregojë rritjen e rasteve të ristrukturimit të saj. Si rezultat i rritjes së kredisë, konstatohet një rënie në treguesit e likuiditetit, e shprehur në formën e raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve. Megjithatë, ky raport mbetet ende në nivele të kënaqshme. Leva financiare e sektorit bankar është ulur, dhe kostoja e huamarrjes për sektorin bankar mbetet relativisht e ulët. Rezultati financiar paraqitet pozitiv dhe paraqet një burim të qëndrueshëm të rritjes së kapitalit dhe të zgjerimit të veprimtarisë. Sektori bankar paraqet një varësi të theksuar ndaj të ardhurave nga interesi, për shkak të përqendrimit të investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë e kredi, dhe për shkak të konkurrencës së pamjaftueshme. Kjo varësi pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen, e parashikueshme. Varësia ndaj të ardhurave nga interesi e bën sektorin bankar të ndjeshëm ndaj faktorëve që mund të shkaktojnë një ngadalësim të rritjes së kredisë ose të mbledhjes së depozitave, ndaj nevojitet zgjerimi i burimit të gjenerimit të të ardhurave.

Kthimi nga aktivet rezulton në nivele të qëndrueshme, po ashtu edhe kthimi mbi kapitalin. Niveli i treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultoi i mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet nga ushtrimi i aktivitetit. Megjithatë, vihet re një tendencë rënëse e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë vitit, si rezultat i zhvendosjes së portofolit të aktiveve, drejt investimeve me rrezik më të lartë dhe përkeqësimit të portofolit të kredisë. Analiza e rrezikut tregon se niveli i rrezikut në përgjithësi për sektorin bankar është rritur, ndonëse ai mbetet ende në nivele të pranueshme. Përveç rritjes së ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe të kursit të këmbimit, prirja rënëse e treguesit të likuiditetit si edhe mundësia e shfrytëzimit të financimit në valutë nga grupet bankare të huaja, rrisin ndjeshmërinë ndaj rreziqeve që prekin tregjet e huaja financiare.

Gjatë vitit 2007 dhe tremujorit të parë të vitit 2008, totali i aktiveve të sektorit bankar është zgjeruar me 23 për qind. Aktivet me rrezik, pas një rënieje në tremujorin e fundit të vitit 2007, kanë rifilluar prirjen e tyre rritëse, duke arritur në fund të muajit mars 2008 në nivelin 37.2 për qind të totalit të aktiveve, krahasuar me 34.6 për qind në fund të vitit 2006. Ndër aktivet me rrezik, rritjen kryesore e ka shënuar kredia, e cila është rritur në total me 58 për qind. Kredia në valutë, është rritur me 61 për qind, duke zënë 73.1 për

qind të totalit të portofolit të kredisë në fund të marsit 2008. Kontributi kryesor në rritjen e aktivitetit të sistemit në total është sjellë nga gjysma e dytë e vitit, ndërkohë që zhvillimet në portofolin e kredisë kanë qenë më uniforme gjatë gjithë periudhës.

Veprimtaria e kredisë është financuar me burime të brendshme të sektorit bankar, ku depozitat përbëjnë pjesën kryesore. Për këtë arsye, prirja rënëse e raportit të depozitave ndaj kredive është thelluar duke zbritur në nivelin 202 për qind, në fund të muajit mars 2008 (grafik 14). Rënia e këtij raporti tregon se aftësia e sistemit për të dhënë kredi, ka qenë më e madhe se aftësia e tij për të mbledhur depozita. Duke pranuar se burimet, domethënë depozitat në valutë të huaj, janë relativisht më të kufizuara se burimet në lekë, është me interes monitorimi i rritjes së depozitave në valutë dhe krahasimi i saj me prirjen ekzistuese dhe të pritshme të rritjes së kredisë në valutë. Siç tregohet edhe në grafiqet 15 dhe 16, pothuaj gjatë gjithë vitit 2007 kredia në valutë është rritur më shpejt se depozitat në valutë. *Kjo sinjalizon se në të ardhmen, burimet e kufizuara në valutë të huaj mund të çojnë në një zhvillim të financimit nga grupi bankar i huaj, në një zvogëlim të marzhit të interesave për aktivitetin në valutë dhe rritjen e preferencës për të mbledhur valutë që ka një normë të ulët interesi, ose një përkeqësim të përputhjes së maturimit midis aktiveve dhe detyrimeve në valutë; në të gjitha rastet duke rritur përkatësisht rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e normës së interesit për sektorin bankar.* Më hollësisht, ekspozimin e sistemit bankar ndaj këtyre rreziqeve do ta shtjellojmë në pjesën 5 të këtij raporti, gjatë trajtimit të analizës stress-test.

Grupet[7] e bankave sipas vëllimit të veprimtarisë, shfaqin karakteristika të ndryshme. Për grupet e bankave G1 dhe G2, pesha e kredisë ndaj totalit të aktivitetit ka qenë më e lartë gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 dhe tremujorit të parë të vitit 2008. Ndërkohë që për G3, rritja ka qenë pothuaj lineare gjatë tërë vitit 2007 dhe është ulur në tremujorin e parë të vitit 2008. Rënia e peshës së kredive për të dyja grupet e para, i është përgjigjur efekteve sezonale dhe goditjeve të ekonomisë reale që ndodhën gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007.

Grafik 13. Ecuria e depozitave dhe kredive për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

E njëjta prirje vihet re në raportin të depozitave ndaj kredive i cili gjatë tërë periudhës, ku ky raport ka ndjekur ecurinë e kredive (grafiqet 13 dhe 17). Në tremujorin e parë të vitit 2008 ky raport ka rënë ndjeshëm sidomos për grupin G2, duke treguar një rritje të ritmit kreditues nga ky grup bankash. Për grupin G3, raporti i depozitave ndaj kredive ka rënë në mënyrë konstante gjatë gjithë vitit. Megjithatë, në tremujorin e parë të vitit 2008 vihet re një rritje e këtij raporti, për shkak të uljes së ritmit të kreditimit. Rritja e kredive gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 ka qenë më e lartë se rritja e kapitalit për grupet G2 dhe G3. Veçanërisht për grupin G2, ky raport në fund të periudhës është gjendur në vlerat e tij më të larta, që prej 3 vitesh.

Grafik 14. Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Kredia në valutë ndaj totalit të kredive për sistemin bankar.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Depozitat në valutë ndaj totalit të depozitave për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 17. Totali i depozitave ndaj totalit të kredisë për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 19. Detyrimet në valutë ndaj totalit të detyrimeve për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në valutë si përqindje e totalit të kredisë është rritur më shumë për bankat e grupeve G1 dhe G2. Ndërkohë që, për grupin G3 ky raport reflekton lëvizjen e kursit të këmbimit gjatë tremujorit të dytë (grafik 18). Nga ana tjetër, raporti i detyrimeve në valutë ndaj detyrimeve gjithsej, pavarësisht se në nivele të larta, është në rënie për grupin G1. Për dy grupet e tjera, ky raport është rritur gjatë gjithë periudhës duke treguar se deri tani, aftësia e sistemit bankar për të mbledhur depozita në valutë, për të financuar kredidhënien në valutë është e tillë, që realizon një mbrojtje të mjaftueshme nga rreziku direkt i kursit të këmbimit (grafik 19).

4.2 TREGUESIT E KAPITALIT

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, i shprehur si raport i kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara, me koeficientët e rrezikut për sistemin bankar (grafik 20.a dhe grafik 20.b), kanë patur një prirje rënëse gjatë gjithë vitit dhe veçanërisht, gjatë gjysmës së parë të tij, ndonëse leva financiare, e shprehur si raport i kapitalit aksioner ndaj totalit të aktivit, ka mbetur në të njëjtat nivele gjatë së njëjtës periudhë. Një gjë e tillë, shpjegohet me rritjen më të shpejtë të aktiveve të ponderuara me koeficientët e rrezikut në krahasim me rritjen e kapitalit rregullator, si edhe me rritjen e provigjoneve për shkak të përkeqësimit të portofolit të kredisë. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2007, raporti është përmirësuar duke reflektuar shtimin e kapitalit rregullator. Por, në vijim, ecuria e kapitalit rregullator nuk i është përgjigjur prirjes rritëse të kredive me probleme në portofolin e bankave. Megjithatë, në fund të vitit 2007, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivelin 17.1 për qind, duke mbetur kënaqshëm mbi nivelin minimal të kërkuar të treguesit, prej 12 për qind.

Për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, rënia e këtij treguesi gjatë vitit 2007 është më e theksuar në bankat e grupit G1 (grafik 21.a dhe grafik 21.b), me rreth 27 pikë përqindje – në nivelin 45.1 për qind. Rënia e këtij treguesi në këtë grup, vjen si pasojë e rritjes së peshës së aktiveve me rrezik dhe tregon për përpjekjet e këtyre bankave, për të përmirësuar eficiencën e veprimtarisë. Për grupet e bankave G2 dhe G3, rënia e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë vitit 2007 ka qenë e ulët, përkatësisht me 0.3 dhe 0.5 pikë përqindje, në nivelet 15.8 dhe 15.5 për qind.

Gjatë vitit 2007 dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2008, u vu re një rënie graduale e përdorimit të levës financiare për sistemin bankar sidomos në gjysmën e dytë të vitit, siç tregohet edhe në grafikun 22.a. Ulja e levës financiare ndërkohë që raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit kanë patur përgjithësisht prirje rënëse, sugjeron që aktivet e sektorit bankar janë rritur më pak se kapitali aksioner dhe njëkohësisht, janë zhvendosur drejt aktiveve më me rrezik. Raporti i kapitalit aksioner me totalin e aktiveve, në grafikun 22.b për sistemin bankar gjithashtu, është rritur përgjatë gjithë periudhës.

Grafik 20. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar.

20.a. Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në %.



20.b Kapitali bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 21. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.

21.a. Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në % për grupet e bankave sipas madhësisë së kapitalit



21.b Kapitali bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në % për grupet e bankave sipas madhësisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 22. Raporti i levës financiare për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.

22.a. Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve në %.



22.b. Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Kapaciteti i sektorit bankar për të përballuar me kapital humbjet e mundshme nga huatë me probleme, i shprehur nëpërmjet raportit të kredive me probleme neto ndaj treguesve të kapitalit (shih tabelën 6 më poshtë), ka vazhduar prirjen e tij rënëse (grafiqet 23.a dhe 23.b). Ritmi i rritjes së këtij raporti, është përshpejtuar në tremujorin e fundit të vitit 2007 dhe në tremujorin e parë të vitit 2008.

Tabelë 6. Raporti i kredisë me probleme neto ndaj treguesve të kapitalit.

	2008				2007	2006
Treguesit (në %)	mars	dhjetor	shtator	qershor	mars	dhjetor
Kredi me probleme neto / kapitali bazë	13.7	12.0	9.0	8.5	7.8	7.2
Kredi me probleme neto / kapitali rregullator	13.0	11.2	8.5	7.9	7.4	6.8
Kredi me probleme neto / kapitali aksioner	10.6	9.1	8.2	7.4	7.1	6.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vihet re se prirja e përkeqësimit të portofolit të kredisë në raport me treguesit e kapitalit është më e theksuar për bankat e grupeve G2 dhe G3 (grafiqet 24.a dhe 24.b). Ndërkohë që për grupin G1, aftësia e kapitalit për të përballuar humbjet nga huatë me probleme, paraqitet relativisht më e lartë dhe më e qëndrueshme.

Eficienca e sistemit bankar në përdorimin e kapitalit ka qëndruar pothuaj në të njëjtat nivele përgjatë gjithë vitit 2007 (grafik 25). Ky tregues është më i lartë së mesatarja evropiane. Rritja e huave me probleme dhe rritja e provigjonimeve përkatëse, mund të kenë ndikuar në uljen e fitimit për njësi të kapitalit. Rritja e normës së interesit bazë nga Banka e Shqipërisë dhe bankat qendrore të huaja, ka ndikuar në *spread*-in midis interesave të paguar në anën e pasiveve dhe atyre të fituar në anën e aktiveve, nga sistemi bankar (grafiqet 26, 27 dhe 28). Që prej fillimit të vitit 2007, vihet re prirja rënëse për grupin G3, ndërkohë që raporti është më i paqëndrueshëm për grupin G2 (grafik 29). Vërehet gjithashtu, një rënie e lartë e këtij treguesi për grupin G2, në tremujorin e parë të vitit 2008. Ndërkohë që, leva financiare për këtë grup gjatë të njëjtës periudhë, është rritur. Nga ana tjetër, rënia e treguesit të kthimit mbi kapitalin (ROE) mund të reflektojë edhe rritjen e provigjonimeve nga ky grup bankash, duke patur parasysh përkeqësimin e cilësisë së portofolit të kredisë.

Ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, siç tregohet nga raporti i pozicionit të hapur në valutë ndaj kapitalit bazë dhe kapitalit aksioner (grafik 30), ka pësuar një rritje në fund të tremujorit të parë të vitit 2008, në krahasim me vlerat historike që prej 4 vitesh. Për grup bankash sipas madhësisë, vihet re se megjithë luhatjet e mëdha gjatë periudhës, raporti i pozicionit të hapur neto ndaj kapitalit, mbetet brenda normave të lejuara për të gjitha grupet (grafiqet 31.a dhe 31.b). Rënia e menjëhershme e pozicioneve të hapura në muajin dhjetor pavarësisht vlerave të larta gjatë tremujorit, mund të reflektojë sjelljen sezonale të kursit të këmbimit dhe pozicionimin përkatës nga ana e bankave.

Grafik 23. Raporti i huave me probleme ndaj kapitalit për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Huatë me probleme neto ndaj kapitalit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Kthimi nga kapitali për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Normat e interesit për instrumentet në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 27. Normat e interesit për instrumentet në usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Normat e interesit për instrumentet në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 29. Kthimi nga kapitali për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit për sistemin bankar.

30.a Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit bazë në %.



30.b Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3 CILËSIA E AKTIVEVE

Në bilancet e bankave, konstatohet rritja e shpejtë e aktiveve me rrezik. Kështu, portofoli i kredisë është rritur si rezultat i pakësimit të qëndrueshëm të investimeve të sektorit bankar, në letrat me vlerë të qeverisë dhe në depozitat me Bankën e Shqipërisë. Në fund të vitit 2007, portofoli i kredisë zinte 39.1 për qind të aktiveve të sektorit bankar, kundrejt 31.5 për qind që ishte në fund të vitit 2006. Për të njëjtën periudhë, vlera e aktiveve (investimeve) me rrezik të ulët (ose pa rrezik) zbriti me 11.1 pikë përqindje, në nivelin 39.5 për qind. Në fund të muajit mars 2008, pesha e portofolit të kredisë në totalin e aktiveve të sektorit bankar, u ngjit në nivelin 40.4 për qind, ndërsa vlera e aktiveve me rrezik të ulët zbriti më tej, në nivelin 38.2 për qind.

Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive është rritur përgjatë gjithë periudhës, duke konfirmuar përkeqësimin e cilësisë së portofolit të kredive të sektorit bankar dhe duke treguar për një rritje të ekspozimit nga rreziku i kreditit. Në kushtet e zgjerimit ende të shpejtë të kredisë, raporti i kredive me probleme mund të përkeqësohet më tej, për shkak të vonesës në kohë të shfaqjes së problemeve, në kreditë e akorduara (grafiqet 37 dhe 38).

Duke patur parasysh analizën në pjesën e tretë të këtij raporti, me interes është aftësia e sektorit bankar për t'u mbrojtur nga rreziku i kreditit në procesin e kredidhënies. Ekzistenca e kolateralit në një vlerë të mjaftueshme, siguron rekuperimin e plotë ose të pjesshëm të kredisë, në rastin ekstrem të paaftësisë së plotë paguese të kredimarrësit, për pjesën e kredisë së mbetur. Sipas të dhënave paraprake dhe të përafërta, vlera e atyre kredive për të cilat ekziston kolaterali, rezulton rreth 58 për qind e vlerës së përgjithshme të portofolit të kredisë, në fund të muajit mars 2008 (grafik 32). Kjo vlerë është e konsiderueshme, në kushtet kur në llojin e kolateralit të përdorur në llogaritje

Grafik 32. Mbulimi i kredisë me kolateral.

Kredia e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme ndaj portofolit të kredisë (në total dhe në valutë) në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 33. Kredia e kolateralizuar ndaj portofolit të kredisë në valutat kryesore në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Kredia e kolateralizuar ndaj portofolit të kredisë në valutë ku kredimarrësi nuk kryen aktivitet në valutë në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

përfshihet vetëm pasuria e paluajtshme, si një formë kolaterali e preferuar nga bankat për kreditë për shtëpi për individët ose kreditë e investimit/zhvillimit për kompanitë e biznesit. Nëse në këtë raport do të përfshiheshin forma të tjera të kolateralit si edhe vlera e tij, vlera e këtij raporti do të ishte më e madhe. Për pjesën e portofolit të kredisë së dhënë në valutë, ky raport për të njëjtën periudhë ishte 56 për qind.

Gjithashtu (grafik 33) nga ekzaminimi i mbulimit të kredisë me kolateral për valutat kryesore, vihet re një ulje e ndjeshme e këtij treguesi për monedhën amerikane, në tremujorët e fundit. Kjo mund të tregojë një perceptim më të ulët të rrezikut për kredinë në këtë valutë nga sektori bankar, duke qenë se zhvlerësimet e pritura të dollarit do të forconin pozitat e huamarrësve. Megjithatë, vihet re një rritje e këtij treguesi për kredinë në valutë, ku kredimarrësi nuk ka të ardhura në të njëjtën valutë, gjë që mund të tregojë për një rritje të vëmendjes së sistemit bankar nga rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit.

Më hollësisht, në grafikun 34 vihet re një rritje e mbulimit me kolateral të kësaj lloj kredie, si në total ashtu dhe për kredinë me probleme, në tremujorët e fundit.

Gjatë vitit 2007 portofoli i kredisë (stoku) u rrit me 93.7 miliardë lekë ose me 34.2 për qind, në krahasim me vitin 2006. Kredia e re, e dhënë gjatë vitit 2007 ishte 246.2 miliardë lekë ose 56.8 për qind më e lartë se në vitin 2006. Përdorimi i kredisë (kredia e shlyer) gjatë vitit 2007 ishte 152.5 miliardë lekë ose rreth 75 për qind më e lartë se në vitin 2006. Raporti midis përdorimit të kredisë (kredisë së shlyer) dhe kredisë së re ka ardhur në rritje, duke shënuar nivelin 69.3 për qind në fund të muajit mars 2008.

Rritja e këtij raporti mund të jetë tregues i rritjes së eficiencës në procesin e dhënies së kredisë, dhe njëkohësisht gjen mbështetje në rritjen e të ardhurave nga interesat, për sektorin bankar. Analiza e shpërndarjes së portofolit të kredisë, si edhe e ecurisë e kohëzgjatjes mesatare[8] të tij, do të ishte e nevojshme për të mbështetur këtë konkluzion. Kjo, pasi nëse sektori bankar ka rritur përdorimin e

kredisë në kushtet kur ka ndryshuar përbërjen e saj sipas afateve të maturimit dhe ka rritur kohëzgjatjen mesatare, ka më tepër mundësi që ky përdorim i lartë i kredisë të tregojë më tepër një rritje të procesit të ristrukturimit të kredisë (marrë një kredi e re, për të shlyer një kredi ekzistuese).

Në vjim paraqitet grafiku i shpërndarjes së portofolit të kredisë sipas afatit të mbetur deri në maturim (grafiku 36). Grafiku tregon që përgjatë tre viteve të fundit, nuk ka patur ndryshime të ndjeshme në shpërndarjen e portofolit të kredisë sipas afateve të maturimit. Gjatë gjithë periudhës, pjesa e portofolit me maturim deri në 1 vit është zgjeruar gradualisht duke u luhatur rreth vlerës 41.5-43.5 për qind. Megjithatë, të dhënat ekzistuese janë të pamjaftueshme për të llogaritur afatin mesatar të maturimit për çdo segment.

Më i rëndësishëm është treguesi i kohëzgjatjes mesatare të portofolit të kredisë, në llogaritjen e të cilit përcaktohet afati mesatar i maturimit brenda çdo segmenti të portofolit të kredisë. Nga grafiku 37 konstatohet që ka një rritje të kohëzgjatjes mesatare të portofolit të kredisë, veçanërisht gjatë vitit 2007. Prej muajit qershor 2007, ky tregues është rritur më shpejt, duke shënuar vlera më të larta për të gjithë periudhën.

Analiza nuk mundëson arritjen e konkluzioneve përfundimtare (për shkak edhe të mungesës së të dhënave më të gjata në kohë), por sidoqoftë, prirja për rritjen e kohëzgjatjes mesatare është evidentuar qartë, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit 2007. Ekziston në këtë mënyrë mundësia, që rritja e përdorimit të kredisë veçanërisht në vitin e fundit, të pasqyrojë njëkohësisht edhe rritjen e rasteve të ristrukturimit të kredive (në formën e dhënies së një kredie të re, për të shlyer një kredi ekzistuese). Nëse është ky rasti, atëherë kjo sjellje mund të jetë diktuar nga vështirësitë e kredimarrësve për të shlyer kredinë dhe ajo i paraprin një përkeqësimi të mëtejshëm të cilësisë së portofolit të kredisë.

Në tremujorin e katërt të vitit 2007 pesha kryesore e kredive të sistemit rezulton e dhënë për individët (grafik 38 dhe 46), afërsisht 21.4 për qind. Vihet re një prirje rënëse e peshave të sektorëve të industrisë përpunuese dhe tregtisë, gjatë vitit 2007. Ndërkohë

Grafik 35. Përdorimi i kredisë ndaj kredisë së re.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 36. Përbërja e porofolit të kredisë sipas afatit të maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Kohëzgjatja mesatare e kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

që ajo përfaqëson përqendrimin më të madh të kredisë së sektorit bankar. Pesha e sektorit të ndërtimit në totalin e kredisë së akorduar, ka mbetur pothuaj e pandryshuar gjithë vitit 2007, rreth nivelit 14 për qind. Konstatohet një rënie e kredisë për sektorin e industrisë përpunuese, ndoshta e lidhur me rritjen e kostove për aktivitetet e industrisë.

Diversifikimi i mëtejshëm i portofolit të kredisë nga sektori bankar do të ulte rrezikun e veprimtarisë, si edhe do të rriste kontributin e tij në zhvillimin ekonomik të vendit. Një drejtim pothuaj plotësisht i pashfrytëzuar në këtë kuadër, mbetet sektori i bujqësisë. Në mënyrë që të rritet kontributi i sektorit bankar në zhvillimin e bujqësisë (duke përmirësuar në të njëjtën kohë edhe karakteristikat e rrezikut të veprimtarisë bankare), është e nevojshme të përshpejtohen reformat në drejtim të zgjidhjes së problemeve të pronësisë, krijimit të lehtësive për zgjerimin e sipërfaqeve të punueshme dhe futjen e teknologjisë së përparuar, përmirësimit të infrastrukturës së tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Këto elemente, të cilat zbusin ndjeshmërinë e sektorit të bujqësisë ndaj goditjeve të ndryshme, duhet të qëndrojnë në themel të nismave për të rritur kontributin e sektorit bankar në zhvillimin e bujqësisë në vend, duke ruajtur parametra të kontrolluar të rrezikut të veprimtarisë.

Pesha e aktiveve likuide në totalin e aktiveve të sistemit bankar, ka mbetur në nivele të larta megjithë prirjen rënëse të viteve të fundit. Për fundin e tremujorit të parë të vitit 2008 ajo shënoi vlerën 48.9 për qind (grafik 39). Kjo ecuri konfirmohet për të treja grupet e bankave (grafik 40). Megjithatë, për totalin e sistemit vihet re se përputhja e maturitetit midis detyrimeve dhe aktiveve është ruajtur në të njëjtat nivele[9] (grafik 41). Mbajtja e këtij treguesi në nivele të larta është veçanërisht e rëndësishme nga pikëpamja e qëndrueshmërisë së sektorit bankar, në kushtet ku tregjet financiare ndërkombëtare vuajnë ende pasojat e krizës së likuditetit dhe financimi i nevojave për likuiditet nga bankat-mëma mungon ose është më i shtrenjtë. Vihet re gjithashtu, se deri në dhjetor 2007 kriza financiare ndërkombëtare nuk ka shkaktuar probleme likuiditeti në sektorin bankar shqiptar. Raporti i mbulimit të detyrimeve afatshkurtra me aktivet likuide, mbetet gjithashtu në nivele të mira.

Kthimi nga aktivet për sistemin bankar (grafik 42) përgjatë vitit 2007 ka rezultuar në nivele të larta, duke shfaqur një prirje rritëse gjatë vitit 2007, megjithë përkeqësimin e portofolit dhe rritjen e aktiveve të sektorit bankar. Në tremujorin e parë të vitit 2008 vihet re një rënie e konsiderueshme e këtij treguesi në nivelin 1.28 për qind, që i dedikohet si rënies së fitimit ashtu edhe rritjes së qëndrueshme të totalit të aktiveve. Për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, raporti është rritur në mënyrë të qëndrueshme për bankat e grupit G3. Për bankat e G2, ky raport shfaq një prirje rënëse që prej tremujorit të tretë të vitit 2007 (grafik 43), për shkak të të njëjtave arsye që u përmendën më sipër.

Grafik 39. Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve për sistemin bankar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 40. Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 41. Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 42. Kthimi nga aktivet për sistemin bankar.

Kthimi nga aktivet (RoA) - të ardhurat neto ndaj aktive totale mesatare, bazë vjetore në %



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 43. Kthimi nga aktivet për grupbankat sipas madhësisë së aktivitetit.

Kthimi nga aktivet me bazë vjetore (RoA) në %



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 44. Huatë me probleme bruto ndaj huave totale për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 45. Huatë me probleme ndaj huave totale për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 46. Shpërndarja e huave sipas sektorëve të industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

4.4 TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE

Me uljen e levës financiare, kostoja e huamarrjes për sistemin bankar mbetet relativisht e ulët. Rezultati financiar është pozitiv prej një kohë të gjatë, dhe paraqet një burim të qëndrueshëm të rritjes së kapitalit dhe të zgjerimit të veprimtarisë. Sektori bankar ka një varësi të theksuar ndaj të ardhurave nga interesi, për shkak të përqendrimit të investimeve të sektorit bankar në letra me vlerë e kredi, dhe për shkak të konkurrencës së pamjaftueshme. Kjo varësi pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen e parashikueshme, për sa kohë ekziston kërkesa për kredi dhe hapësira për dhënien e saj nga sektori bankar. Varësia ndaj të ardhurave nga interesi e bën sektorin bankar të ndjeshëm ndaj faktorëve që mund të shkaktojnë një ngadalësim të rritjes së kredisë ose të mbledhjes së depozitave. Për këtë arsye, duhet të synohet zgjerimi i burimit të gjenerimit të të ardhurave, kryesisht nëpërmjet zgjerimit të produkteve bankare dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto për sistemin bankar (grafik 47), ka patur një prirje rritëse gjatë vitit 2007 dhe në fund të tremujorit të parë të vitit 2008, duke kapur nivelin 100 për qind. Gjatë vitit 2007, treguesi është luhatur për shkak të rritjes së provigjonimeve për huatë me probleme. Në tremujorin e parë të vitit 2008, vihet re një rritje më e lartë e të ardhurave nga interesat (10 për qind), në krahasim me të ardhurën bruto (2 për qind). Faktorët që mund të kenë ndikuar janë ulja e levës financiare dhe rritja e provigjoneve, për shkak të përkeqësimit të portofolit të kredisë. Ndërkohë diferenca midis normave të interesit për të gjitha valutat është ulur ndjeshëm, në tremujorin e parë të vitit 2008.

Ulja e mëtejshme e normave të interesit për monedhën amerikane nga ana e FED, do të rrisë diferencën me normën e interesit të lekut dhe do të mbështesë më tej dhënien e kredisë në këtë valutë. Financimi i zgjerimit të kredisë në valutë

nga banka të veçanta, mund të ndeshte vështirësi, në kushtet e një rënieje të mundshme të dërgesave financiare nga emigrantët dhe të një rritjeje të konkurrencës për grumbullimin e depozitave. Për këtë arsye, bankat do të detyroheshin të ruanin nivelet ekzistuese të normave të depozitave në valutë, duke qenë se depozitat në valutë janë mënyra kryesore e financimit të kredisë në valutë. Përndryshe, disa nga bankat mund t'i drejtoheshin huamarrjes nga grupi për fonde në valutë që kanë interesa të ulët. Por duhet thënë që megjithë situatën e vështirë të likuiditetit në tregjet ndërkombëtare financiare, në sajë të prezencës së presioneve të vazhdueshme inflaioniste, ulja e normave bazë të interesit për valutat e tjera kryesore ka më pak të ngjarë të ndodhë. Në këtë mënyrë, efekti i këtyre lëvizjeve të normave të interesit, në nxitjen e krediitimit në valutë në vendet në zhvillim, do të jetë më i zbutur.

Për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit vihet re se rritja e raportit të marzhit të interesave ndaj të ardhurave bruto (grafik 48) në tremujorin e parë të vitit 2008, ka qenë më e lartë për grupin G2.

Raporti i "shpenzime jo për interesa" ndaj "të ardhurat bruto" (grafik 49) ka patur një prirje rënëse gjatë gjithë vitit 2007, duke reflektuar një ekspozim në rënie ndaj rrezikut operativ. Megjithatë, gjatë tremujorit të parë të vitit vihet re një rritje e lartë e këtij raporti, veçanërisht për bankat e G2, e cila i dedikohet kryesisht rritjes së provigjoneve për shkak të përkeqësimit të portofolit të kredisë.

Grafik 47. Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto për sistemin bankar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 48. Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 49. Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto për sistemin bankar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Grafik 50. Shpenzime interesi ndaj të ardhurave bruto për grup-bankat sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

5. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE

Një sistem pagesash i sigurt dhe eficient është një faktor i rëndësishëm në shlyerjen e transaksioneve në tregjet financiare si dhe në stabilitetin e sistemit financiar. Roli i Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave synon nxitjen dhe mbështetjen e mirëfunksionimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, veçanërisht me qëllim që të arrihet:

a) stabiliteti dhe besueshmëria e sistemeve të pagesave, duke identifikuar, parandaluar dhe zgjidhur në kohë rreziqet e mundshme;
b) transparenca e kuadrit operacional të sistemeve të pagesave dhe eficienca e tyre;
c) ruajtja e besimit të publikut në instrumentet dhe shërbimet e pagesave që përdoren;
d) promovimi i automatizimit në përdorimin dhe procesimin e instrumenteve të pagesave si dhe ndëroperabiliteti i sistemeve mbështetëse.

Banka e Shqipërisë zotëron dhe administron dy sisteme të pagesave në lekë: *"Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS"*[10] *dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH"*[11]. Të dyja sistemet, kanë filluar të operojnë prej katër vjetësh dhe janë përmirësuar në vazhdimësi, duke synuar ruajtjen e eficiencës së tyre. Karakteristikat teknike të funksionimit tregojnë shkallën e sigurisë dhe të eficiencës. Kështu, sistemi AIPS ka qenë i aksesueshëm nga pjesëmarrësit në 99.85 për qind të orarit të tij të operimit, pra, në 248 ditë pune sistemi ka qenë i padisponueshëm vetëm për 2 orë e 35 minuta, si pasojë e problemeve teknologjike apo teknike.

Gjatë vitit 2007, numri i transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS është rritur me 17 për qind, krahasuar me vitin 2006. Ndërkohë pagesat e procesuara në sistemin AECH, pothuajse janë dyfishuar, duke u rritur me 47 për qind krahasuar me vitin 2006. Numri më i madh i transaksioneve është përqendruar në tremujorin e fundit të vitit, veçanërisht për sistemin AECH.

Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar rreth 183 transaksione me një vlerë totale prej 15.1 miliardë lekësh, ndërsa në sistemin AECH rreth 290 transaksione me një vlerë totale ditore prej 48 milionë lekësh. Tabelat në vijim pasqyrojnë numrin dhe vlerën totale të pagesave të procesuara, përkatësisht në sistemet AIPS dhe AECH, gjatë vitit 2007, krahasuar me vitin 2006:

Tabelë 7. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	2006	2007
Numri i transaksioneve	38,793	45,480
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,376	3,745
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	87.01	82.34

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Tregues për transaksionet në sistemin AECH.

Sistemi AECH	2006	2007
Numri i transaksioneve	48,889	71,857
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	7.77	11.99
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	0.16	0.17

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përveç numrit të transaksioneve të procesuara në sisteme, rritje të rëndësishme ka patur edhe vlera e tyre. Gjatë vitit 2007, rritja në vlerën e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS dhe atë AECH rezulton të jetë përkatësisht me 11 dhe 56 për qind, krahasuar me vitin 2006. Vlera totale e likuiditeteve të shlyera në sistemet e pagesave gjatë vitit 2007, rezulton të jetë katërfishi i vlerës së Prodhimit të Brendshëm Bruto për vitin[12].

Në mënyrë më të detajuar, llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS gjatë vitit 2007 dhe pesha e tyre relative, paraqiten në tabelën 9:

Tabelë 9. Llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS.

Lloji i pagesës	Volum		Vlerë (në miliardë lekë)	
	Vlerë absolute	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione të B.SH	7,467	16.4%	2,166.55	57.9%
Transferim fondesh *cash*	8,455	18.6%	221.43	5.9%
Pagesa ndërbankare	7,831	17.2%	664.49	17.7%
Pagesa për klientët	16,506	36.3%	134.93	3.6%
Shlyerje në bazë neto	3,224	7.1%	8.99	0.2%
Shlyerje letra me vlerë të qeverisë	1,997	4.4%	548.46	14.6%
Totali	45,480	100%	3,744.85	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahasuar me të njëjtët zëra të vitit të kaluar, vërejmë se një peshë të konsiderueshme në rritjen e numrit të transaksioneve, zë numri i pagesave për klientët. Përsa i përket vlerës së transaksioneve, rritje e konsiderueshme reflektohet në zërin e transaksioneve të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, si edhe në transaksionet ndërbankare.

Nga pikëpamja e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të stabilitetit të sistemeve të pagesave, vlerësohet edhe shkalla e përqendrimit të pagesave në nyje të veçanta të rrjetit. Tregues të përqendrimit për dy sistemet AIPS dhe AECH, paraqiten si në tabelën 10 dhe 11:

Tabelë 10. Tregues të përqendrimit për sistemin AIPS.

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (mld lekë)
Sistemi AIPS	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka[13]	33%	30%
5 banka	45%	39%
Totali (vlerë absolute)	45,480	3,745

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 11. Tregues të përqendrimit për sistemin AECH.

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (mln lekë)
Sistemi AECH	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka[14]	50%	53%
5 banka	66%	65%
Totali (vlerë absolute)	71,587	11,997

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat kanë përdorur lehtësinë që ofron sistemi i pagesave për "kredinë brenda ditës". Krahasuar me vitin 2006, numri dhe vlera e transaksioneve për "kredinë brenda ditës" gjatë vitit 2007, janë rritur përkatësisht me 52 dhe 47 për qind.

Tabelë 12. Përdorimi i kredisë brenda ditës.

Kredi brenda ditës (ILF)	2006	2007
Numri i transaksioneve	444	675
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	146.32	217.51
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	329.55	322.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2007, 11 banka kanë përdorur "kredinë brenda ditës", 3 më shumë se gjatë vitit 2006. Nga analiza e përqendrimit të transaksioneve sipas bankave, konstatohet se 5 banka kanë qenë aktive në përdorimin e këtij instrumenti, për menaxhimin e likuiditetit brenda ditës. Rreth 85 për qind e totalit të vlerës së "kredisë brenda ditës", është e përqendruar në dy banka.

Në tërësinë e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë ofron edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes në bazë neto, të vlerës së çeqeve të procesuara nga bankat. Përdorimi i çekut si instrument pagese në formë "letër", në Shqipëri ka vazhduar të jetë në rënie edhe gjatë vitit 2007, si në numër (45 për qind më pak çeqe të shlyera), ashtu edhe në vlerë (65 për qind më pak vlerë monetare e shlyer), krahasuar me vitin 2006. Peshën kryesore në rënie e zë përdorimi gjithnjë e më i ulët i çekut bankar.

Tabelë 13. Shlyerja e çeqeve në AIPS.

Shlyerja e çeqeve në AIPS	2006	2007
Numri i çeqeve të shlyera	994	544
Vlera e çeqeve (miliardë lekë)	3.76	1.33

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.1. INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE

Instrumentet e pagesave elektronike dhe numri i transaksioneve që kryhen me to, po rriten gjithnjë e më shumë. Gjatë vitit 2007, vërehet një rritje e konsiderueshme, prej 74 për qind e numrit të kartave në përdorim, kryesisht karta me funksion debiti/*cash*-i, krahasuar me vitin 2006. Janë shtuar gjithashtu terminalet për përdorimin e kartave, kryesisht terminalet POS të vendosura në pika shitjeje, me një rritje prej 47 për qind krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2006. Përsa i përket shpërndarjes gjeografike të terminaleve ATM dhe POS të ofruara nga bankat, mund të themi se përqendrimi më i madh i tyre është në rajonin e Tiranës. Gjithsesi, vlen të përmendet një tendencë në rritje e shtrirjes së tyre edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Tabelë 14. Përdorimi i kartave bankare.

Karta bankare	2006	2007
Numri i kartave të debitit/cash-i	335,856	591,355
Numri i kartave të kreditit	9,754	12,991

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Numri i terminaleve ATM dhe POS.

Terminale ATM dhe POS	2006	2007
Numri i terminaleve ATM	309	443
Numri i terminaleve POS	1,234	1,832

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të numrit të kartave apo terminaleve për përdorimin e tyre, një rritje më modeste vërehet në numrin dhe në vlerën e transaksioneve që kryhen me karta bankare, respektivisht prej 17 dhe 26 për qind. Kjo shpjegohet nga fakti se kartëmbajtësit ende nuk kanë besimin e duhur dhe/apo mundësitë për ta përdorur kartën si mjet pagese. Thënë ndryshe, në përpjestim me numrin e popullsisë[15], mesatarisht, një në pesë persona është mbajtës i një karte dhe çdo kartëmbajtës kryen jo më shumë se 16 transaksione në vit. Pra, sistemi bankar është akoma në hapat e parë të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, krahasuar me statistikat e raportuara nga vendet e rajonit.

Karta Debiti	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	8,053	9,249
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	47.81	59.04
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	5,940	6,390

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 16. Transaksionet me kartat e debitit.

Karta Krediti	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	176	363
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.2	5.3
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	18,207	14,635

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 17. Transaksionet me kartat e kreditit.

Prirje pozitive vërehet edhe në lidhje me përdorimin e "*Home Banking*", si instrument elektronik pagese. Aktualisht, në Shqipëri janë tre banka që ofrojnë shërbime me këtë instrument pagese. Krahasuar me vitin 2006, gjatë vitit 2007 vërehet një rritje përkatësisht prej 122 për qind në numrin e transaksioneve *"Home Banking"* dhe 188 për qind rritje, në vlerën e transaksioneve të procesuara. Kjo rritje kryesisht është pasojë e shtimit të 2 bankave në ofrimin e këtij shërbimi, gjatë vitit 2007.

Home Banking	2006	2007
Numri i transaksioneve	19,096	42,447
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	16.83	48.49
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	881.34	1,142.36

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 18. Përdorimi i home – banking.

5.2. MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

"Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes është një funksion i Bankës Qendrore, sipas të cilit, objektivat e sigurisë dhe eficiencës promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt këtyre objektivave dhe, aty ku është e nevojshme, duke stimuluar ndryshime"[16].

Gjatë vitit 2007, puna e Bankës së Shqipërisë në lidhje me këtë funksion, u përqendrua në:

Përmirësimin e bazës rregullative për sistemet e pagesave, ku është punuar për rishikimin e disa rregulloreve ekzistuese duke synuar përmirësimin e tyre në përputhje me zhvillimet e reja në tregun e pagesave, si edhe me direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet më të mira të bankave qendrore.

Hartimin e dokumentit "Politika për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave", finalizimi i të cilit u krye në muajt e parë të vitit 2008. Ky dokument synon parashikimin e bazës ligjore, objektivat e mbikëqyrjes, vlerësimin e rreziqeve që ndeshen në sistemet e pagesave, si dhe zbatimin e mbikëqyrjes nëpërmjet monitorimit dhe analizave. Dokumenti parashikon përputhshmërinë e sistemeve të pagesave me parimet themelore të sistemeve me rëndësi sistemike, si edhe bashkëpunimin me departamentet e tjera për zbatimin e politikës së mbikëqyrjes.

Përmirësimin e infrastrukurës së sistemeve të pagesave dhe vlerësimin e sigurisë, për të cilin gjatë vitit 2007 janë aplikuar disa versione të reja të sistemeve, që kanë ndihmuar në përsosjen dhe modernizimin e mëtejshëm të tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, është ndërtuar një ndërfaqe për komunikim elektronik midis sistemeve AIPS e AECH dhe programit të Thesarit të Ministrisë së Financave. Kjo lidhje elektronike midis sistemeve do të përshpejtojë komunikimin dhe shlyerjen e pagesave të iniciuara nga Ministria e Financave, si edhe do të minimizojë rrezikun operacional që rrjedh nga hedhja manuale e veprimeve në sistem. Vëmendje i është kushtuar edhe vlerësimit të sigurisë dhe eficiencës së sistemeve. Për qëllime vlerësimi, janë realizuar testime për sigurinë e sistemeve (Back-up për sistemet AIPS dhe AECH). Ndërtimi i një back-up-i në distancë do të përmbushte plotësisht parimin themelor për sigurinë dhe eficiencën e sistemeve, proces i cili mbetet për t'u zbatuar në të ardhmen.

Grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e statistikave mbi instrumentet e pagesave në Shqipëri, ku puna është përqendruar në mbledhjen e të dhënave dhe në rritjen e cilësisë së raportimit nga bankat, duke synuar unifikimin e termave dhe të raporteve. Në vijim, puna do të vazhdojë në rishikimin e metodologjisë ekzistuese të raportimit të instrumenteve të pagesave.

Për të plotësuar më tej anën rregullative të një sistemi modern pagesash, ndihet nevoja e hartimit të një ligji të veçantë mbi Sistemin e Pagesave. Gjatë vitit 2008, do të fillojë puna për realizimin e këtij synimi, në bashkëpunim me institucione të tjera dhe me sektorin bankar.

6. ANALIZA "STRESS-TEST"

Analiza "stess-test" tregon se sektori bankar në tërësi paraqitet i mbrojtur nga rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit, rreziku i drejtpërdrejtë i normës së interesit dhe rreziku i tërthortë i kredititi nëpërmjet ndryshimit të normave të interesit. Për sektorin bankar rreziku i drejtpërdrejtë i kredititi, rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit nëpërmjet huadhënies në valutë shfaqet në nivele të përballueshme, ndërkohë që për disa banka të veçanta këto rreziqe paraqiten të rëndësishme.

Aplikimi i metodologjisë "*stress-test*" mbi bilancin e bankave shërben për të zbuluar dobësitë e mundshme me të cilat mund të përballet sistemi ynë bankar, si rezultat i goditjeve ekstreme por të mundshme. Ndër rreziqet e mundshme analizohet rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i kreditit, rreziku i normës së interesit si dhe rreziqet indirekte të kreditit nëpërmjet kredidhënies në valutë dhe nëpërmjet luhatjeve të normave të interesit. Në hapësirën informuese 5.1 të këtij raporti jepen më shumë detaje në lidhje me metodologjinë stress-test.

Secili prej rreziqeve të përmendura më lart mund të shfaqet më i thelluar ose më pak i thelluar në bazë të cilësive që karakterizojnë sistemin tonë bankar. Kështu, aktualisht pjesa më e madhe e kredidhënies realizohet në valutë të huaj, kryesisht në euro dhe dollarë (afërsisht 73 për qind[17]). Rreziku i kursit të këmbimit, që mund të përballen bankat në lidhje me këto kredi është relativisht i kufizuar, pasi një përqindje e lartë e depozitave në sektorin bankar është në valutë dhe raporti i aktiveve në valutë kundrejt pasiveve në valutë është 100 për qind. Në këtë mënyrë, si rezultat i pjesës së konsiderueshme të pozicioneve në valutë në të dyja anët e bilancit, rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit është më pak i ndjeshëm. Megjithatë, rreziku i tërthortë i kreditit shoqëron kredidhënien në valutë.

Rreziku i kreditit përbën një ndër rreziqet kryesore me të cilat përballet sistemi ynë bankar. Ky rrezik ekziston si rezultat i mundësisë që kredidhënësi të humbasë të gjitha ose një pjesë të rëndësishme të fondeve që ka dhënë kredi, për shkak të paaftësisë paguese të kredimarrësit. Ky rrezik përfaqësohet drejtpërdrejt me raportin e huave me probleme ndaj totalit të huasë së dhënë. Niveli i kredidhënies është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Aktualisht, raporti i kredisë ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar është afërsisht 41 për qind.

Një tjetër rrezik ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar është ai i normës së interesit. Ky rrezik lidhet me ndikimin që kanë luhatjet e normës së interesit për monedhat lek, euro dhe dollar, në koston e burimeve të financimit dhe në vlerën e investimeve, dhe në përfundim mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe nivelin e kapitalit rregullator.

Rreziku i kursit të këmbimit lidhet me ndikimin në rezultatin financiar të një institucioni me një pozicion të hapur valutor të caktuar, si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit.

Në vijim, jepen rezultatet e analizës stress-test për secilin nga rreziqet e përmendura më sipër. Analiza është realizuar për sektorin bankar në tërësi, për grupet e bankave G1, G2, G3 dhe për secilën nga bankat. Në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e analizës jepen në tabelën 19.

6.1. RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Rreziku i kursit të këmbimit vlerëson efektin që sjell mbiçmimi/nënçmimi i monedhës vendase ndaj dy monedhave të huaja kryesore (usd, euro) mbi normën e mjaftueshmërisë dhe kapitalin rregullator.

Një nënçmim i supozuar i *monedhës amerikane* kundrejt asaj vendase me 50 për qind, do të ulte normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit, me 0.3 pikë përqindjeje. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për pjesën më të madhe të bankave shënon një rënie, por jo nën nivelin minimal të lejuar prej 12 për qind. Edhe për një goditje më të madhe se 100 për qind, kapitali rezulton në nivele të mjaftueshme për të mbrojtur bankat nga rreziku direkt i kursit të këmbimit. Për sa i përket grupeve, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet G1, G2 dhe G3 bie përkatësisht me 0.5, 0.2 dhe 0.3 pikë përqindjeje, pa paraqitur ndjeshmëri ndaj këtij rreziku.

Për sa i takon nënçmimit të monedhës evropiane (euro) kundrejt monedhës vendase (lek) me 50 për qind, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit ulet me 0.3 pikë përqindjeje, duke mbetur mbi kufirin minimal të lejuar dhe duke treguar se sektori bankar mbetet i mbrojtur ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të ndryshimit të kursit të euros[18]. Përsa i përket grupeve të bankave sipas madhësisë, normat e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet G1, G2 dhe G3 kanë rënë me përkatësisht 1, 0.1 dhe 0.3 pikë përqindjeje, duke mbetur mbi kufirin e lejuar.

Në përfundim, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, për grupet G1, G2 dhe G3 rezulton mbi nivelin minimal të lejuar edhe pas aplikimit të një nënçmimi më të lartë së 50 për qind të monedhës amerikane (usd) apo asaj evropiane (euro). Sistemi bankar si dhe banka të veçanta përgjithësisht vlerësohen si të mbrojtura ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit, duke qenë se goditja e aplikuar e një nënçmimi prej 50 për qind, ka pak të ngjarë të ndodhë në realitet.

6.2. RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Ky test vlerëson ndjeshmërinë e kapitalit rregullator dhe të normës së mjaftueshmërisë, si rezultat i ndryshimit në koston e financimit dhe në vlerën e investimeve (detyrime dhe asete), për shkak të një ndryshimi të normës së interesit. Goditja aplikohet për të treja monedhat; atë vendase, monedhën amerikane dhe atë evropiane. Si normë interesi reference, për çdo monedhë është llogaritur norma mesatare e ponderuar e depozitave të reja dhe e kredive të reja në sistemin bankar. Vlerës aktuale të normës së interesit për monedhat e mësipërme i shtohet një vlerë e caktuar, e cila përbën një goditje të normës së interesit relativisht të madhe[19].

Për një rritje të normës së interesit për monedhën vendase me 3 pikë përqindje, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar rezulton me një rënie prej 1.7 pikë përqindjeje por duke mbetur përsëri mbi nivelin e lejuar prej 12 për qind. Po kështu, për grupbankat sipas madhësisë, rënia më e madhe e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit është më e madhe për G3, me rreth 2.2 pikë përqindjeje, por duke mbetur mbi normën e lejuar. Për banka të veçanta norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie nën nivelin e lejuar prej 12 për qind edhe për goditje më të vogla, dhe si pasojë më të mundshme për të ndodhur. Niveli i rritjes së normës së interesit të lekut, për të cilën preket

niveli minimal i normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për një bankë, është 1.25 pikë përqindjeje. Mund të konkludojmë që një goditje, e cila për nga madhësia është pak e mundur të ndodhë në realitet, nuk shkakton probleme në treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator për sistemin bankar, por banka të veçanta paraqesin një rritje të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në lekë.

Goditja e dytë mat ndikimin mbi kapitalin rregullator të sektorit, të një rritjeje prej 3 pikë përqindjeje të normës aktuale të interesit në monedhën amerikane, e cila si rezultat i goditjes merr vlerën 6.11 për qind (nga 3.11 për qind që është në fund të dhjetorit 2007).

Bazuar në rezultatet e testit, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar ka shënuar një rënie prej 0.1 pikë përqindjeje, pas aplikimit të goditjes. Grupet e bankave më të ndjeshme kanë rezultuar grupet G1 dhe G3, në të cilat norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie me 0.2 pikë përqindjeje. Megjithatë, ajo mbetet mbi normën minimale të lejuar. Banka të veçanta rezultojnë më të ndjeshme edhe ndaj goditjeve më të vogla të rritjes së normës së interesit; niveli i rritjes së normës së interesit të dollarit amerikan, për të cilën preket niveli minimal i normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për çdo bankë, është 2.5 pikë përqindje.

Goditja e tretë mat ndikimin mbi kapitalin rregullator të sistemit të një rritjeje prej 3 pikë përqindjeje të normës aktuale të interesit në monedhën evropiane, e cila si rezultat i goditjes merr vlerën 7.6 për qind (nga 4.6 për qind që është në mars 2008).

Bazuar në rezultatet e testit, kapitali rregullator i sistemit ka pësuar një rënie prej rreth 1.2 miliardë lekësh. Ndërsa norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin ka shënuar një rënie prej 0.4 për qind, duke mbetur gjithësesi mbi nivelin minimal të lejuar. Për sa i përket grupeve sipas madhësisë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin G1 rritet me 0.2 pikë përqindje, për grupin G3 bie me 0.6 pikë përqindje dhe nuk ndryshon për grupin G2. Theksojmë se norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për asnjërin nga grupet nuk bie nën normën e lejuar.

Si përfundim, aftësia e kapitalit rregullator për të mbuluar rrezikun e normës së interesit shfaqet e mjaftueshme për sektorin bankar. Aplikimi i një goditjeje relativisht të madhe mbi normën mesatare të interesit për aktivitetin në lekë, usd dhe euro tregon që norma e mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet mbi nivelin e lejuar prej 12 për qind. Megjithatë, për banka të veçanta ekziston një rrezik i moderuar i ndryshimit të normës së interesit në lekë dhe në usd.

6.3. RREZIKU I KREDITIT

Testi i rrezikut të kreditit realizohet mbi bazën e rritjes 100 për qind të kredive me probleme dhe të ndikimit të saj mbi kapitalin rregullator të të gjithë sektorit, dhe të bankave individuale.

Prej këtij testi, rezulton që kapitali rregullator i sektorit bankar ka rënë me rreth 5 miliardë lekë dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ka rënë me 1.5 pikë përqindje, duke mbetur mbi nivelin minimal të kërkuar. Për sa i përket grupeve, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit paraqitet e ndjeshme për grupet G2 dhe G3, në të cilat bie me përkatësisht 2.2 dhe 1.3 pikë përqindjeje. Edhe pse për grupimet e mësipërme, në të gjitha rastet, norma rezulton mbi kufirin minimal të lejuar, për banka të veçanta norma e mjaftueshmërisë bie nën nivelin 12 për qind, duke treguar se rreziku i kreditit është kryesor për to. Ndaj një goditjeje më të lartë, për shembull rritje e kredisë me probleme me 150 për qind, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit rezulton problematike për të njëjtat banka, si në rastin e mësipërm.

Si përfundim, rritja me 100 për qind e kredive me probleme ul nën nivelin e lejuar normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për disa banka të veçanta, ndërkohë që ulja e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar është relativisht e madhe, por jo nën nivelin minimal të kërkuar.

6.4. RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT NËPËRMJET KREDIDHËNIES NË VALUTË

Ky test mat ndikimin e luhatjeve të kurseve të këmbimit mbi ndryshimin e nivelit të kredive me probleme në valutë, kur kredimarrësit nuk kanë të ardhura në valutë. Aktualisht, kreditë në valutë për kredimarrësit që nuk kanë të ardhura në monedhën që jepet kredia, janë rreth 50 për qind të totalit të kredisë. Ky ndikim llogaritet nëpërmjet ekuacionit të regresionit, që lidh ndryshimin relativ të të ardhurave vjetore me ndryshimin e raportit të kredisë me probleme në valutë. Ndryshimi i të ardhurave vjetore lidhet me ndryshimin e kursit të këmbimit, nëpërmjet raportit të levës e si rrjedhojë, raporti i kredisë me probleme shprehet në funksion të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Në këtë mënyrë, nënçmimi i monedhës vendase me 50 për qind kundrejt monedhës euro, ndikon në uljen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar me 1.5 pikë përqindje. Për grupet e bankave sipas madhësisë së kapitalit, rënia e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit (G1, G2 dhe G3) është përkatësisht 0.6, 2.5 dhe 1.3 pikë përqindje, duke rezultuar gjithsesi mbi nivelin e lejuar. Vlen të theksohet megjithatë, se për banka të veçanta, rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit paraqitet relativisht i lartë. Kështu, për goditje të kursit në masën e një nënçmimi mbi 10 për qind, ekzistojnë banka ku norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie poshtë nivelit minimal të kërkuar.

Goditja e dytë, nënçmimi i monedhës vendase me 60 për qind ndaj dollarit amerikan, ndikon në reduktimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit, me 0.2 pikë përqindjeje dhe madhësinë e kapitalit rregullator, me afërsisht 0.6 miliardë lekë. Bankat e veçanta si dhe grupe të ndryshme paraqesin diferenca të papërfillshme pas aplikimit të kësaj goditjeje, përveç grupit G1 ku rënia në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit është në masën 0.8 pikë përqindje, por gjithsesi mbeti mbi nivelin e lejuar. Aplikimi i goditjeve më të mëdha jep të njëjtin rezultat.

Si përfundim, sektori bankar shqiptar në total nuk shfaq ndjeshmëri të lartë ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit si për euron ashtu edhe për usd. Për banka të veçanta megjithatë, rreziku i tërthortë i nënçmimit të monedhës vendase ndaj euros paraqitet relativisht i lartë, për disa prej tyre.

6.5. RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT NËPËRMJET LUHATJEVE TË NORMAVE TË INTERESIT

Aftësia paguese e kredimarrësve është e lidhur ngushtë dhe me luhatjet e normave të interesit për monedhat përkatëse. Kështu, luhatjet e normave të interesit nuk pakësojnë vetëm kapitalin e bankës në momentin e hendekut të gjerë midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, por rrisin edhe koston e kredisë për kredimarrësit, duke çuar në përkeqësimin e aftësisë së tyre paguese, e për pasojë në rritjen e portofolit të kredive me probleme për bankën. Ky test merr në konsideratë ndikimin e goditjeve të normave të interesit mbi portofolin e kredisë, respektivisht sipas monedhave kyesore euro, usd dhe lek.

Kështu, rritja me 5 pikë përqindje e normës aktuale (mesatare) të interesit për kredinë në euro në nivelin 12.8 për qind, do të shkaktonte rënien e normës së mjaftueshmërisë së sistemit me 0.8 pikë përqindje, duke rezultuar mbi kufirin lejuar. Për grupet e bankave sipas madhësisë, efekti është më i ndjeshëm për bankat e G1 të cilat pësojnë një rënie prej 1.8 pikë përqindje, ndërkohë që rënia në grupet G2 dhe G3 është përkatësisht 0.8 dhe 0.7 pikë përqindje, duke rezultuar mbi nivelin minimal të kërkuar. Megjithatë, për banka të veçanta efektet kanë një variancë të lartë; për disa nga bankat e sektorit, kapitali rregullator është i pamjaftueshëm për të përballuar goditje, të cilat janë më të mëdha se një rritje mbi 1 për qind në normën e interesit të kredisë.

Goditja e dytë, supozon rritjen e normës aktuale (mesatare) të interesit për kredinë në usd, nga 6.9 për qind në 11.9 për qind. Kjo do të shkaktonte rritjen e detyrimeve/borxhit të të gjithë kredimarrësve në usd me 0.39 për qind dhe, për pasojë, rritjen e portofolit të kredisë me probleme të sistemit me gati 3.9 për qind. Kapitali rregullator i sistemit bankar do të pakësohej me 196 milionë lekë dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të binte lehtësisht me 0.1 pikë përqindje. Edhe në nivel grupesh G1, G2, G3, efekti i këtij *shock*-u mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit është thuajse i pakonsiderueshëm.

Goditja e tretë, rritja me 5 pikë përqindjeje e normës aktuale të interesit për kredinë në monedhën vendase, nga niveli 12.3 për qind në nivelin 17.3 për qind, do të shkaktonte një rënie në normën mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar, me 0.2 pikë përqindjeje. Për grupet e bankave sipas madhësisë dhe sipas origjinës së kapitalit norma e mjaftueshmërisë së kapitalit nuk paraqet ndryshim të rëndësishëm nga kjo goditje.

Si përfundim, rritja me 5 pikë përqindje e normës aktuale të interesit për kreditë në lekë, usd dhe euro, nuk ka efekte të ndjeshme mbi aftësinë e

kapitalit rregullator të sistemit bankar për të mbuluar humbjet që vijnë si pasojë e shtrenjtimit të kredisë për klientët e bankave. Pavarësisht, për banka të veçanta, një rritje më e madhe se 1 për qind e normës së interesit për kreditë në euro do të kërkonte rritjen e kapitalit rregullator, për të përballuar rrezikun e tërthortë të normës së interesit.

Tabelë 19. Rezultate të përmbledhura të analizës "stress-test".

		Goditjet	Sektori bankar	Grupet sipas madhësisë së aktiveve			Banka të veçanta
				G1	G2	G3	
Rreziku i kredisë		Rritja 150% e kredive me probleme	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
		Rritja 100% e kredive me probleme	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
Rreziku i drejtpërdrejtë i normës së interesit	1. Lekë	Rritje e normës së interesit në lek me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
		Rritje e normës së interesit në lek me më shume se 1.25%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
	2. Usd	Rritje e normës së usd me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
		Rritje e normës së usd me më shumë se 2.5%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
	3. Euro	Rritje e normës së interesit në euro me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
Rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit	1. Usd	Nënçmim i usd ndaj lekut me 50%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
	2. Euro	Nënçmim i euros ndaj lekut me 50%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
Rreziku indirekt i normës së interesit	1. Lekë	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në lekë	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
	2. Usd	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në usd	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
	3. Euro	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në euro	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
		Rritje me më shumë se 1% e normës së së interesit të kredisë në euro	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
Rreziku indirekt i kursit të këmbimit	1. Usd	Nënçmimi i lekut ndaj usd me 60%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
	2. Euro	Nënçmimi i lekut ndaj euros me 50%	Nuk paraqet rrezik[20]	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik
		Nënçmimi i lekut ndaj euros me më shumë se 10%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Paraqet rrezik

Burimi: Banka e Shqipërisë.

7. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA DHE SHOQËRITË E SIGURIMIT

Institucionet financiare jobanka përfshijnë të gjitha institucionet financiare që nuk përkufizohen "bankë", sipas ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Përveç shoqërive të sigurimit, pjesa tjetër e institucioneve financiare jobanka, zë një peshë pothuaj të papërfillshme në totalin e sistemit. Për këtë arsye, rreziqet e veprimtarisë së këtyre institucioneve, nuk kanë karakter sistemik. Këto institucione përfaqësohen nga institucionet financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe të tjera. Gjendja e tyre financiare në fund të tremujorit të katërt është karakterizuar nga një rënie e aktivitetit krahasuar me një tremujor më parë, rënie e kapitalizimit të veprimtarisë dhe një rritje jo e rëndësishme e aktiveve me probleme. Në tregun e produkteve të sigurimit, është realizuar prania e tre kompanive të huaja, nëpërmjet blerjes së shumicës së kapitalit dhe formave të tjera të bashkëpunimit me shoqëritë ekzistuese vendase të sigurimit. Aktivet e shoqërive të sigurimeve zënë një pjesë relativisht të vogël të aktiveve të sistemit financiar. Sektori i sigurimeve paraqet një performancë pozitive për sa i përket treguesve të shëndetit si mjaftueshmëria e kapitalit, treguesi i cilësisë së aktiveve dhe eficiencës në përdorimin e kapitalit për 2007. Megjithatë, madhësia e këtij sektori, kufizon ndjeshëm aftësinë e tij për të përballuar financiarisht dëmet financiare që mund të pretendohen, për shkak të vështirësive me të cilat mund të ndeshet pjesa tjetër e sistemit financiar.

Grafik 51. Pesha e përbërësve të sistemit financiar ndaj PBB-së në % (2007).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përgjithësisht, institucionet financiare jobanka veprojnë si ndërmjetësues financiarë që nuk pranojnë depozita nga publiku. Në statistikat zyrtare ato klasifikohen si ndërmjetësues të tjerë financiarë, duke përjashtuar kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit. Deri në fund të vitit 2007, vepronin 7 institucione financiare jobanka, të cilat ishin të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe 3 institucione të tjera.

Grafik 52. Pesha specifike e përbërësve të sistemit financiar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tërësi, institucionet financiare jobanka (pa përfshirë shoqëritë e sigurimit) zënë një peshë të papërfillshme në përbërjen e PBB-së, me afërsisht 0.61 për qind për vitin 2007 dhe vetëm 1.83 për qind të aktiveve të sistemit financiar. Ndërkohë, aktivet e sektorit bankar zënë peshën kryesore prej 77.6 për qind të PBB-së, ndërsa shoqëritë e sigurimit zënë afërsisht 1.36 për qind të PBB-së. (grafiqet 51 dhe 52).

Grafik 53. Ndryshimi i aktiveve të institucioneve jobanka në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Aktivet e institucioneve financiare jobanka kanë pësuar një rënie me rreth 56 për qind për tremujorin e katërt të vitit 2007, krahasuar me tremujorin paraardhës. Kontributin më të madh në këtë rënie e kanë veprimet me klientët dhe veprimet me arkën, depozitat dhe llogaritë, si zërat kryesorë të aktivit të bilancit të tyre. Grafiku 53, paraqet ndryshimin e aktiveve për këto institucione sipas tremujorëve të periudhës 2006-2007.

Kapitalizimi i veprimtarisë për institucionet jobanka, i shprehur si raporti i llogarive të kapitalit me totalin e aktiveve, ka rezultuar afërsisht 44 për qind për tremujorin e katërt të vitit 2007, duke pësuar një rënie me 5 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit. Për sa i përket cilësisë së aktiveve për tremujorin e katërt të vitit 2007, portofoli i kredive rezultoi mesatarisht 83 për qind e totalit të aktiveve. Treguesi i kredive me probleme rezultoi 1.17 për qind e totalit të kredive të tyre, duke shënuar një rritje të lehtë me 0.23 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2007.

Një tregues tjetër i cilësisë së aktiveve është raporti i aktiveve jofinanciare ndaj totalit të aktiveve. Ky raport për tremujorin e fundit të vitit ka rezultuar afërisht 2 për qind, duke shënuar një rënie me 3.7 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2007.

Të ardhurat nga interesi përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të këtyre institucioneve; pesha e tyre për tremujorin e fundit të vitit 2007 rezulton afërsisht 82.2 për qind e totalit të të ardhurave. Një tjetër burim të ardhurash janë ato të krijuara nga komisionet, të cilat zënë afërsisht 9.6 për qind të totalit të të ardhurave për tremujorin e fundit të vitit. Vihet re një prirje e ndjeshme rënëse e të ardhurave nga interesat dhe komisionet për tremujorin e katërt të vitit, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, konkretisht me 22.3 për qind dhe 74.9 për qind.

Mbështetur në analizën e treguesve të mësipërm, aktiviteti i institucioneve financiare jobanka për tremujorin e fundit të vitit 2007, paraqet një ngadalësim krahasuar me tremujorin e tretë të po këtij viti.

Sektori i sigurimeve ka mundësi të mëdha zhvillimi brenda vendit, ndonëse aktualisht mbetet shumë për të bërë. Në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori pritet të ndikojë hyrja e tre kompanive të huaja, të cilat nëpërmjet blerjes së kapitalit dhe formave të tjera të bashkëpunimit me shoqëritë e sigurimit ekzistuese, kanë zgjedhur të pozicionohen në tregun shqiptar ku operojnë 11 shoqëri sigurimi. Prej tyre, vetëm 3 shoqëri ofrojnë produkte të sigurimit të jetës.

Aktivet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e tretë[21] të vitit 2007 janë rritur afërsisht me 17 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti

më parë. Sipas disa vlerësimeve, të ardhurat totale nga primet përfaqësojnë 0.6 për qind të PBB-së dhe totali i aktiveve të tyre zë rreth 1.4 për qind të vlerës së PBB-së. Aktivet e shoqërive të sigurimit zënë një pjesë relativisht të vogël në totalin e aktiveve të sistemit financiar, rreth 1.8 për qind të tij (tremujori i tretë 2007). Gjatë vitit 2007, vihet re një rritje e të ardhurave nga primet në masën 30.6 për qind në krahasim me vitin 2006, duke e çuar atë në 5.9 miliardë lekë (93 për qind e të cilit përbëhet nga tregu i jojetës). Raporti "dëme ndaj primeve" për vitin 2007, ka pësuar një rënie me 6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2006 (grafik 54).

Grafik 54. Raporti dëme/prime në tregun total të sigurimit.



Burimi: AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare).

Një tregues i rëndësishëm i shëndetit, që pasqyron aftësinë e sektorit për të përballuar humbjet ndaj rreziqeve të mundshme është ai i kapitalizimit të veprimtarisë, i cili matet si raport i kapitalit ndaj totalit të aktiveve. Në këtë mënyrë, kapitalizimi për tremujorin e tretë të vitit 2007 ka rezultuar 52.4 për qind, duke shënuar një rritje prej 5.4 pikë përqindje, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahas treguesit të mësipërm, një tjetër indikator është edhe ai i llogaritur si raport i kapitalit ndaj rezervave teknike, që për tremujorin e tretë të vitit 2007 ka rezultuar 116.5 për qind, duke shënuar një rritje të këtij treguesi me 20.7 pikë përqindjeje. Një element i aftësisë paguese të sistemit janë provigjonet teknike, të cilat për periudhën në fjalë janë rritur me rreth 50 për qind.

Për sa i takon treguesit të kthimit ndaj kapitalit (ROE), ai ka arritur në 19.7 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2007, vlerë kjo rreth 2.1 pikë përqindje më e lartë sesa një vit më parë.

Në përfundim, sektori i sigurimeve paraqet një performancë pozitive për sa i përket treguesve të shëndetit si kapitalizimi i veprimtarisë, treguesi i cilësisë së aktiveve dhe eficiencës në përdorimin e kapitalit për 2007. Megjithatë madhësia e këtij sektori, kufizon ndjeshëm aftësinë e tij për të përballuar financiarisht dëmet financiare që mund të pretendohen, për shkak të vështirësive me të cilat mund të ndeshet pjesa tjetër e sistemit financiar.

ANEKS 1.

Tabelë 20. Humbjet e shkaktuara nga kriza e huave hipotekore në sektorin financiar në disa vende të botës.

Vendi/Rajoni	Humbja totale e raportuar	Humbjet e vlerësuara mbi riçmimin ALT-A të kredive të SHBA	Humbjet e vlerësuara mbi ABS	Humbjet e vlerësuara mbi CDOs	Humbjet e vlerësuara mbi SIVs	Humbja totale e vlerësuar në lidhje me riçmimin (subprime)	Humbjet e pritshme nga subprime
Evropa	80	16	27	53	27	123	43
ku: Britania e Madhe	19	16	1	12	11	40	22
Zvicra	23	0	7	15	1	23	0
Vendet Skandinave	0	0	0	0	1	1	1
Zona e Euros	33	0	10	20	15	45	12
Të tjera	5	0	9	6	0	14	9
SHBA	95	29	12	90	13	144	49
Total	193	44	50	153	40	288	95

Burimi:Goldman Sachs; UBS dhe vlerësime të FMN-së.
Shënim: ABS= janë letra me vlerë të mbështetura nga asetet;
CDO= detyrim borxhi i kolateralizuar;
SIV= mjete të strukturuara investimi;
ALT-A = Kategori kredish hipotekore me rrezik potencial më të lartë se kreditë cilësore, por më të ulët se kreditë "subprime".

Hapësirë informuese. Rreziqet makroekonomike që prej tetor 2007.

Tabelë 21. Ndryshimet e rreziqeve dhe kushteve.
Që prej tetor 2007

Kushtet dhe rreziqet	Ndryshimet nga tetor 2007 - GRSR
Kushtet monetare dhe financiare	↓
Pranimi i rrezikut	↓↓
Rreziqet makroekonomike	↑↑↑
Rreziqet e tregjeve në zhvillim	↑↑
Rreziku i kredisë	↑↑↑
Rreziqet e tregut	↑

Burimi: IMF, 'Assessing risks to global financial stability'.

Kushtet monetare dhe financiare – Ka të bëjë me kostot e financimit dhe me disponueshmërinë e fondeve, të lidhura dhe me kushtet monetare dhe financiare botërore.

Pranimi i rrezikut – Nënkupton gatishmërinë e investitorëve për të ndërmarrë një rrezik shtesë duke rritur ekspozimin ndaj kategorive të aktiveve me rrezik të lartë, gjë që si pasojë rrit dhe mundësinë për humbje.
Rreziqet makroekonomike – Lidhen me tronditjet makroekonomike që kanë potencialin të nxisin ndryshime të forta në treg, duke patur parasysh kushtet ekzistuese në tregjet e kapitalit.

Rreziqet e tregjeve në zhvillim – Lidhen me karakteristikat kryesore makroekonomike të tregjeve në zhvillim dhe me ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të jashtme. Këto lloje rreziqesh, janë konceptualisht të ndara nga rreziqet makroekonomike, meqë fokusohen vetëm tek tregjet në zhvillim.

Rreziku i kreditit – Rezulton nga ndryshimet në perceptimin e cilësisë së kreditit, gjë që mund të çojë në tensionimin e institucioneve financiare me rëndësi sistemike.

Rreziqet e tregut dhe të likuiditetit – Janë mundësia për paqëndrueshmëri në vlerësimin e rreziqeve, gjë që mund të rezultojë në rrjedhje të mëdha kapitali dhe humbje midis tregjeve financiare.

SHËNIME

[1] Banka Qendrore Evropiane ka si objektiv të politikës së saj monetare ruajtjen e qëndrueshmërisë së çmimeve. Qëndrueshmëria e çmimeve përkufizohet si rritje vjetore e normës së inflacionit pranë, por më poshtë, nivelit 2 për qind. Nga ana tjetër, qëllimet e politikës monetare të Rezervës Federale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë specifikuar në ligjin e saj organik si "...të nxisë efektivisht objektivat e punësimit maksimale, të qëndrueshmërisë së çmimeve dhe të ecurisë së moderuar të normave afatgjata të interesit.". Ky ndryshim në objektiva, vendos përgjegjësi të ndryshme mbi këto dy banka qendrore dhe përcakton veprimet e tyre në kuadër të politikës monetare.

[2] Sipas informacioneve të disponueshme deri më 14/02/08.

[3] Një vlerësim i kohëve të fundit i humbjeve të sektorit financiar nga kriza financiare jepet në Aneksin 1.

[4] Informacioni dhe të dhënat për ndërtimin e grafikëve, janë marrë nga vlerësime të Bankës Qendrore Evropiane dhe materiale të tjera, të publikuara.

[5] Këtu e në vazhdim këtyre grupeve do t'i referohemi me simbolin GBMK.

[6] IFRS: International Financial Reporting Standards – standarde ndërkombëtare të uniformizuara të kontabilitetit.

[7] Sipas totalit te aktiveve, bankat ndahen në grupe ku në grupin e parë (G1) përfshihen bankat që zënë 0-2 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar, në grupin e dytë (G2) përfshihen bankat që zënë 2-7 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar dhe në grupin tretë (G3) përfshihen bankat që zënë më shumë se 7 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

[8] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së kredisë, sipas kategorive të raportuara të maturimit. për çdo interval është marrë"apriori", mesi i tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin kreditë "deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 0.5 muaj; për atë "1-3 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vjet ose 120 muaj (duke qenë së pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vjet.

[9] Rritja e raportit për tremujorin e parë të vitit 2008 i dedikohet një ndryshimi metodologjik.

[10] Sistemi i shlyerjes në kohë reale (RTGS), i cili vlerësohet kundrejt parimeve themelore për sistemet e pagesave me rëndësi sistemike (CPSIPS)

[11] Sistemi i shlyerjes në bazë neto

[12] Burimi: Country Report IMF – Shkurt 2008

[13] Bankat që kanë peshën më të madhe të pagesave në numër dhe vlerë, nga 17 bankat pjesëmarrëse në sistemin AIPS.

[14] Bankat që kanë peshën më të madhe të pagesave në numër dhe vlerë, nga 15 bankat pjesëmarrëse në sistemin AECH.

[15] Instat – Numri i popullsisë, janar 2005.

[16] Përkufizim sipas Raportit të Committee on Payment and Settlement Systems, "Central Bank oversight of payment and settlement systems" May 2005, Bank for International Settlements.

[17] Të dhënat i referohen muajit Mars 2008.

[18] Aplikimi i goditjes së mbiçmimit të euros ndaj lekut e rrit normën e mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator.

[19] Për secilen nga monedhat është aplikuar edhe një goditje negative por në asnjë rast kjo nuk ka rezultuar problematike për nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

[20] Pa përfshirë Bankën Raiffeisen norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bie në kufirin minimal të lejuar.

[21] Të dhënat e tremujorit të fundit të vitit 2007 për bilancin e shoqërive të sigurimit, nuk janë ende të disponueshme.